RAPORTI PËRFUNDIMTAR

MBI

Auditim Financiar

Tiranë, tetor 2026

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
DAB	Drejtoria e Auditit të Brendshëm
EMP	Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MF	Ministria e Financave
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NZ	Nëpunës Zbatues
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Aksionere
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	**PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE**	4-8
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-4
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-7
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	8-8
II.	**HYRJA**	9-12
1	Objektivat dhe qëllimi	9-9
2	Identifikimi i çështjes	9-9
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-9
4	Përgjegjësitë e audituesve	9-10
5	Kriteret e Vlerësimit	10-10
6	Standardet e auditimit	10-10
7	Metodat e auditimit	10-11
8	Dokumentimi i auditimit	11-12
III.	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	12-108
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12-13
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	13-108
2.1	Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	13-26
2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2025	26-55
2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2025	55-65
2.4	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna	65-104
2.5	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	104-105
IV.	**REKOMANDIME**	105-122

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e Vlorës kufizohet në veri me Bashkinë Fier, në lindje me Bashkinë Selenicë dhe në jug me Bashkinë Himarë. Qendra e bashkisë është qyteti i Vlorës.
Bashkia Vlorë ka nën administrimin e saj dy qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra. Në listën e fshatrave përfshihet edhe Sazani. Bashkia e Vlorës përfshin të gjithë zonën bregdetare nga Lumi i Vjosës në veri deri në Qafën e Llogarasë në jug, duke përfshirë Gadishullin e Karaburunit dhe Ishullin e Sazanit.
Me miratimin e Ligjit nr.115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia Vlorë përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë.
Buxheti i Bashkisë Vlorë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet:"1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë". Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Vlorë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe fondet e transferuara nga buxheti i shtetit.
Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Vlorë për periudhën e aktivitetit 2025 qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.
Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit për periudhën objekt auditimi 01.01.2025 – 31.12.2025, janë si vijon:
- Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm;
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit;
- Auditim mbi burimin e krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre;
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për pasqyrat financiare të vitit 2025;
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren. Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore.

Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit.
Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.
Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 63,144 mijë lekë.
Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik; Konfirmim nga të tretët; Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve; Intervistimi; Raporte dhe informacione; Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- Verifikimi i transaksioneve;
- Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;
- Intervistat;
- Verifikimi në sisteme dhe terrene, etj.

e. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 18 gjetje dhe ka dhënë 23 rekomandime, nga të cilat masa organizative me 10 gjetje dhe 12 rekomandime, 8 gjetje dhe 10 rekomandime në vlerën 1,244,722 mijë lekë masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin e të ardhurave të munguara.
f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me*:*

- ***Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2025.***

- Nga auditimi u konstatua se vlera progresive e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore të subjekteve fizik/juridik/institucione/abonentë familjarë, etj në fund të vitit 2025 është në vlerën 829,623,808 lekë[1], nga të cilat vlera e debitorëve të krijuar gjatë vitit 2025 është 37,932,379 lekë dhe pakësimet gjatë vitit 2025 janë në vlerën 27,422,381 lekë. Sa më sipër, në krahasim me fundin e vitit 2024, ku vlera debitore është 819,113,810 lekë, në fundin e vitit 2025 vlera debitore është rritur me 10,509,998 lekë.
- Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vlorë (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Vlorë) u konstatua se përgjatë vitit 2025, në 46 raste, janë kryer punime ndërtimi nga subjekte të ndryshme, për të cilët nuk është aplikuar tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën 4,631,073 lekë.
- Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit, rezultoi se përgjatë vitit 2025 në territorin e Bashkisë Vlorë, kanë ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit 40 subjekte, nga të cilët 18 prej tyre kanë ushtruar aktivitet të pa licensuar. Përgjatë vitit 2025 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë. Konstatohet se në fund të vitit 2025 rezultojnë debitor 6 subjekte për vlerën 5,000,000 lekë.
- Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV Bashkia Vlorë, u konstatua se deri më datë 31.12.2025 në mënyrë progresive, si rrjedhojë e mos likuidimit të 665 gjobave të vendosura, janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin

[1] Sqarojmë se në këtë vlerë nuk janë përfshirë detyrimet nga gjobat e IMTV dhe Policisë Bashkiake (vlera e të cilave është e kontabilizuar), qira për stacionet e plazhit (vlera e të cilës nuk është kontabilizuar), tarifa e licencimit të stacioneve të karburantit (vlera e të cilës nuk është kontabilizuar).

e bashkisë në vlerën 402,010,813 lekë, vlerë e cila është e kontabilizuar. Për vitin 2025 vlera e detyrimit të krijuar nga gjobat e vendosura nga IMTV është në vlerën 195,985,813 lekë.
- Nga auditimi i të ardhurave nga qiradhënia e aseteve në pronësi/përdorim të Bashkisë Vlorë, u konstatua se Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve, si struktura e ngarkuar për administrimin e aseteve, (përjashtuar hapësirat e dhëna me qira për stacion plazhi) nuk ka një regjistër të kontratave të qirasë për pasuri të llojit ndërtesë, truall, sipërfaqe pyjore dhe kullosore etj, si dhe nuk ishte kryer verifikim fizik pranë pasurive, të cilat i ka në pronësi/përdorim, me qëllim identifikimin e përdorimit të tyre në mungesë të dokumentacionit ligjor. Konstatohet se nga vlera e faturuar prej 35,736,128 lekë për vitin 2025, për marrjen me qira të hapësirës për "Stacion plazhi", janë likuiduar vetëm 34,550,628 lekë, pra me diferencë në vlerën 1,185,500 lekë, si rrjedhojë e mos pagesës së detyrimit vjetor nga 5 subjekte.
Në mënyrë progresive deri më datë 31.12.2025 vlera e detyrimit të papaguar për marrjen me qira të hapësirës për "Stacion plazhi" është 2,400,000 lekë, ku vlera prej 1,214,500 lekë krijuar deri në fund të vitit 2024 dhe 1,185,500 lekë krijuar brenda vitit 2025, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.
- Nga auditimi mbi administrimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, rezultoi se Bashkia Vlorë administron të dhëna sa i takon subjekteve biznes, ndërkohë që për detyrimet e familjarëve merren të mirëqenë vlerat totale të arkëtuara që i kalohen nga Ujësjellës Kanalizime Vlorë, pa kryer verifikime dhe pa njohur numrin e abonentëve taksapagues dhe atyre debitorë. Me përjashtim të DAV, drejtoritë e tjera që administrojnë taksa/tarifa vendore nuk mbajnë regjistër për menaxhimin e të dhënave. Gjithashtu konstatohet se procesi i administrimit të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Vlorë është shpërndarë dhe jo i mirëkoordinuar, duke qenë se pranë kësaj bashkie ekziston Drejtoria e të Ardhurave Vendore, por kjo drejtori është përgjegjëse vetëm për administrimin e të dhënave që lidhen me subjektet private, ndërkohë që e gjithë pjesa tjetër e të ardhurave administrohen nga drejtori të tjera, duke ndikuar negativisht në procesin e planifikimit dhe marrjes së masave për arkëtimin e të drejtave.
- Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të vitit 2025, rezultoi se është realizuar në masën 57%, ku realizimin më të lartë e ka ndihma ekonomike, ndjekur nga shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë shpenzimet për mallra, shërbime dhe investime. Ky mos realizim vjen për faktin se parashikimi i shpenzimeve nuk është bërë mbi bazën e të ardhurave faktike të një viti më parë, por është planifikuar mbi planin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, i cili për asnjë vit nuk realizohet. Detyrimet e prapambetura të raportuara në fund të vitit 2025, konstatohet se janë në vlerën 72,399,600 lekë, vlerë e cila në raport me totalin e shpenzimeve të vitit, zë 2.81 %, gjë që tregon se kjo njësi vendore nuk është në vështirësi financiare.

- ***Mbi auditimin e llogarive vjetore 2025.***

-Nga auditimi i llogarisë nr. 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 51,904,240 lekë, për garanci të cilave i ka kaluar afati dhe duhet t'u kthehen subjekteve përkatëse.
- Nga auditimi i llogarisë nr. 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 175,551,000 lekë. Nga verifikimi i kryer në databazën e QKB-së, rezultoi se Bashkia Vlorë zotëron aksione në disa Shoqëri Aksionare. Konkretisht Bashkia Vlorë, zotëron aksione në: Vlora Parking Sh.A., me NIPT M56403202P, 100% të aksioneve me vlerë 3,500,000 lekë; Markata e Peshkut Sh.A., me NIPT M46723211H, 100% të aksioneve me vlerë 3,500,000 lekë; Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë Sh.A., 41.35% të aksioneve me vlerë 4,135,000 lekë; K.F.Oriku Sh.A., me NIPT L36521202N, 100% të aksioneve me vlerë 4,100,000 lekë; Flamurtari Football Club Sh.A., me NIPT L17130203I, 100% të aksioneve me vlerë 3,500,000 lekë; Tregu Shitjes me Shumicë Frut-Perim Sh.A., me NIPT K67217201D, 100% të aksioneve me vlerë 156,816,000 lekë.
- Nga auditimi i analizave të llogarive të aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare në mbyllje të vitit 2025, rezultoi se nuk ka analizë më vete për vlerat e rikonstruksioneve,

mbikëqyrjes dhe kolaudimit, të cilat nuk i shtohen vlerës së aktivit pas investimeve të kryera. Gjithashtu, rezultoi keqklasifikim kontabël, i gjendjes së këtyre aktiveve në llogaritë: Në analizën e gjendjes së llogarisë *212"Ndërtesa e Konstruksione",* janë keqklasifikuar 7 aktive në vlerën prej 96,594,903 lekë, ku sipas klasifikimit kontabël, 6 aktive në vlerën 88,775,097 lekë i përkasin llogarisë *213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"* dhe 1 aktiv në vlerën 7,819,806 lekë llogarisë *210 "Toka, Troje, Terrene*; - Në analizën e gjendjes së llogarisë *213 "Rrugë, mjete, vepra ujore"*, është keqklasifikuar vlera prej 103,720,750 lekë e 30 aktiveve, ku sipas klasifikimit kontabël, 5 aktive në vlerën 16,228,308 lekë i përkasin llogarisë *210 "Toka, Troje, Terrene"*, 13 aktive në vlerën 3,738,580 i përkasin lekë llogarisë 214 *"Instalime teknike makineri e pajisje"* dhe 12 aktive i përkasin llogarisë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në vlerën 83,753,862 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë vlera 37,387,815 lekë e emërtuar "*Të tjera*", e cila është trashëguar nga ish-komunat e pa analizuar.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Vlorë, si dhe administratorët e njësive administrative, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve debitorë nga taksa/tarifa vendore në subjektet fizik/juridik/institucioni/abonentë familjarë në vlerën 829,623,808 lekë, për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos arkëtimi i tyre.
- DAV Bashkia Vlorë të nxjerrë njoftim detyrimin për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative për arkëtimin e vlerës prej 4,631,073 lekë[2].
- Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 5,000,000 lekë.
- Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Kryeinspektori i IVMT Bashkia Vlorë të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 402,010,813 lekë.
- Kryetari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me objekt verifikimin, inventarizimin e pasurive që Bashkia Vlorë ka në pronësi/përdorim, me qëllim krijimin e regjistrit të aseteve me informacion të plotë për vendndodhjen, statusin juridik, gjendjen fizike etj.
- Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Bashkia Vlorë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore 2,730,750 lekë, nga të cilat 2,400,000 lekë si rrjedhojë e mospagesës së detyrimit vjetor të qirasë për hapësirë plazhi, si dhe 330,750 lekë si rrjedhojë e aplikimit jo të drejtë të nivelit të tarifës për hapësirë plazhi.
- Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, të marrë masa për të përmirësuar planifikimin buxhetor dhe monitorimin periodik të zbatimit të fondit të investimeve, duke planifikuar fondet mbi nevoja reale dhe duke analizuar në kohë devijimet nga plani, me qëllim rritjen e nivelit të realizimit dhe përdorimin efektiv të fondeve publike.
- Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të analizojë mundësinë e ndryshimeve në strukturat aktuale përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, duke i centralizuar këto përgjegjësi, me qëllim planifikimin dhe koordinimin më të saktë të treguesve mbi taksat dhe tarifat vendore.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinion mbi pasqyrat financiare viti 2025.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Vlorë për periudhën ushtrimore 01.01.2025 – 31.12.2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese.

[2] Subjektet janë pasqyruar në Kapitullin Anekse – Aneksi nr.2, tabelat nr.24 dhe nr.25.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, Pasqyrat Financiare të vitit 2025, me përjashtim të rasteve të cilësuara në "Bazën për opinion e kualifikuar", paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit më 31 dhjetor 2025, referuar kuadrit rregullator të zbatuar nga njësia për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare".

Baza për opinion të kualifikuar[3]**:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga njësia shpenzuese Bashkia Vlorë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 është 63,144 mijë lekë.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

-Llogaritë e Aktiveve Afatgjata dhe Afatshkurtra Materiale, janë pasqyruar për vlerën kontabël pa u krahasuar me inventarin fizik;

-Vlerat e rikonstruksioneve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit janë pasqyruara më vete, dhe nuk i janë shtuar vlerës së aktivit pas investimeve të kryera.

- Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 212 "Ndërtesa e Konstruksione", rezultoi se janë përfshirë në mënyrë të gabuar 7 aktive në vlerën prej 96,594,903 lekë, ku 6 aktive në vlerën 88,775,097 lekë i përkasin llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" dhe 1 aktiv në vlerën 7,819,806 lekë llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene".

- Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 213 "Rrugë, mjete, vepra ujore", janë përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 103,720,750 lekë e 30 aktiveve, ku 5 aktive në vlerën 16,228,308 lekë i përkasin llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene", 13 artikuj aktivesh në vlerën 3,738,580 lekë llogarisë 214 "Instalime teknike makineri e pajisje" dhe 12 artikuj aktivesh llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën 83,753,862 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë vlera 37,387,815 lekë e emërtuar "Të tjera", e cila është trashëguar nga ish-komunat e pa analizuar.

-Llogaria nr.26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet", është pasqyruar më pak për vlerën 175,551,000 lekë;

-Llogaria nr.466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", është pasqyruar më shumë për vlerën 51,904,240 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 739/1 prot., datë 01.07.2026, për "*Auditimin financiar"*, i miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 01.07.2026

3 **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, **janë materiale por jo të përhapura**".

deri në datë 06.08.2026, në subjektin Bashkia Vlorë për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025 u krye auditimi, nga grupi i auditimit me përbërje:
1. K.K, përgjegjës grupi;
2. A.G, auditues;
3. K.P, auditues.

1.OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objekti dhe qëllimi i auditimit.
Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Identifikimi i çështjes.
Raporti Përfundimtar i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Vlorë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:
1.Aktiviteti i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm;
2.Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
3.Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
4.Raportimi financiar;
5.Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;
6.Ankesa të dala gjatë auditimit.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.
Niveli drejtues i Bashkisë Vlorë (Kryetari i Bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Drejtori i Drejtorisë së Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontrolleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.
Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Vlorë, drejtorët e drejtorive pranë Bashkisë Vlorë kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Përgjegjësitë e audituesve.
Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.
Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Audituesi merrë evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Kriteret e vlerësimit.
Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:
- Në fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit:
Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm publik", i ndryshuar;
Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar;
VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik";
Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;
Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues";
Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 "Për miratimin e manualit të MFK", i ndryshuar;
Urdhri i MF nr. 100, datë 16.10.2017 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar.
- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:
UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar;
Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar;
Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" i ndryshuar;
Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "Për përgatitjen e buxhetit vendor";
Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore".
Udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore".
- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:
Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar;
Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave lokale", i ndryshuar;
Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar;
VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar;

VKB nr. 96, datë 07.12.2023, “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2025”, i ndryshuar;

Standardet e auditimit.
ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar të KLSH-së etj; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

Metodat e auditimit.
Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:
- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve*. Është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi.* Është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione*. Janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm*. Grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit.
Mbështetur në kërkesat e manualeve të auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i auditimit”, nga audituesit u

përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, akt-konstatimeve dhe akt-verifikimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit. Gjatë hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, sipas përcaktimeve ligjore janë paraqitur kundërshtime nga subjekti Bashkia Vlorë, pasqyruar në çështjet përkatëse.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Bashkia e Vlorës kufizohet në veri me Bashkinë Fier, në lindje me Bashkinë Selenicë dhe në jug me Bashkinë Himarë. Qendra e bashkisë është qyteti i Vlorës.

Bashkia Vlorë ka nën administrimin e saj dy qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra. Në listën e fshatrave përfshihet edhe Sazani. Bashkia e Vlorës përfshin të gjithë zonën bregdetare nga Lumi i Vjosës në veri deri në Qafën e Llogarasë në jug, duke përfshirë Gadishullin e Karaburunit dhe Ishullin e Sazanit.

Me miratimin e Ligjit nr.115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia Vlorë përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë.

Bashkia Vlorë, Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësive	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Vlorë	**Qyteti** Vlorë
Orikum	**Qyteti:** Orikum, **Fshatrat:** Dukat, Dukat Fshat, Tragjas, Radhimë
Qendër Vlorë	**Fshatrat:** Bestrovë, Babicë e Madhe, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kaninë, Kërkovë, Nartë, Sherishtë, Panaja, Xhyherinë, Zvërnec, Sazan.
Novoselë	**Fshatrat:** Novoselë, Aliban, Bishan, Mifol, Poro, Dëllenjë, Delisuf, Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, Fitore, Akërni.
Shushicë	**Fshatrat:** Shushicë, Bunavi, Beshisht, Grabian, Drithas, Mekat, Llakatund, Çeprat, Risili.

Organizimi i Bashkisë Vlorë:

Bashkia Vlorë ka nën varësi njësitë shpenzuese si Ndërmarrja e Shërbimeve Publike; Ndërmarrja e Mbetjeve të Ngurta; Klubi Shumësportësh Flamurtari; Teatri "Petro Marko"; Qendra e Kulturës; Shtëpia e Fëmijës; Qendra e Zhvillimit PAK.

Administrata e Bashkisë Vlorë përbëhet nga:

Këshilli Bashkiak, Kryetari, Nënkryetari.
Drejtoria e Bashkëqeverisjes.
Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit ekonomik.
Drejtoria e Auditit të Brendshëm.
Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
Drejtoria e Protokoll-Arkivës.
Drejtoria Juridike.
Drejtoria e Prokurimeve.
Drejtoria e Urbanistikës.
Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.
Drejtoria e Mbrojtjes Civile.
Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike.

Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social.
Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit.
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
Drejtoria e Projekteve të Huaja Integrimit Europian dhe Diasporës.
Njësitë Administrative dhe Rajonet.
Seksioni i Gjëndjes Civile.
Policia Bashkiake.

III.2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit.

III.2.2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe kanë ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga Bashkia Vlorë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti "Mjedisi i kontrollit".

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Vlorë në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se Bashkia Vlorë nuk ka miratuar rregulloren e brendshme për vitin 2025, por vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me Vendimin nr. 101, datë 11.09.2018 "Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Vlorë". Në këtë dokument nuk janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit në përputhje me strukturën organizative.

Në Bashkinë Vlorë nuk është miratuar kodi i etikës profesionale në kundërshtim me kërkesat pikës "a", nenit 20 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, por bashkia ka përshtatur përcaktime të kodit të etikës me anë të disa dispozitave në rregulloren e brendshme.

Një problematikë e evidentuar lidhur me këtë parim është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore.

Rregullorja e brendshme është e publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë. Bashkia ka procedura të shkruara për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave.

-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se për vitin 2025, Bashkia Vlorë nuk ka përcaktuar procedura për mbrojtjen ndaj sinjalizuesve dhe nuk ka mekanizma të cilat i

dedikohen ankesave për korrupsion. Gjithashtu konstatohet se nuk ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësisë publike për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të ndershëm.

Gjatë vitit 2025 janë marrë 2 masa disiplinore:
Bashkia vlerëson performacën e personelit nëpërmjet vlerësimeve të punës të cilët përmbajnë edhe elementë të vlerësimit dhe monitorimit për zbatimin e rregullave të etikës.

Parimi 2-Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Nga auditimi i dokumentacionit konstatohen se nuk ka raportime periodike mbi monitorimin e planit të veprimit për KB.
Nga drejtoritë dhe sektorët nuk ishin hartuar planet mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve.
Në rregulloren e brendshme është përcaktuar përgjegjësia menaxheriale e drejtuesve të të gjitha strukturave të bashkisë të cilët janë përgjegjës dhe raportojnë dhe i japin llogari, sipas shkallës hierarkike, eprorit direkt deri tek Kryetari ose tek nëpunësit të cilëve Kryetari u ka deleguar përgjegjësinë, për: Hartimin dhe monitorimin e planeve vjetore dhe periodike në përputhje me objektivat strategjike, afatmesme si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit, menaxhimin/administrimin e risqeve/problemeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë (nëpërmjet identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit periodik të zbatimit të masave për zvogëlimin e risqeve), informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësive të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejtojnë, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve

Për periudhën e aktivitetit të vitit 2025, nëpërmjet shkresës nr. 2431 prot., datë 18.03.2026 është dërguar pranë MFE-së "Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm", si dhe "Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm" dhe "Raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon" për vitin e mëparshëm.
Në raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të Bashkisë Vlorë për vitin 2025, citohet se: "Në lidhje me masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit theksojmë se janë miratuar prioritetet e investimeve bazuar në analizën e faktorëve që kanë impakt më të madh në komunitet".
Për sa trajtuar më sipër, rezultoi se në formatin e këtij raporti nuk përfshihen të gjithë kapitujt/elementët e parashikuar në Udhëzimin nr. 2, datë 26.01.2024 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike", konkretisht:
-Vlerësimin e sistemit të MFK-së në të cilën përfshihet:
Gjendja aktuale e sistemit të MFK-së; objektivat e përmbushura gjatë periudhës së raportimit si dhe vlerësimin i cili duhet të paraqitet për çdo komponent të menaxhimit financiar dhe kontrollit me fokus kryesisht tek: mjedisi i kontrollit; vendosja e objektivave; identifikimi i ngjarjeve, vlerësimi i riskut; përgjigjen ndaj riskut; aktivitetet e kontrollit; informacioni dhe komunikimi; monitorimi.
-Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në të cilën përfshihet:
Gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm për vitin e raportimit, si dhe rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit për përmirësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm.
-Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen në të cilën përfshihet:

Masat e marra nga titullari dhe vetë nëpunësi autorizues gjatë vitit raportues për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, minimizimin e risqeve që pengojnë përmbushjen e objektivave dhe plan veprimet për të ardhmen bazuar në rekomandimet auditit të brendshëm apo të jashtëm, si dhe menaxherët e njësisë.
-Rekomandime të përgjithshme për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm në të cilën përfshihet:
Rekomandimet për përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e kontrollit të brendshëm, për ndjekje të mëtejshme nga njësitë qendrore të harmonizimit të Ministrisë së Financave.
Pjesë e shkresës përcjellëse nr. 2431 prot., datë 18.03.2026, është edhe plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollit në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.
Bashkia nuk kishte hartuar planin e menaxhimit të risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.
Këshilli i Bashkisë Vlorë me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Parimi 3 - Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.
Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit te delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.
Institucioni vepron mbi bazën e rregullore të brendshme të miratuar me Vendimin nr**.** 101, datë 11.09.2018 "Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Vlorë" e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek drejtorët e drejtorive, por jo në përputhje me strukturën organizative Nr. 3, datë 17.01.2025, të publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
Nga auditimi konstatohet se nuk ishte rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë nuk është miratuar një rregullore e re.
Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PPV-ve, si dhe në Relacionin e Buxhetit. PPV është i publikuar në faqen web të bashkisë https://vlora.gov.al/.
Me Vendimin Nr. 3, datë 17.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë dhe Institucionet të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2025" është miratuar struktura e përbërë nga **475** punonjës, ndër të cilat **150** nëpunës civilë.

- **Struktura organizative e bashkisë.**

Administrata e bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë (jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:
Funksionet politike: Kryetari; Zëvendëskryetarët; Administratorët; Kabineti. Emërimi dhe lirimi i funksionarëve politikë dhe funksionarëve të kabinetit të bashkisë bëhet me Urdhër të Kryetarit.
Nëpunësit civilë: Shërbimi Civil në bashki organizohet dhe funksionon sipas Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij,

duke përcaktuar skemën e administrimit të këtij shërbimi. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:

a. Nëpunës të nivelit te lartë drejtues: - Sekretari i Përgjithshëm.
b. Nëpunës të nivelit te mesëm drejtues: - Drejtorë Drejtorie
c. Nëpunës të nivelit të ulët drejtues: - Përgjegjës Sektori
d. Nëpunës të nivelit ekzekutiv: - Specialistët.

Punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës ku përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë.

Struktura e Bashkisë Vlorë për vitin 2025

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	**475**	Nëpunës Civilë	**150**
		Nëpunës me kontratë	**325**
Numri i të punësuarve me kontratë provizore		-	-
Vende vakante		-	**35**

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Bashkia Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Përgjatë vitit 2025, janë rekrutuar **56** punonjës të rinj. Në dosjet e personelit, nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe as objektivat për secilin punonjës.
Bashkia Vlorë ka faqen e saj zyrtare në internet, në të cilën përditësohen dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.
Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku konstatohet se bashkia përdor procedurat për delegimin e detyrave.

Parimi 4 -Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave.
Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.
-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.
Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë Bashkisë Vlorë
Përgjatë vitit 2025, janë rekrutuar **56** punonjës (nëpunës civil dhe punonjës me kontratë), pranë Bashkisë Vlorë. Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, pavarësisht se nuk ka një plan vjetor rekrutimi.
Për sa më sipër, grupi i auditimit ka verifikuar respektimin e kuadrit ligjor nga ana e bashkisë për rekrutimin (punësimin) e punonjësve gjatë kësaj periudhe kohore, konkretisht:
1-Për punësimin e znj. O.K, e punësuar me aktin nr. 16500 datë 10.10.2025, "Kontratë Individuale e Punës" të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin "Specialist" në Njësinë e Kordinimit të procesit të Legalizimeve. Nga verifikimi i dosjes së personelit nuk rezultoi, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.
2-Për punësimin e z. E.V, i punësuar me aktin nr. 8741 datë 04.06.2025, "Kontratë Individuale e Punës" të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin "Përgjegjës" në Sektorin e Kontrollit të Territorit, në Policinë Bashkiake. Nga verifikimi i dosjes së personelit rezultoi se: nga ana e Bashkisë Vlorë, nuk rezultoi, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

Si konkluzion, punësimi pranë Bashkisë Vlorë i nëpunësve për të cilët nuk është zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi e hapur, përveçse bie ndesh me interesin publik, parimin e konkurrencës së lirë dhe barazisë përpara ligjit, ndër të tjera, përbën një risk të shtuar duke ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e punës në Bashkinë Vlorë.
"Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 107, pika 2, ku përcaktohet se: Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji".
Për sa më sipër me ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Burimeve Njerëzore.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.
Nga drejtoria juridike dhe e burimeve njerëzore nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.
Nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.
Për vitin 2025 janë kryer nga ASPA, **24** trajnime ku kanë marrë pjesë **24** nëpunës të institucionit.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.
Nga auditimi i kryer rezultoi se bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme. Njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë dhe nuk ka autorizime për delegimin e detyrave.
Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.
Për vitin 2025, Titullari i bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 425 datë. 21.08.2025 *"Për krijimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik" (GMS)* Në këtë urdhër, komisioni ka në përbërje **10** anëtarë dhe kryetar grupi është Titullari i bashkisë.
Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se takimet e GMS, dokumentohen me procesverbale. Vlen të theksojmë se GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20;
-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit;
financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.1 "Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK" a, b, c, d, pika 2.3.1;
-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Kreu II. "Dosja e Personelit";
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.1, Kapitulli IV "Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit", Kapitulli V, Anekset.

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët/NA/Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më

gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.
Nga auditimi i kryer konstatohet se, bashkia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), në të cilin evidentohen objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Dokumenti përfundimtar i PBA-së 2025-2027 është miratuar me VKB nr. 17 datë 25.02.2025 "Për miratimin e Programit Buxhetor për vitin 2025". *Ky dokument është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë.*
Bashkia ka hartuar plan-veprime operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA).
Në planin vjetor të punës, çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, suksesi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike. Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezultoi se njësia publike ka krijuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut. Janë identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe priotizimin e risqeve të përputhshmërisë.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve.

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.
Nga auditimi i kryer konstatohet se bashkia vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve.

Parimi 9 - Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme.

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se ka sistem të Kontrollit të Brendshëm.

III. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit".

Veprimtaritë e kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. Menaxhimi dhe auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.
Në vijim të auditimit të kryer, konstatohet mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
Listë prezencat plotësohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës dhe listë pagesa përpilohet nga specialisti i pagave, të dhënat hidhen çdo muaj në librin e pagave.
Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, bashkia ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve, krijimin e komisioneve për prokurimet, komisioneve për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.)
Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimeve dhe krijimi i tyre në sistemin e PP" është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.
Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit dhe në bankat e nivelit të dytë.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.
Bashkia ka sisteme funksionale të IT-së si TAIS, SIFQ, HRMIS etj. dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it.
Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces. Bashkia nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.
Bashkia ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësive për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

- **Gjurma e auditimit.**

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.
Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 5.2.7 "Monitorimi dhe Raportimi";
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

IV. Komponenti: "Informimi dhe komunikimi".

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.
Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
Në vijim të auditimit, konstatohet se bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.
Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.
Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.
Nuk ka sistem për kontabilizimin e të dhënave në bashki.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se janë hartuar procedura të shkruara për të siguruar që menaxherët dhe personeli i bashkisë të informohen mbi që të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve dhe nismat e tjera të bashkisë.
Bashkia përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike. Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.
Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresor dhe evidentohet që punonjësit përdorin adresat zyrtare të e-mailit. Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të njësisë të informacionit lidhur me: Dokumentin e buxhetit vjetor të propozuar; Buxhetin e miratuar të bashkisë; Raporte periodike të zbatimit të buxhetit; Pasqyrat vjetore financiare të dhe të buxhetit; Planet vjetore të prokurimit, proceset e hapura të prokurimit, kontratat e lidhura, statistika mbi prokurimet; Raporti i auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës.

Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 23, "Informacioni dhe Komunikimi" pika 2;
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

V. Komponenti: "Monitorimi".
Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.
Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.
Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.
Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.
Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së.
Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm. Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.
DAB ka hartuar planin strategjik, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 15333/1 prot., datë 16.10.2024, të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2025.
Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.
Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.
Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, "Monitorimi" pika 1; Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:
Përsa i përket sistemit të MFK: Bashkia ka ngritur një sistem jo efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk janë hartuar planet vjetore të punës. Bashkia Vlorë nuk ka miratuar rregulloren e brendshme në përputhje me strukturën organizative të miratuar për vitin 2025.

-Dosjet personale të punonjësve kanë disa mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, vlerësimet periodike të punonjësve dhe formularët e përshkrimeve të punës.

Organizimi, përbërja dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

Në zbatim të Ligjit nr.114/2015, datë 20.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku përcaktohet se:

"*Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në germat a-c të kësaj pike"*, është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Auditit të Brendshëm në varësi funksionale nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.

DAB, përgjatë periudhës objekt auditimi, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të VKB Nr. 3, datë 17.01.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara 2025", duke pasur në strukturën e saj 1 (një) Përgjegjës znj. L.G dhe 2 (dy) specialiste znj. E.Gj dhe znj. Xh.M të certifikuara si audituese të brendshme.

Struktura e DAB për vitin 2025

Nr	Periudha	Funksioni	Arsimi bazë	Niveli i diplomës	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime
	Për vitin 2025							
1	L.G	Përgjegjëse	Ekonomiste	Master Shkencor	18	18	2011	Po
2	E.GJ	Audituese	Ekonomiste	Master Shkencor	18	16	2013	Po
3	XH.M	Audituese	Financë	Bachelor	10	7	2018	Po

Burimi: DAB Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Trajnimet e DAB dhe certifikimet.

Audituesit e brendshëm duhet të zgjerojnë njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përgjegjësia për trajnimin nuk është vetëm e drejtuesit të auditimit të brendshëm ose strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo audites duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikat e reja të auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve të DAB sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Për vitin 2025 trajnimet e audituesve të DAB për Bashkinë Vlorë pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Trajnimet e DAB për vitin 2025

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Tema e trajnimit	Institucioni Trajnues	Data e trajnimit (online/fizik)
1.	L.G	Përgjegjëse	Menaxhimi i të ardhurave vendore	Drejtoria e Harmonizimit të Audititmit të Brendshëm	9-13 Tetor (40 orë) Trajnim Fizik
2.	E.GJ	Audituese	Menaxhimi i të ardhurave vendore	Drejtoria e Harmonizimit të Audititmit të Brendshëm	9-13 Tetor (40 orë) Trajnim Fizik
3.	XH.M	Audituese	Menaxhimi i të ardhurave vendore Trajnim për biznesin e vogël dhe OJF	Drejtoria e Harmonizimit të Audititmit të Brendshëm	9-13 Tetor (40 orë) Trajnim Fizik

Burimi: DAB Vlorë përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Komiteti i Auditit të Brendshëm.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj, nuk është krijuar nga Bashkia Vlorë.

Nga kontrolli i dokumentacionit rezultoi se nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, neni 12, shkronja "b", i cili përcakton se titullari i njësisë publike është përgjegjës për: Krijimin e Komitetit të Auditimit

të Brendshëm në njësitë publike përkatëse sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës "b" të nenit 23 të këtij ligji".
Sa më sipër rezultoi se, Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të ligjit nr.114/2015 "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit".

Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik.
Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm.
DAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik"* ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" në Bashkinë Vlorë, e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr. 4062 prot, datë 26.02.2026, Urdhër i Brendshëm nr. 334 prot, datë 26.02.2026 dhe rezultoi se është në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016".

Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve.
Në manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.100, datë 25.10.2016, përcaktohet se: "Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri më datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri më datën 10 Tetor të çdo viti. Planet pas dhënies së mendimit, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data 20 Tetor e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm".
Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publike dhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani Vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i auditimit të brendshëm.
Në mbështetje të manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik 2023-2025 i cili është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr.15333/1 prot., datë 16.10.2024. Plani vjetor për vitin 2025 ka pësuar ndryshime sipas shkresës nr. 15333/3 prot., datë 15.09.2024.
Plani strategjik dhe Plani vjetor janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 15333/2 prot., datë 16.10.2024, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, si dhe Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar.

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e DAB për vitin 2025.
Nga auditimi rezultoi se:
Në planin vjetor të auditimit për vitin 2025, miratuar me shkresën nr. 15333/1 prot., datë 16.10.2024, janë programuar për auditim drejtori brenda strukturës së bashkisë dhe institucione në varësi të saj.
Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, DAB ka realizuar 8 auditime kundrejt 8 auditimeve të planifikuara, pra plani vjetor është realizuar 100%, pasqyruar si më poshtë:

Nr.	Planifikuar	Nr	Subjekte të audituara nga DAB	Nr	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Përfunduar	Proces
					Përputhsh	Perform	Financ	IT	Kombin		
1	Zbatimi i rekomandimeve	1	Zbatimi i rekomandimeve	1	1					1	
2	Drejtoria e Integrimit Evropian, Projekteve të Huaja dhe Diasporës	1	Drejtoria e Integrimit Evropian, Projekteve të Huaja dhe Diasporës	1	1					1	

3	Klubi Shumësportësh "Flamurtari"	1	Klubi Shumësportësh "Flamurtari"	1					1	1	
4	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	1	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	1					1	1	
5	Qendra Kulturore e Fëmijëve	1	Qendra Kulturore e Fëmijëve	1	1					1	
6	Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit	1	Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit	1					1	1	
7	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	1	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	1	1					1	
8	Detyrimet e prapambetura	1	Detyrimet e prapambetura	1					1		
		8	**Totali**	**8**	**4**	**0**	**0**	**0**	**4**	**7**	**1**

Burimi: DAB Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për aktivitetin e vitit 2025 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 284/1 prot., datë 09.02.2026.
Nga auditimi i raportimit për vitin 2025, rezultoi se janë dhënë 40 rekomandime gjithsej, të cilat janë të karakterit organizativ. Rekomandimet janë pranuar të gjitha, prej të cilave 36 rekomandime janë zbatuar dhe 4 janë në poçes zbatimi.

Nr	**Viti**	**Të dhëna sipas Raportimit**				**Sipas Raportimit**			
		Rekomandime të shprehura ne numër				**Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)**			
		Gjithsej në numër	**Pranuar**	**Zbatuar**	**Në proces**	**Gjithsej në numër**	**Zbatuar**	**Në proces**	**Pazbatuar**
1	2025	40	40	36	4				
TOTALI		**40**	**40**	**36**	**4**				

Burimi: DAB Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër rezultoi se për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Vlorë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit pika 3.1.3 ku citohet: *"Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit".*

Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB
Grupi auditimit duke patur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në vitin 2025, zgjodhi të auditojë dosjen e cila është vlerësuar nga DAB me nivel të mesëm dhe të lartë risku siç është: Dosja e auditimit të kryer në Klubin Shumësportesh "Flamurtari";
1.Dosja e auditimit e performancës dhe përputhshmërisë për subjektin Klubi Shumësportësh "Flamurtari".
Objektivi kryesor i subjektit të audituar konsiston në: Zbatimin e rregullave, procedurave dhe kërkesave ligjore nga punonjësit e Klubit Shumësportësh "Flamurtari".
Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezultoi se qëllimi i auditimit është:
Të ndihmojë subjektin që do të auditohet në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit.
Gjetja e konstatuar:
I. Nga auditimi u konstatua se nga ky sektor nuk është bërë identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut, në lidhje me programimin dhe realizimin e detyrave si dhe mungon Regjistri i Riskut.
Rekomandimi i lënë:
"Të bëhet identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut, në lidhje me programimin dhe realizimin e detyrave, si dhe të hartohet Regjistri i Riskut konform Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
II. Nga auditimi u konstatua se aktiviteti i Klubit Shumësportësh "Flamurtari" është mbështetur në rregulloren e brendshme në të cilën janë përcaktuar detyrat e personelit, por kjo rregullore nuk është përditësuar me ndryshimet e fundit.
Rekomandimi i lënë:
"Nga Klubi Shumësportësh "Flamurtari" të përpunohet dhe të përditësohet rregullorja e brendshme për stafin e saj. Si dhe të përcaktohen detyra të qarta, konkrete, të plota dhe praktike, për të mundësuar kontrollin dhe menaxhimin e realizimit të objektivave".

IV. Sipas informacionit verbal dokumentacioni për shpenzimet e kryera në sektorin e gjelbërimit ndodhet në drejtorinë e burimeve ekonomike, aty ku finalizohet veprimi.
Rekomandimi i lënë:
"Një kopje e dokumentacionit të mbahet nga sektori i gjelbërimit, për të dokumentuar më mirë punën e tij".

-Sa më sipër rezultoi se në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;
- DAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;
-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të manualit të auditimit të brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12.

<u>Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm.</u>
Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë, vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.
Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Vlorë ka hartuar "Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm", i cili rezultoi të jetë i miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë me shkresën nr. 4063 prot., datë 26.02.2026.
Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashkinë Vlorë në përputhje me ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit" e cila është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë me shkresën nr. 4063 prot., datë 26.02.2026.

<u>Dosjet e përhershme.</u>
Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësisë që auditohet. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se audituesit e brendshëm nuk kanë krijuar dosjet e përhershme të auditimit në mospërputhje me përcaktimet e bëra në manualin e auditimit të brendshëm ku përcaktohet se: "Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet". Dosja e përhershme duhet të përditësohet pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e saj. Dosja e përhershme mbahet në format elektronik ose të printuar, kjo në funksion të mundësive të DAB.

-Sa më sipër rezultoi se DAB në Bashkinë Vlorë nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 *"Dosja e Përhershme".*

<u>Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezultoi se:</u>
-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenet 12, 13 të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar;
-Për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Vlorë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të

Territorit si dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit;
-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;
- DAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;
-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;
- DAB në Bashkinë Vlorë nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 "Dosja e Përhershme".

III.2.2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2025.
Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025-2027, rezultoi se:
- Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për PBA 2025-2027 me urdhrin nr. 151, datë 16.05.2024, si dhe është përgatitur dhe miratuar kalendari i PBA 2025 - 2027 me VKB nr. 101, datë 05.01.2024 "Për miratimin e kalendarit të PBA 2023-2025", në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 33/1.
- Nga auditimi rezultoi se nuk janë mbajtur procesverbale lidhur me takimet e kryera nga Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe nuk ka gjurmë auditimi për të verifikuar nëse ky grup është mbledhur 4 herë, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 21 datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve", pika 2.1.4 ku citohet *"GMS-ja duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit... Vendimet e GMS-së duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike..."*
- Janë miratuar në Këshillin Bashkiak tavanet përgatitore për PBA 2025-2027 me VKB nr.27 datë 28.03.2024 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të PBA 2025-2027", në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 34/6.
- PBA 2025-2027, faza e parë është miratuar me VKB nr. 60, datë 10.07.2024 "Për miratimin e projekt dokumentit të parë të PBA 2025-2027".
- Tavanet përfundimtare të PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr. 65, datë 30.07.2024 "Për miratimin e tavaneve përfundimtare për PBA 2025-2027", në kundërshtim me përcaktimet në nenin 34/6 të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" , i ndryshuar.
- Faza e dytë e PBA 2025-2027 është miratuar me VKB nr. 89, datë 26.09.2024 "Për miratimin e programit përfundimtar të PBA 2025-2027".
Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetit vjetor janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "*Buxhetimit me pjesëmarrje*", ku janë mbajtur relacionet dhe protokollet përkatëse.
Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, rezultoi se për vitin 2025 për përgatitjen e PBA 2025-2027 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.111, datë 27.12.2024, si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo

fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 8/1 prot., datë 10.01.2025. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Vlorë.

Për hartimin e PBA 2025-2027 dhe buxhetit vjetor, rezultoi se janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, nga njësitë vartëse dhe nga drejtoritë e Bashkisë Vlorë në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, nga kërkesat e sektorëve të ndryshëm, që mbulojnë këto programe si dhe nga kërkesat e mbledhura në dëgjesa publike.

Në fazën përfundimtare të PBA, duke i'u referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investimet dhe të ardhurat.

Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.1 Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)+(601)	1,579,411	47.69	1,615,370	47.43	1,649,157	47.00
2	Shpenzime operative (602) (603) (604), (606), (609)	1,211,082	36.57	1,239,780	36.40	1,290,706	36.78
3	Shpenzime për investime (230-231)	**521,546**	**15.75**	550,972	**16.18**	569,201	**16.22**
	Totali	**3,312,039**	**100.00**	**3,406,122**	**100**	**3,509,064**	**100**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Janë respektuar kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 7, datë 25.02.2022 "Për një ndryshim të udhëzimit nr. 23, datë 30.7.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të NJQV, të udhëzimit plotësues nr. 2, datë 24.01.2025 "Për përgatitjen e PBA 2025-2027".

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2025

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore. Kështu për periudhën 2025-2027 Bashkia Vlorë ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2 Planifikimi i të ardhurave

Përshkrimi	Planifikimi 2025
Të ardhura tatimore	2,270,174,000
Të ardhura jotatimore	1,146,186,000
TOTAL	**3,416,360,000**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga pushteti qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan-buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës.
Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të Këshillit të Bashkisë.
Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*.
Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë dhe janë të raportuara periodikisht në MF. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.
Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.
Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuara sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2025, rezultoi se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Vlorë ka pësuar ndryshime nëpërmjet VKB-ve, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Vlorë.
U verifikuan situacionet mujore të rakorduara me Degën e Thesarit Vlorë dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave nga taksat dhe tarifat e bashkisë dhe nga grantet. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Vlorë janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Vlorë, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.
Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Tabela nr.3 Planifikimi i buxhetit për vitin 2025, Bashkia Vlorë *(000/lekë)*

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2025	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
	Të ardhurat		
1	Të ardhura të veta të trashëguara sipas rakordimeve me thesarin		
2	Të ardhura e vitit ushtrimorë	2,308,576	
3	Transferta e pakushtëzuar	877,759	
4	Transferta specifike	582,759	
	Shpenzimet		
1	Paga (600)		1,549,896
2	Sigurime (601)		253,275
3	Shpenzime (602)		941,438
4	Shpenzime (604)		37,586
5	-603		59,388
6	Fondi emergj + kontigj		95,588
7	Inv(230 +231)		831,923
8	Transferta 606		0

9	Tjera...		0
Totali i buxhetit		**3,769,094**	**3,769,094**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Rezultoi se buxheti i konsoliduar (Bashkia Vlorë dhe Njësitë e Varësisë) për vitin 2025 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në vlerën **3,769,041 mijë lekë**.

Përgjatë vitit 2025, kanë ndodhur 3 ndryshime buxhetore me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, veprime që tregojnë për planifikime jo optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Tabela nr.4 Ndryshimet buxhetore gjatë vitit 2025 *(000/lekë)*

Periudha Buxhetore	**Buxheti fillestar**		**Ndryshime gjatë viteve**		**Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve**			
	Nr. datë	**Vlera**	**Nr. Datë**	**Vlera**	**Pakësuar artikulli / shtuar artikulli**			
					Shtesa. Art.	**Shuma**	**Pakësim. Art.**	**Shuma**
Viti 2025	**Nr. 111 datë 27.12.2024**	3,769,094			231	20,308	231	-20,308
					231	2,000	231	-2,000
			Nr. 16 datë 22.02.2025	29,049	231	8,859	231	-8,859
					602	600	602	-600
			Nr. 24 datë 27.03.2025	1,646,457	602	1,000	602	-1,000
					231	450,200	231	-458,200
					602	8,000		
			Nr. 87 datë 30.10.2025	9,300				
					602	984		-984
Totali Viti 2025		**3,769,094**		**1,684,806**		**491,951**		**-491,951**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore të shpeshta përgjatë vitit buxhetor, tregon për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Vlorë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Vlorë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuara me Vendim të KB ose të diktuara nga transferta e deleguar nga pushteti qendror.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2025, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.5 Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2025

Art.	**Emërtimi**	**Plani progresiv**	**Fakti**	**%**
1	Paga (600)	1,697,509,477	1,310,801,390	77
2	Sigurime (601)	273,248,501	215,579,662	79
3	Shpenzime (602)	1,213,372,731	750,512,621	62
4	Shpenzime (603)	75,211,000	53,783,684	72
5	Shpenzime (651)	900,000	679,089	75
6	Shpenzime (604)	45,873,638	20,684,570	45
7	Transferta (606)	719,033,625	716,437,307	100
8	Shpenzime (166)	11,500,000	11,220,150	98
9	Inv. (230 +231)	2,621,406,713	756,533,344	29
10	Shpenzime (609)	95,588,000		0
	TOTAL	**6,753,643,685**	**3,836,231,817**	**57**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezultoi se për vitin 2025 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është në masën 57 % dhe realizimin më të lartë e ka artikulli 606 "Transfertat për buxhetet familjare dhe Individ" ku përfshihet ndihma ekonomike dhe PAK, ndjekur nga shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë shpenzimet për mallra e shërbime dhe transferta korente të brendshme.
Vihet re që për vitin 2025 transferta për investime (230-231) paraqiten me realizim 29 %, dhe mallra dhe shërbime të tjera (602) paraqiten më realizim 62 % pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët, ose ½ e fondit të planifikuar nuk shpenzohet, ç'ka tregon një planifikim jo të saktë të shpenzimeve për mallra dhe shërbimeve dhe transferta korente të brendshme.

Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.

Tabela nr.6 Buxheti sipas burimeve të financimit për vitin 2025

Nr.	Emërtimi	Viti 2025							
		Plani fillim Viti Sipas VKB	**Çelja në Thesarit sipas akt rakordimit**	**Fakti sipas aktrakordimit**	**Të ardhurat e veta**	**Grand**	**Trans. pakushtëz Spec.**	**Transf. Kushtëz. Funks Deleg.**	**Transf. Kushtëz për Inv.**
1	Paga (600)	1,643,115,000	1,534,245,000	1,310,801,390	292,861,832	548,644,859	415,393,708	53,900,991	
2	Sigurime (601)	264,137,000	249,678,000	215,579,662	48,415,332	90,201,638	67,980,725	8,981,967	
3	Shpenzime (602)	1,174,441,000	1,077,360,000	750,512,621	421,839,119	261,921,835	32,990,161	33,761,506	
4	Shpenzime (603)	75,211,000	69,095,000	53,783,684	43,306,944	10,476,740			
5	Shpenzime (651)	900,000	900,000	679,089	679,089				
6	Shpenzime (604)	37,586,000	21,468,000	20,684,570	16,000,000			4,684,570	
7	Transferta 606	3,181,000	3,181,000	716,437,307	1,769,500			714,667,807	
8	Shpenzime (166)	11,500,000	11,500,000	11,220,150	11,220,150				
9	Inv (230 +231)	2,148,241,000	913,099,000	756,533,344	300,607,817	11,200,933			444,724,594
10	Shpenzime (609)	95,588,000	0						
	Totali	**5,453,900,000**	**3,880,526,000**	**3,836,231,817**	**1,136,699,783**	**922,446,005**	**516,364,594**	**815,996,841**	**444,724,594**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

-Referuar tabelës së mësipërme, rezultoi se fondet e shpenzuara nga të ardhurat e veta kanë peshën më të lartë në burimet e financimit, në vlerën 1,136,699,783 lekë ose 30% të fondeve të shpenzuara për vitin 2025, për të vijuar me grandet në vlerën 922,446,005 lekë ose 24%, duke vijuar me transfertën e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 815,996,841 lekë ose 21%, transferta e pakushtëzuar specifike në vlerën 516,364,594 lekë ose 13% dhe me transfertën e kushtëzuar për investime në vlerën 444,724,594 lekë ose 11.6% të fondeve sipas burimit të financimit.

Transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara.
Buxheti nga transferta e kushtëzuar për vitin 2025 është realizuar në vlerën 815,996,841 lekë, ose 21% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2025, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar për funksionet e deleguara, e zënë transferta për familje dhe individ, paga dhe fonde të shpenzuara për transferime korente të brendshme.

Transferta e kushtëzuar për investime.
Buxheti nga transferta e kushtëzuar për investime për vitin 2025 është realizuar në vlerën 444,724,594 lekë, ose 11.6% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2025.

Transferta e pakushtëzuar specifike.
Buxheti nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2025 është realizuar në vlerën 516,364,594 lekë, ose 13% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2025, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative.

Të ardhurat e veta.
Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2025 është realizuar në vlerën 1,136,699,783 lekë, ose 30% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2025, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga, investime dhe shpenzime operative.

Grandet.
Buxheti nga transferta specifike për vitin 2025 është realizuar në vlerën 922,446,005 lekë, ose 24% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2025, ku peshën kryesore brenda transfertës specifike, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.
Me miratimin e buxhetit për vitin 2025 është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë dhe i kontigjencës në vlerën 95,588 mijë lekë, pra brenda nivelit 3% të fondit total të planifikuar, të cilat nuk janë përdorur përgjatë vitit.

Realizimi i investimeve.
Grupi i Auditimit të KLSH-së konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele të ulta në vitin 2025, konkretisht në masën 29%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Vlorë në fillim të vitit buxhetor planifikon proçedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën "a" në nenin 5, në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; Neni 47 në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak.
Për vitin 2025 Bashkia Vlorë me shkresën nr. 7447 prot., datë 19.05.2025, ka përcjellë në MF raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e parë të vitit 2025, me shkresën nr. 15197 prot., datë 18.09.2025 ka përcjellë në MF raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e dytë të vitit, si dhe me shkresën nr. 3437/1 prot., datë 20.02.2026 ka përcjellë në MF raportin vjetor të monitorimit të buxhetit. Nga auditimi u konstatua se raporti i monitorimit të 4 mujorit të parë është dërguar jashtë afatit, ndërkohë raporti i monitorimit 8 mujor dhe 12 mujor është dërguar brenda afateve të përcaktuara në UMF nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar", pika 270.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.
Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Vlorë, rezultoi se, është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, janë raportuar periodikisht në Këshillin Bashkiak dhe MF. Me fondet buxhetore 2025, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga ministritë e linjës sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA-të e periudhës përkatëse në bazë të shkresave të alokimit të fondeve.
Sipas raportimit të kryer, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2025-31.12.2025 ka ardhur duke u ulur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet ecuria e shumës së detyrimit përgjatë vitit 2025.

Tabela nr.7 Detyrimet e prapambetura për periudhën 2025

Detyrime	Detyrimi në 31.12.2024	Detyrimi i krijuar në 01.01.2025-31.12.2025	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2025	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2025
Investime	2,343,869	4,046,200	6,390,069	986,200	5,403,869
Investime nga FZHSH					
Mallra dhe shërbime	6,178,960	65,406,510	71,585,470	4,589,200	66,996,270
Vendime gjyqësore					
Të tjera					
Totali	**8,522,829**	**5,575,400**	**72,399,660**	4,589,200	**72,399,600**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që ka Bashkia Vlorë ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare 2025 si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.
-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2025, përcjellë në MF me shkresën nr. 24312 prot., datë 18.03.2025, rezultoi se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Vlorë ndaj palëve të treta raportuar në MF është në vlerën 72,399,660 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, shpenzime kapitale dhe vendime gjyqësore.
Për efekt krahasimi dhe mosrakordimit të detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2025 për sa raportuar nga bashkia, sa paraqitur në pasqyrat financiare dhe SIFQ tabela si më poshtë:

Tabela nr.8 Situata Financiare 2025

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	**Borxhe (a+b)**			
a	**Hua afatgjatë**			
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
b	**Hua afatshkurtër**			
b.1	Hua			
b.2	Overdrafte			
b.3	Kreditë furnitorëve			
II	**Detyrime (a+b+c)**	**72,399,660**		2.81%
a	**Shpenzime korrente**	66,996,270		
a.1	Mallra dhe shërbime	20,653,897		
a.2	Paga dhe sigurime	13,137	**2,575,510,356**	
a.3	Të tjera	46,342,373		
b	**Shpenzime kapitale**	**5,403,390**		
b.1	Institucione buxhetore	5,403,390		
b.2	Subjekte private			
c	**Vendime gjyqësore**			
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
III	**Totali (I+II)**	**72,399,660**	**2,575,510,356**	**2.81%**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

-Në vijim parashtrojmë përcaktimet e bëra për detyrimet e prapambetura, çfarë përfaqësojnë dhe cilat detyrime përfshihen:
"Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta", nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontratë, faturë ose sipas ligjit".
"Detyrimet e prapambetura regjistrohen në llogarinë ekonomike nr. 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura"[4].
"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore 2025, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë nr. 486 në debi të llogarisë nr. 467 "Kreditorë të ndryshëm për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në llogari në datën 31.12.2025"[5].
-Pra sa më sipër vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura të raportuara në MF është në masën 2.81 % ndaj totalit të shpenzimeve të miratuara për vitin 2025.
Stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta paraqitet më pak se 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara, ç'ka do të thotë se Bashkia Vlorë në fund të vitit 2025 rezultoi në një situatë normale**.**

[4] Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme".
[5] Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar".

Detyrimet nga vendimet gjyqësore.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2025 nuk ka detyrime nga vendimet gjyqësore. Përgjatë vitit 2025, janë kryer likuidime të vlerës së detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2025, në vlerën 16,697,656 lekë.

Shpronësimet për interes publik.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës rezultoi se ndaj Bashkisë Vlorë është krijuar detyrimi për shpronësimin e 9 subjekteve në vlerën 28,504,972 lekë, e cila është likuiduar. Më poshtë pasqyrohet në formë tabelore vlera e shpronësimit për çdo subjekt.

Tabela nr.9 Vlera e shpronësimit për çdo subjekt

Nr.	Nr./Datë	Emërtime	Vlera
1	267/ 04.04.2025	Shpronësim për zbatim rigjenerim urban i shëtitores qendrore të Vlorës sheshi Isa Boletini	1,580,165
2	268/ 04.04.2025	Shpronësim për zbatim rigjenerim urbani shëtitores qendrore të Vlorës sheshi Isa Boletini	7,250,669
3	271/ 04.04.2025	Baliff officer shpronësim për zbatim rigjenerim urbani shëtitores qendrore të Vlorës	6,131,386
4	460/ 09.05.2025	Shpronësim për zbatim menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta të rajonit Vlorë	824,364
5	534/ 29.05.2025	Shpronësim rikualifikim i bllokut të kufizuar nga bulevardit Çamëria rruga Pelivan Leskaj, Piro Sava	1,509,534
6	574/ 03.06.2025	Shpronësim për zbatim menaxhim i integruiar i mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës	326,400
7	838/ 23.07.2025	Shpronësim për zbatim rigjenerim urbani shëtitores qendrore të Vlorës	1,030,334
8	899/ 08.08.2025	Shpronësim me projektin vija bregdetare e qytetit të Vlorës	9,158,520
9	898 06.08.2025	Shpronësim për zbatim menaxhim i integruar i mbetjeve të ngurta të rajonit Vlorë	693,600
Total			28,504,972

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Faturat e palikuiduara.

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 60 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Vlorë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, rezultoi se për vitin 2025, ky afat nuk është respektuar në 4 raste për vlerën 38,013,266 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë[6].

Tabela nr.10 Përmbledhëse e faturave për vitin 2025

Artikulli	Sasia	Viti 2025/lekë
230-231-602	4	38,013,266

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Për periudhën deri në fund të vitit 2025 janë 137 fatura të palikuiduara për shpenzime për shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën 72,386,523 lekë.

-Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 60 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Konkluzioni.

- Buxheti i Bashkisë Vlorë dhe PBA 2025-2027, në përgjithësi është miratuar në përputhje kuadrin rregullator në fuqi;
- Për PBA 2025-2027 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar, pasi nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;
- Nga auditimi rezultoi se nuk janë mbajtur procesverbale lidhur me takimet e kryera nga Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe nuk ka gjurmë auditimi për të verifikuar nëse ky grup është mbledhur 4 herë, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 21 datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve", pika 2.1.4 ku citohet "*GMS-ja duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit... Vendimet e GMS-së duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike...*"

[6] Tabela analitike nr.11 është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Buxheti është miratuar jashtë afatit të përcaktuar në pikën 97 të Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit", i ndryshuar.
- Tavanet Përgatitore dhe përfundimtare të PBA-së 2025-2027, janë miratuar jashtë afateve;
- Kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), të cilat në çdo rast janë miratuar me VKB;
- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë proçesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;
- Për PBA 2025-2027 nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë proçesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxhetit vjetor, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga drejtorët e drejtorive të Bashkisë Vlorë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;
- Për vitin 2025 në krahasim me planet vjetore, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është mesatarisht në masën 57%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 "Transferta për Buxhet Familjar dhe Individ", duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore si dhe realizimin më të ulët e ka artikulli 604. Vihet re se për vitin 2025 artikulli (203-231) shpenzime për investime paraqiten 29%, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.
- Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 60 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Vlorë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2025, ky afat nuk është respektuar në 4 fatura për shpenzime për investime dhe shpenzime korrente në vlerën 38,013,266 lekë.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi z. H.H, Drejtor i komanduar i Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave, evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive për vitin buxhetor.

Në zbatim të pikës 2, të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1) Evidencat analitike të llogarive debitore për taksat dhe tarifat vendore.
2) Akt rakordimi me Degën e Thesarit Vlorë për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.
3) Evidencat e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare.
4) Të tjera dokumente për arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifat vendore.
5) Vendimin e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale.
6) Vendimet e Kryetarit të Bashkisë për strukturën organike.

Burimi i krijimit të të ardhurave për vitin 2025.

Për vitin 2025, burimet e financimit të Bashkisë Vlorë paraqitet në vlerën totale prej **7,810,385 mijë lekë**, dhe ndahen në 3 kategori:

- Të ardhurat nga burimet e veta; 3,404,359 mijë lekë;
- Transferta nga Buxheti Qendror; 2,037,538 mijë lekë;
- Trashëgimi nga viti i shkuar; 1,107,737 mijë lekë;
- Buxheti i Shtetit 1,260,751 mijë lekë.

Trajtuar si më poshtë vijon:

a) Të ardhura nga burimet e veta *(zënë 4.06 % të të ardhurave të përgjithshme).*

Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Vlorë, paraqitet në masën 147.46%, ose nga vlera 2,308,523 mijë lekë të parashikuara është realizuar vlera 3,404,359 mijë lekë, me tejkalim të planit në vlerën 1,095,836 mijë lekë. Në krahasim me faktin e vitit 2025 në përqindje është 47.46 % më i lartë, në vlerë absolute është 1,095,836 mijë lekë.

Planifikimi për vitin 2025 është 58.2 % më i lartë se realizimi faktik për vitin 2024, në vlerë absolute 850,006 mijë lekë më i lartë.

b) Transferta nga buxheti qendror në vlerën 2,037,538 mijë lekë *(zënë 26.08.% të ardhurave të përgjithshme).*
c) Të ardhurat e trashëguara nga viti i 2024 në vlerën 1,107,737 mijë lekë *(zënë 14.18 % të ardhurave të përgjithshme).*
e) Buxheti i shtetit në vlerën 1,260,751mijë lekë *(zënë 16.14 % të ardhurave të përgjithshme).*

Struktura e Drejtorisë së të Ardhurave Bashkia Vlorë (DAV).
Veprimtaria e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore mbështetet në Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; VKB-të për këtë qëllim si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Për vitin 2025 me VKB nr. 111, datë 27.12.2024 është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr. 8/1 prot, datë 10.01.2025. Me vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 792 prot., datë 17.01.2025 është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/sektorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, si më poshtë vijon:
Drejtoria e të Ardhurave Vendore (*këtu e vijim DAV*), ka patur në përbërjen e saj **46** punonjës, 1 Drejtor, 4 Përgjegjës Sektori dhe 41 specialistë/inspektor/operator për taksat dhe tarifat vendore/faturist[7].
Për vitin 2025, pranë Bashkisë Vlorë ka funksionuar DAV, struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Vlorë nga taksat dhe tarifat. Kjo drejtori në aktivitetin e saj për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave duhet të bashkëpunojë edhe me drejtori/sektor të tjerë pranë bashkisë, si ai i pronave, urbanistikës, infrastrukturës, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit/faturës për arkëtim/sipas rastit ndjekja e arkëtimit, si dhe roli i DAV është kryesisht në hartimin dhe përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore, ndjekjen e arkëtimit/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

Strukturat të tjera për mbledhjen e të ardhurave në territorin që administron Bashkia Vlorë janë:
- Drejtoria e Planifikimit Kontroll dhe Zhvillimit Territorit (DPKZHT);
- Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve (DPPMA);
- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (NSHP);
- Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit (DFBK),
- Drejtoria e Infrastrukturës, institucionet vartëse, agjentët tatimorë.

Taksat dhe tarifat e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Vlorë.
Për vitin 2025, Paketa Fiskale e Bashkisë Vlorë është miratuar me VKB nr. 96, datë 07.12.2023, "Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2025", i ndryshuar me VKB nr. 105 datë 18.12.2024. Mbështetur në Paketën Fiskale të mësipërme në Bashkinë Vlorë, janë aplikuar/mbledhur 27 lloje taksash dhe tarifash.
Për vitin 2025 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Vlorë dhe Njësitë Administrative, ndahen në 3 kategori:
1.Biznes;
2.Familjar;
3.Institucione.
Kategoritë e mësipërme (përjashtuar institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:
-Kategoria e parë ndahet në biznes i madh dhe biznes i vogël.
-Kategoria e dytë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim banesa private, toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

[7] Struktura e DAV Bashkia Vlorë është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Tabela nr.12 Subjektet mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore

Nr.	Lloji	2025
1	Biznesi i Madh	2539
2	Biznesi i Vogël	6486
3	Institucione	47
	Total	**9072**

Burimi: DAV Bashkia Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Veç taksave dhe tarifave të mësipërme Bashkia Vlorë ka planifikuar dhe arkëtuar të ardhura nga disa lloje burimesh të ndryshme, si gjoba nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Policia Bashkiake etj[8].

Për vitin 2025, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 2,308,523 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 3,404,359 mijë lekë ose 147% më shumë se planifikimi.
Në analizën e realizimit dhe mos realizmit të treguesve, konstatohet se shumë lloje taksash paraqiten me mbi realizim, ç'ka nënkupton një planifikim jo real dhe të saktë të nivelit të ardhurave dhe të bazuar në të dhëna korrekte, konkretisht:
- Taksë për kalimin e së drejtës së pronësisë, është realizuar 63,282 mijë lekë nga 30,000 mijë lekë të planifikuara ose në masën 211%.
- Taksë e fjetjes në hotel, është realizuar 74,804 mijë lekë nga 47,220 mijë lekë të planifikuara ose në masën 158%.
- Taksë e ndikimit në infrastrukturë, është realizuar në vlerën 1,845,891 mijë lekë, nga 613,000 mijë lekë të planifikuara ose në masën 301%
- Taksa mbi të ardhurat personale, është realizuar 64,670 mijë lekë nga 46,910 mijë lekë të planifikuara ose në masën 138%.
- Tarifë shërbimi për subjektet me aktivitet ndërtimi, është realizuar 310,698 mijë lekë nga 27,000 mijë lekë të planifikuara.

Ndërsa me mosrealizim janë zërat:
- Taksë pasurie e paluajtshme tokë bujqësore, është realizuar në vlerën 19,780 mijë lekë nga 40,337 mijë lekë ose në masën 49 %.
- Të ardhura nga aplikimi i gjobave dhe debitorëve, është realizuar në vlerën 132,468 mijë lekë nga 358,283 mijë lekë të planifikuar, ose në masën 37%.
- Të ardhura nga qiratë (mjete + godinë + tokë), është realizuar në vlerën 999 mijë lekë nga 39,727 mijë lekë të planifikuar, ose në masën 3%.
- Tarifë për leje dhe certifikata transporti, është realizuar në vlerën 9,659 mijë lekë nga 21,328 mijë lekë të planifikuar, ose në masën 45%.

Duke krahasuar të dy periudhat vitin 2024 dhe vitin 2025, konstatohet një rritje si në planifikim për vlerën 415,251 mijë lekë, po ashtu dhe në arkëtim për vlerën 1,993,058 mijë lekë.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.
Sa më sipër: "*Evidenca e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2025*" dhe "*Vlerësimi i gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat/tarifat vendore*", sipas strukturës së Paketës Fiskale të miratuar nuk janë të plota, pasi mungon gjurma e auditimit mbi vlerësimin e gjendjes së debitorëve të krijuar për gjithë taksat/tarifat vendore.

[8] Tabela analitike nr.13 "Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2025" është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me: Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 4, pika 7, nenet 20-25 në Kreun IV; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar neni 5, neni 1; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar neni 4, pika 7, nenet 20-25 në Kreun IV; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, neni 5 "Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore", neni 12, neni 54/c "Raportimi financiar".

Debitorët sipas kategorive të tyre.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2025 (të trashëguar nga vitet e mëparshme) – 31.12.2025 (krijuar brenda vitit, si dhe në mënyrë progresive në fund të vitit 2025).

Nr.	Emërtim i taksës/tarifës vendore	Çelja 01.01.2025	Pagesat e kryera gjatë vitit 2025 për llogari të gjendjes së debitorëve progresiv në datën 31.12.2024	Vlera e debitorëve të rinj, krijuar vetëm gjatë vitit 2025, nga mos pagesa e detyrimeve të vitit 2025	Detyrimi progresiv i debitorëve më 31.12.2025
1	Debitor në vite	2,495,699			2,495,699
2	Debitor pulla	397,000		255,000	652,000
3	Vërtetime rajone	658,400	101,000		557,400
4	Bileta tregu	30,600			30,600
5	Debitor Klsh	8,680,526			8,680,526
6	Gjoba IMTV	428,090,000	7,362,000	27,656,000	448,384,000
7	Njësia Nevosela	7,238,201			7,238,201
8	Njësia Orikumi	15,922,745			15,922,745
9	Njësia Shushicë	1,041,663			1,041,663
10	Njësia Qendër	895,111			895,111
11	Gjoba Policia	216,000	8,211,708	8,211,708	216,000
12	Debitor tatimet	491,582,652		34,110,620	525,693,272
13	Legalizimet	98,414,672	3,093,527	3,566,759	98,887,904
14	Ujësjellësi	191,756,541	24,227,854		167,528,687
	TOTALI	**1,247,419,810**	**42,996,089**	**73,800,087**	**1,278,223,808**

Burimi: DAV Bashkia Vlorë, Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme rezultoi se:
-Në fillim të vitit 2025 vlera debitore për taksa, tarifa, gjoba dhe qira është në vlerën 1,246,580,122 lekë;
-Përgjatë vitit 2025 është krijuar 73,800,087 lekë vlerë debitore gjithsej;
-Në fund të vitit 2025 vlera debitore progresive është 1,278,223,808 lekë, pra me një rritje të konsiderueshme në krahasim me fillimin e vitit 2025.
Situata e mësipërme tregon një punë të dobët të Bashkisë Vlorë në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.

Taksat dhe tarifat e biznesit.
Në Bashkinë Vlorë subjektet ngarkohen me detyrime vendore për taksën mbi truallin, pasuri, pastrim, ndriçim, tarifën e gjelbërimit etj. Në tabelën në vijim paraqiten detyrimet e subjekteve në fund të vitit 2024, shtesat dhe pakësimet gjatë vitit 2025 si dhe detyrimi në fund të periudhës 2025.

Tabela nr.14 Subjektet debitor nga 01.01.2025 deri më datë 31.12.2025

Nr.	Lloji i debitorëve	Debitor deri më 31.12.2024	Shtesa 2025	Pakësime 2025	Kamatëvonesa 2025	Debitor deri më 31.12.2025
1	Biznesi vogël	324,697,550	266,001,433	246,167,085	11,843,193	356,375,091
2	Biznes i madh	152,946,523	157,228,216	168,203,836	4,926,598	146,897,501
1+2	Total	**477,644,073**	**423,229,649**	**414,370,921**	**16,769,791**	**503,272,592**

Burimi: DAV Bashkia Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Debitorët "Biznes" të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, si dhe mosmarrja e masave ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.
Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga DAV, rezultoi se deri në 31.12.2024 kanë qenë debitor në vlerën 477,644,073 lekë.

Për vitin 2025 janë krijuar debitorë në vlerën 25,628,519 lekë.

-Në fund të vitit 2025 në mënyrë progresive rezultojnë debitor subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 503,272,592 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të paarkëtuara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.
-Në fund të vitit 2025 në krahasim me fillimin e vitit 2024, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje.

Taksat dhe tarifat familjare.
Në Bashkinë Vlorë familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit, gjelbërimit e ndriçimit dhe taksën e ndërtesës. Këto detyrime mblidhen nëpërmjet agjentit tatimor Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë (SHRUK Vlorë) në bazë të VKB nr. 96 datë 07.12.2023, “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundërvajtësve”, i ndryshuar me VKB nr. 3 datë 17.01.2025 me të cilin ka lidhur akt-marrëveshje me nr. 6494 prot., datë 16.07.2018.
Lidhur me tarifat për pastrim/gjelbërim/ndriçim për këtë kategori, bashkia ka marrë të mirëqenë vlerat e arkëtuara nga SHRUK Vlorë dhe nuk ka asnjë të dhënë për të bërë përllogaritjet e saj.
Sa i takon të dhënave të mbajtura lidhur me të ardhurat që depozitohen nga SHRUK Vlorë, rezultoi se deri më datë 31.12.2025, SHRUK Vlorë ka ndaj Bashkisë Vlorë detyrime në vlerën 167,743,479 lekë.
Gjithashtu theksojmë se tarifën e shërbimit 3% si agjent tatimor SHRUK Vlorë e ka zbritur dhe e ka mbajtur direkt nga shumat e arkëtuara nga qytetarët, sipas marrëveshjes me nr.13330 prot., datë 22.12.2022 Bashkia Vlorë dhe nr. 3380 prot., datë 20.12.2022 SHRUK Vlorë për rolin e agjentit tatimor.
Pra shuma prej 167,743,479 lekë është arkëtuar nga qytetarët dhe nuk është derdhur për llogari të Bashkisë Vlorë, e cila është e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKB nr. 79 prot., datë 02.12.2021 pika 2/e dhe VKB nr. 95 prot, datë 23.12.2022 dhe nr. 96, datë 07.12.2023 pika 1, procedura e ndjekur është në kundërshtim me pika 7 e nenit 4, të Ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, si dhe marrëveshjes ndërmjet palëve Bashkia Vlorë dhe SHRUK Vlorë për rolin e agjentit tatimor.

Planifikimi dhe arkëtimi i taksës së tokës bujqësore për vitin 2025.
Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, si më poshtë:

Tabela nr.15 Vlera e taksës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit.

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas Ligjit (lekë/ha/vit)
I	5,600
II	4,900
III	4,200
IV	3,600
V	3,000
VI	2,400
VII-X	1,800

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Me VKB nr. 96, datë 07.12.2023 “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundërvajtësve”, janë miratuar nën kategorizimet për taksën e tokës bujqësore të cilat ndryshojnë nga një njësi administrative në tjetrën dhe po ashtu brenda njësive administrative sipas fshatrave.
Referuar VKB nr. 96, datë 07.12.2023 “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundërvajtësve”, përgjegjësinë për vjeljen e kësaj takse e kanë specialistët e DAV në NJA si dhe Sektori i Menaxhimit të Tokës Bujqësore për qytetin.
Të dhëna për tokën bujqësore sipas njësive administrative paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela nr.16 Të dhëna për tokën bujqësore në Bashkinë Vlorë

Nr.	Njësitë Administrative	Sipërfaqe tokë bujqësore (ha)	Tokë e ndarë me AMTP	Tokë në pronësi të bashkisë (ha)	Tokë e dhënë me qira nga sip. në pronësi (ha)
1	Vlorë	434	434	0	0
2	Orikum	2407	2407	0	0
3	Novoselë	6524	5784	739	211
4	Qendër	4156.1	0	0	0
5	Shushicë	2845	2445	400	87.64
	Totali	**16,366.1**	**11,070**	**1,139**	**298.64**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Referuar të dhënave të mësipërme në Bashkinë Vlorë sipërfaqja e tokës bujqësore është 16,366.1 ha. Nga kjo sipërfaqe është ndarë me AMTP sipërfaqe prej 11,070 ha, e cila është dhe sipërfaqja për të cilën familjet që e kanë në pronësi kanë detyrimin për taksën e tokës bujqësore.

Nga auditimi i procesit të planifikimit dhe arkëtimit të taksës së tokës bujqësore për vitin 2025, u konstatua se:

- *Nuk ka koordinim nga një strukturë në bashki mbi grumbullimin e informacionit për debitorët e taksës së tokës bujqësore nga NJA dhe në përfundim të vitit këto të dhëna të përpunohen dhe të jenë në nivel bashkie si dhe të jenë pjesë e borxhit tatimor.*

Tabela nr.17 Detyrimi për taksën e tokës bujqësore viti 2025

Nr.	Njësitë Administrative	Debitor 31.12.2024		Borxhi i krijuar 2025		Progresiv 31.12.2025	
		Nr. Familjeve	Vlera	Nr. Familjeve	Vlera	Nr. Familjeve	Vlera
1	Vlorë	5,191	3,211,890				3,211,890
2	Orikum	3,227	45,312,423		4,634,499		49,946,922
3	Novoselë	5,880	103,104,912		8,787,150		111,892,062
4	Qendër	4,090	107,053,861				107,053,861
5	Shushicë	4,430	42,170,000		3,900,000		8,117,000
	Totali	**22,818**	**300,853,086**		**17,321,649**		**318,174,735**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga auditimi konstatohet se detyrimi që familjet kanë për taksën e tokës bujqësore në Bashkinë Vlorë i krijuar gjatë vitit 2025 është në vlerën 17,321,649 lekë dhe borxhi progresiv më datë, 31.12.2025 është 318,174,735 lekë, që përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Referuar të dhënave të tabelave të mësipërme rezultoi se debitorët e taksës së tokës kanë ardhur duke u rritur, ç'ka tregon se puna e Sektorit të Menaxhimit të Tokës dhe e NJA-ve nuk është në nivelet e duhura, pasi ka munguar përgjegjësia dhe vëmendja e duhur për vjeljen e taksës së tokës bujqësore, gjë të cilën e tregon niveli i lartë i debitorëve nga viti në vit.

Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet, kur individët paraqiten në Bashki apo NJA në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifat vendore apo për të marrë shërbime dhe nga DAV ju mbahet edhe taksa e tokës. Edhe njoftimet për detyrimet periodike bëhen për ato raste për të cilat NJA ka të dhëna, pasi konstatohet se si pasojë e shumë transaksioneve të kryera me pasuritë, NJA nuk ka më informacion të saktë për pronarët e tokës.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi: z. S.H me detyrë Administrator në NJA Orikum, z. G.F me detyrë Administrator në NJA Qendër, z. K.SH me detyrë Administrator në NJA Novoselë dhe z. B.A me detyrë Administrator në NJA Shushicë, për mos marrjen e masave të mjaftueshme për arkëtimin e taksës së tokës për vitin 2025 sipas përcaktimeve në VKB nr. 96, datë 07.12.2023, "Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2025", i ndryshuar; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 24; Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35.

<u>Taksa e fjetjes në hotel.</u>

Për vitin 2025 taksa e fjetjes në hotel paraqitet me realizim në vlerën 74,804 mijë lekë, ose 158 % e planifikimit. Nga auditimi u konstatua se, aplikimi i taksës bëhet sipas deklarimeve të vetë subjekteve. Këto mangësi bëjnë që kjo taksë të mos jetë arkëtuar saktë për numrin e personave që akomodohen në strukturat akomoduese të Bashkisë Vlorë, kryesisht kjo në sezonin veror

ku numri i personave që akomodohen në hotele është më i lartë, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Vlorë, pasqyruar si më poshtë.

Debitor deri në 2025	Subjekte	Debi 31.12.2024	Faturuar 2025	Kamatëvonesë	Paguar 2025	Diferenca
Gjithsej	264	24,079,770	50,369,176	-	35,027,844	39,421,103

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të kësaj takse rezultoi se DAV ka të regjistruar 264 hotele dhe njësi akomoduese, si dhe për vitin 2025 janë arkëtuar 35,027,844 lekë dhe në fund të periudhës progresive deri në 31.12.2025 vlera debitore është 39,421,103 lekë, të cilat janë të kontabilizuara dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Gjithashtu, nga DAV nuk janë bërë përpjekje për të verifikuar nëpërmjet faqeve të internetit për rezervime online të hoteleve si një mënyrë për të kontrolluar nëse ka hotele apo njësi të tjera akomoduese që japin dhoma me qira dhe nuk janë të regjistruara për t'i paguar bashkisë taksën e fjetjes në hotel sipas përcaktimeve të VKB për miratimin e taksave dhe tarifave vendore.

Për situatën e mësipërme, hotelet për të cilat administrohet informacion dhe kanë rezultuar me problematikë në arkëtimin e tyre, mbanë përgjegjësi *z. F.LL, me detyrë Drejtor i Komanduar i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për periudhën Korrik - Dhjetor 2025.*

Procedurat e ndjekura për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e infrastrukturës së ndërtimeve informale që ndodhen në territorin e Bashkisë Vlorë.

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet e reja rezultoi se, nga legalizimet e bëra ndër vite nuk kanë paguar detyrimin në periudhën 2015-2024 për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ish-ALUIZNI, gjithsej 2322 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara me vlerë totale të detyrimeve **97,595,326 lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Për vitin 2025, rezultoi se janë debitorë ndaj bashkisë **100** qytetarë me vlerë totale **3,511,157 lekë,** të dhëna të cilat paraqiten në tabelën si vijon:

Tabela nr.18 Detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet 2015-2025

Viti	Numri	Vlera
2015	26	639,709
2016	242	6,230,630
2017	430	15,674,135
2018	296	8,949,989
2019	137	3,761,598
2020	240	6,738,681
2021	434	13,284,459
2022	380	11,076,841
2023-2024	37	27,728,127
Totali	***2222 (2015-2024)***	**94,084,169**
2025	**100**	**3,511,157**
Totali progresiv	**2322**	**97,595,326**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezultoi në **97,595,326 lekë** ndaj **2322** objekte të legalizuara, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Asnjë nga strukturat e Bashkisë Vlorë nuk ka marrë masa për të rritur nivelin e arkëtimeve lidhur me këtë taksë. Gjithashtu, Drejtoria e Urbanistikës nuk ka përcjellë në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit informacion lidhur me detyrimet që kanë ndaj bashkisë qytetarët që kanë përfituar nga procesi i legalizimit. Si rezultat këto detyrime nuk janë të kontabilizuara. Të dhëna lidhur me numrin e debitorëve nuk dërgohen as në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore/Sektori i Borxhit i cili nuk ka informacion lidhur me numrin e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë si dhe vlerën progresive të borxhit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; VKB nr. 96, datë 07.12.2023, "Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2025", i ndryshuar.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi: *z. K.M, me detyrë Drejtor i Urbanistikës për periudhën nga data 01.01.2025 deri më datë 03.03.2025, z. Z.S, me detyrë Drejtor i Urbanistikës për periudhën nga data 03.03.2025 deri më datë 17.07.2025, z. O.D me detyrë Drejtor i Urbanistikës për periudhën nga data 17.07.2025 deri më datë 03.10.2025, z. I.XH me detyrë Drejtor i Urbanistikës për periudhën nga data 03.10.2025 deri më datë 31.12.2025.*

Për tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Vlorë.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Vlorë mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar;

-Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar;

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar;

-VKB për miratimin e paketës fiskale, përkatësisht VKB nr.96, datë 07.12.2023, i ndryshuar, për vitin 2025;

-Dosjet e licencimit të subjekteve për periudhën 01.01.2025-31.12.2025;

-Gjithashtu u kryqëzua informacioni me databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI), Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Referuar kuadrit rregullator të fushës, rezultoi se subjektet që aplikojnë për t'u pajisur me autorizim për tregtimin e karburantit, kanë detyrimin që të paguajnë tarifën në vlerën 1,000,000 lekë për 5 vite. Struktura e ngarkuar në Bashkinë e Vlorës, për shqyrtimin e aplikimeve, faturimin dhe ndjekjen e arkëtimit është Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike.

Sa më sipër, grupi i auditimit i'u drejtua me kërkesë Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike për të vendosur në dispozicion databazën me subjektet që ushtrojnë aktivitet "Tregtim karburanti", licencimet e kryera në vitin 2025, faturimin dhe arkëtimin e tarifës përkatëse, si dhe debitorë të krijuar përgjatë vitit 2025 dhe të trashëguar nga vitet e mëparshme.

Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm, rezultoi se në Bashkinë Vlorë, për vitin 2025 ushtrojnë këtë aktivitet 40 subjekte[9].

-Rezultoi se 18 prej subjekteve të mësipërme ushtrojnë aktivitet të pa licensuar dhe për rrjedhojë nuk kanë paguar vlerën e tarifës së licencimit 1,000,000 lekë për stacion të tregtimit të karburantit[10].

-Sa më sipër detyrimi total për subjektet që kanë ushtruar aktivitet "Tregtim Karburanti" pa licencë është në vlerën 18,000,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

-Me qëllim licencimin e tyre, rezultoi se jo të gjithë subjektet janë njoftuar. Konkretisht, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, Bashkia Vlorë, përgjatë vitit 2025 ka dërguar shkresat e njoftimit për 15 subjekte, ndërkohë nuk ka njoftuar subjektet: "2A-O"; "D.T" dhe "J.P".

-Pra sa më sipër rezultoi se përgjatë vitit 2025 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për marrjen e masave shtrënguese ndaj këtyre subjekteve, si dhe Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e

[9] Tabela nr.19 "Subjektet me aktivitet tregtim karburanti" është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

[10] Tabela nr.20 "Subjektet me aktivitet tregtim karburanti pa licencë" është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar.
Gjithashtu nga kryqëzimi i databasës së Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, Qendrës Kombëtare të Biznesit, me databazën e Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, rezultoi se janë 4 subjekte të cilat ushtrojnë aktivitet "Tregtimi Karburanti", për të cilët struktura Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike nuk administron informacion/dokumentacion. Subjektet janë pasqyruar si më poshtë vijon:

Tabela nr.21 Subjekte pa informacion/dokumentacion

Nr.	Subjekti	Adresa	NIPT
1	S.A	Sherisht	K
2	G	Tërbaç	K
3	V.G	Nartë	L
4	C.O	Pusi i Mezinit	K

Burimi: Databasa ISHTI, DPM, QKB, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Konstatohet se në fund të vitit 2025 rezultojnë debitor 6 subjekte për vlerën 5,000,000 lekë. Vlera debitore është e krijuar në vitet e mëparshme, pasi për vitin 2025, subjektet që janë pajisur me autorizimin për tregtimin e karburantit, kanë kryer likuidimin në vlerën 1,000,000 lekë/autorizim.

Tabela nr.22 Subjektet debitorë për tarifën e autorizimit të tregtimit të karburantit

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i autorizimit	Detyrimi
1	B.S	K	2019-2024	1,000,000
2	A.B	L	2019-2024	800,000
3	D.T	K	2019-2024	1,000,000
4	J 2	K	2019-2024	1,000,000
5	J.P	L	2019-2024	200,000
6	V.P	K	2025-2030	1,000,000
Total				**5,000,000**

Burimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, Bashkia Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se administrohen shkresa për njoftimin e likuidimit të detyrimit për 3 subjekte, ndërkohë për subjektet "A.B" "V.P", si dhe "J.P", nuk administrohet dokumentacion.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, znj. D.F, me shkresën nr.739/8 prot., datë 17.09.2026 është paraqitur observacion, konkretisht:
Pretendimi i Subjektit: Konkretisht lidhur me qëndrimin e grupit të auditimit për:
Tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Vlorë.
Pajisjen me autorizim të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si Lavazh
Sqaroj se grupi i auditimit në konstatimet e veta nuk ka marr në konsideratë detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike. Kjo Drejtori sipas praktikës dhe veprimtarisë së saj pajis me licenca apo autorizime subjektet të cilat bëjnë kërkesë, plotësojnë dokumentacionin dhe paguajnë tarifën e miratuar. Në dijeni time nga Drejtoria është derguar shkresë dhe tek lista e subjekteve që ka qenë e administruar në të dhe tek Drejtoria e Tatim Taksave por nuk është kjo drejtori përgjegjëse për kontrollin në terren të tyre dhe mbledhjen e taksave. Lidhur me verifikimin e shkresave duke qenë se nuk jam më pjesë e Bashkisë Vlorë e kam të pa mundur aksesin në to. Dokumentacionin e kam len në dorëzim të drejtorisë në kohën e largimit. Dua të theksoj se as unë dhe as specialistja që ka pas detyrën të kryej shqyrtimin e dosjeve për licencim nuk kemi asnjë përgjegjësi lidhur me vjeljen e taksës që citohet në akt konstatimi dhe as nuk kemi pas detyrë të marrim masa shtrënguese. Pra nuk mund të tejkalonim kompetencat tona funksionale. Nëse nga Drejtoria do të ishte lëshuar autorizim pa kryer pagesën e taksës dhe dokumentacionet përkatëse për licencim atëherë po mund të ekzistonte një shkelje por në rastin e mos paraqitjes së subjekteve nuk është përgjegjësi e saj po e enteve të tjera kontrolluese. Grupi i auditimit duhet të kryente një kontroll më të detajuar, qoftë edhe duke kërkuar sqarime paraprake, lidhur me detyrat dhe përgjegjësit e secilit punonjës për të nxjerr përfundimet përkatëse. Pra është kryer një kontroll sipërfaqësor dhe jo i detajuar. Sa më sipër kërkoj të merren parasysh

kundërshtimet e mia, të kryen verifikimet përkatëse dhe të evidentohen në Raportin Përfundimtar të Kontrollit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit të mësipërm, shprehet se observacioni i bërë nuk merret në konsideratë dhe shpjegon si më poshtë vijon:

-Fillimisht theksojmë se në asnjë rast nuk jemi shprehur se ngarkoheni me përgjegjësi për mos marrjen e masave shtrënguese, pasi jemi të qartë që këtë detyrë nuk e keni ju, por jemi shprehur që nuk keni kërkuar bashkëpunim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila ka mekanizmat e duhur për të mundësuar arkëtimin e vlerës debitore për tarifat e licencave të lëshuara në periudha të mëparshme dhe që subjektet nuk kanë kryer pagesën;

-Në asnjë rast nuk jemi shprehur se përse Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve nuk ka kryer kontrolle në terren për të evidentuar subjektet me aktivitet tregtimin e karburanteve;

-Jemi shprehur se jo të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet pa licencë janë njoftuar për t'u pajisur me licencë.

-Jemi shprehur se në territorin e Bashkisë Vlorë ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve edhe subjekte të tjerë, për të cilët Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve nuk administron dokumentacion.

-Jemi shprehur se ka subjekte debitore të cilët nuk kanë kryer likuidimin e tarifës së licencës të lëshuar në periudha të mëparshme, pra jo përgjatë vitit 2025.

Sqarojmë se periudha objekt auditimi ka qenë viti 2025 dhe ndër aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë periudhë ka qenë edhe rregullore e brendshme e vitit 2018.

Referuar kuadrit rregullator të mësipërm, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve (emërtesa sipas rregullores së brendshme) dhe me konkretisht në shkronjën "b" në nenin 137 të rregullores së brendshme, detyrat për Specialistin e Transportit dhe Sinjalistikës, punonjës në varësinë Tuaj gjatë kohës që keni ushtruar detyrën e Drejtorit të komanduar të Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, parashikohet se:

"Kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore në fushën e transportit, ***lejeve*** *dhe merr masa ndaj subjekteve shtetërore apo private qofshin që përbëjnë shkelje të këtyre dispozitave".*

Pra sa më sipër, zbatimi i dispozitave ligjore e nënligjore në fushën e **lejeve**, kërkon që subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, duhet të jenë të pajisur me licencën përkatëse dhe të kryejnë likuidimin e tarifës.

Në këto kushte si është kontrolluar zbatimi i dispozitave ligjore për subjektet e mësipërme dhe marrja e masave për subjekte që janë në shkelje të këtyre dispozitave, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, ka rezultuar se kontrolli dhe marrja e masave nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve ka qenë i pjesshëm dhe jo i plotë, për arsye të cilat i kemi pasqyruar edhe në materialin e auditimit (subjekte pa licencë, mosnjoftimi i të gjithë subjekteve, subjekte për të cilët nuk administrohet asnjë informacion etj)

Pra ju si Drejtori e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, në kushtet kur nuk i keni të gjithë mekanizmat, në kuadër të marrjes së masave (sipas detyrës në rregulloren e brendshme) për subjektet në shkelje të dispozitave ligjore:

-Nuk keni kërkuar bashkëpunim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, për subjektet që nuk kanë kryer likuidimin dhe janë debitorë, me qëllim që të arkëtohet detyrimi, pra jo ta arkëtoni ju, por DTTV duke i kërkuar ju ndihmë dhe bashkëpunim;

-Nuk keni kërkuar bashkëpunim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, me qëllim që t'ju japi informacion mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve në territorin e Bashkisë Vlorë, duke bërë krahasimin me databazën e subjekteve që keni dhe evidentimin e subjekteve të cilat nuk i keni në databazën tuaj;

-Nuk keni informuar Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për situatën, në të cilën ka subjekte që ushtrojnë aktivitet të palicencuar;

-Nuk keni kërkuar bashkëpunim nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial, me qëllim që t'ju japi informacion mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve në territorin e Bashkisë Vlorë, duke bërë krahasimin me databazën që keni dhe evidentimin e subjekteve të cilat nuk i keni në databazën tuaj.

Për këto masa jemi shprehur në materialin e auditimit, për të cilat keni mekanizmat e duhur për ti vendosur në zbatim.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. Z.S, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike për periudhën Janar – Korrik 2025, znj. D.F me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike për periudhën Korrik – Dhjetor 2025.

Pajisja me autorizime të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë lavazh.

Grupi i auditimit, auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të pikës 6 në paketën fiskale të miratuar për vitin 2025: "*Pagesa për autorizim për ushtrim veprimtarie si Lavazh, është 10,000 lekë*".

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se përgjatë vitit 2025 nga Bashkia Vlorë, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, nuk është lëshuar asnjë autorizim për ushtrim veprimtarie si lavazh. Nga auditimi i regjistrit të faturimit të DAV, ka rezultuar se 51 subjekte zhvillojnë aktivitet si Lavazh, pasqyruar si më poshtë[11].

Subjekte	Tarifa vjetore	Vlera e përllogaritur
51	10,000	510,000

Për vitin 2025, nëse nga Bashkia Vlorë do lëshoheshin autorizime dhe do tarifoheshin subjekte të cilat zhvillojnë aktivitet me veprimtari si lavazh, të ardhurat që do të arkëtoheshin janë në vlerën 510,000 lekë, të cilat janë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. Z.S, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike për periudhën Janar – Korrik 2025, znj. D.F me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike për periudhën Korrik – Dhjetor 2025.

Për realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vlorë.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Vlorë mbi arkëtimin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në Bashkinë Vlorë, si dhe për subjekte të cilat kanë kryer punime ndërtimi si rrjedhojë e lejeve të ndërtimit, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Paketa fiskale e vitit 2025;
-Evidenca e prokurimeve me fonde publike 01.01.2024 - 31.12.2025;
-Leje ndërtimi, njoftim i fillimit të punimeve dhe certifikatë përdorimi;
-Faturimi i detyrimit dhe pagesa.

Referuar paketës fiskale të miratuar me VKB nr. 96, datë 07.12.2023 të ndryshuar, rezultoi se ndaj subjekteve që kryejnë punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vlorë, si rrjedhojë e kontratave për punë publike dhe lejeve të ndërtimit, të cilat hapin adresë sekondare, aplikohen disa tarifa, konkretisht:

-Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve në vlerën 123,000 lekë;
-Tarifa e ndriçimit në vlerën 18,000 lekë;
-Tarifa e gjelbërimit në vlerën 9,000 lekë.

Momenti i shtrirjes së përgjegjësisë tatimore është nga data e fillimit të punimeve deri në përfundimin e tyre. Drejtoria e Urbanistikës duhet të njoftojë Drejtorinë e të Ardhurave Vendore për subjektet që kanë marrë leje ndërtimi dhe kanë filluar/përfunduar punimet, si dhe Njësia e Prokurimit duhet të njoftojë Drejtorinë e të Ardhurave Vendore për subjektet të cilat kanë fituar kontrata për punë publike nëpërmjet procedurave të prokurimit. Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në vijim kryen vlerësimin tatimor, faturimin dhe arkëtimin e vlerës përkatëse.

-Sa më sipër, grupi i auditimit i'u drejtua me kërkesë Drejtorisë së Urbanistikës, Njësisë së Prokurimit dhe Drejtorisë së të Ardhurave Vendore për komunikimin e përbashkët, me qëllim faturimin dhe arkëtimin e tarifave të mësipërme. Nga përgjigjet e kthyera, konstatohet se përgjatë vitit 2025:

[11] Tabela nr.23 "Subjektet me aktivitet Lavazh" është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Drejtoria e Urbanistikës në asnjë rast nuk ka përcjellë informacion me shkrim/email drejtuar Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vlorë, duke mos zbatuar detyrimin në Paketën Fiskale;
-Njësia e Prokurimit ka përcjellë dy herë informacionin për subjektet që kanë fituar kontratë për punë publike në territorin e Bashkisë Vlorë.
Në këto kushte grupi i auditimit kërkoi nga Drejtoria e Urbanistikës, të vendosë në dispozicion informacionin me subjektet që kanë kryer punime ndërtimi si rrjedhojë e lejeve të ndërtimit, me qëllim kryerjen e vlerësimit të detyrimit të tyre. Metodologjia e ndjekur për vlerësimin e këtij detyrimi, u krye duke pasur në konsideratë, datën e njoftimit të fillimit të punimeve, si dhe statusin e punimeve deri më datë 31.12.2025 (pra për punimet, për të cilat është dhënë leja e shfrytëzimit, data e dhënies së lejes është përfundimi i punimeve, si dhe për punimet për të cilat nuk është dhënë leja e shfrytëzimit, detyrimi është përllogaritur deri më datë 31.12.2025).

Nga sa më sipër konstatohet se janë 5 subjekte, të cilat janë shpallur fituese të kontratave për punë publike dhe që nuk janë përcjellë nga Njësia e Prokurimit drejtuar DAV, me qëllim faturimin dhe arkëtimin e tarifave përkatëse, si dhe 41 raste për subjekte që janë pajisur me leje ndërtimi, të cilat nuk janë përcjellë pranë DAV[12].
Për subjektet e mësipërme, u krye verifikimi në regjistrin e faturimit të DAV dhe QKB, ku rezultoi se këto subjekte janë aktive, si dhe nuk janë faturuar për objektet e mësipërme.
Për mungesën e dërgimit të informacionit të plotë pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, mbanë përgjegjësi z. K.D, Përgjegjës i Njësisë së Prokurimit për periudhën Janar-Qershor 2025 dhe znj. M.C, Përgjegjës i Njësisë së Prokurimit për periudhën Qershor – Dhjetor 2025.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, z. K.D, me shkresën nr.739/8 prot., datë 17.09.2026 është paraqitur observacion, konkretisht:
Pretendimi i Subjektit:
Referuar nenit 43 të rregullores së brendshme, njësia e prokurimit nuk ka detyrë përcjelljen e informacionit të mësipërm pranë DTTV Bashkia Vlorë. Gjithashtu në vijim të kërkesave për informacion që ka paraqitur DTTV Bashkia Vlorë, NJP i është përgjigjur duke dhënë informacionin përkatës.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit të mësipërm, shprehet se observacioni i bërë nuk merret në konsideratë dhe shpjegon si më poshtë vijon:
-Shkresat që ju keni bashkëlidhur observacionit, grupi i auditimit i ka pasqyruar. Sa i përket vazhdimit të observacionit, ju sqarojmë se grupi i auditimit nuk ka referuar rregulloren e brendshme, por Paketën Fiskale.
Sa më sipër, ju lutemi referojuni përcaktimeve të bëra në VKB nr. 96, datë 07.12.2023 të ndryshuar, për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2025, konkretisht në faqen nr.20 dhe do të kuptoni përgjegjësinë e NJP.

<u>Subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në zbatim të lejeve të ndërtimit[13].</u>
Në vijim të përllogaritjeve të kryera, bazuar në Paketën Fiskale, rezultoi se vlera prej 4,387,374 lekë, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë, si rrjedhojë e mungesës së përcjelljes së informacionit pranë DAV Bashkia Vlorë, për kryerjen e faturimit.

Bazuar në Paketën Fiskale të Bashkisë Vlorë, miratuar me VKB nr. 96, datë 07.12.2023, i ndryshuar, kapitulli nr.2, tabela e tarifave, si dhe paragrafi në vijim të tabelës, për mungesën e dërgimit të informacionit pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, mbanë përgjegjësi z. K.M, me detyrë Drejtor i Urbanistikës për periudhën nga data 01.01.2025 deri më datë 03.03.2025, z. Z.S, me detyrë Drejtor i Urbanistikës për periudhën nga data 03.03.2025 deri më datë 17.07.2025, z. O.D me detyrë Drejtor i Urbanistikës për periudhën nga data

[12] Tabela "Subjektet fituese të tenderave për punë publike" është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
[13] Tabela "Subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në zbatim të lejeve të ndërtimit" është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

17.07.2025 deri më datë 03.10.2025, z. I. Xh. me detyrë Drejtor i Urbanistikës për periudhën nga data 03.10.2025 deri më datë 31.12.2025.

Problematika të tjera të rezultuara gjatë verifikimeve të mësipërme.

Nga verifikimi i mësipërm dhe më konkretisht nga kryqëzimi i informacionit, u konstatuan disa mangësi, të cilat lidhen kryesisht me aplikimin e taksave dhe tarifave vendore nga DAV Bashkia Vlorë, konkretisht:

-Ndaj subjektit "L" ShPK, nuk janë aplikuar tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit për adresat sekondare të deklaruara në QKB, konkretisht për adresat:

"Izvori" Orikum, leje ndërtimi nr.385, deklaruar adresa në QKB më datë 10.12.2024 deri më datë 18.06.2025, 187 ditë afat. Përllogaritur dhe pasqyruar tarifa 76,849 lekë për adresën sekondare "Izvori" Orikum në tabelën e mësipërme.

"Dukat Fushe", leje ndërtimi nr. 555, deklaruar adresa në QKB më datë 10.12.2024 deri më datë 28.02.2025, 60 ditë afat. Përllogaritur dhe pasqyruar tarifa 24,657 lekë për adresën sekondare "Dukat Fushë" në tabelën e mësipërme;

"Dukat Fushë", leje ndërtimi nr. 265, deklaruar adresa në QKB më datë 10.12.2024 deri më datë 18.06.2025, 187 ditë afat. Përllogaritur dhe pasqyruar tarifa 76,849 lekë për adresën sekondare "Dukat Fushë" në tabelën e mësipërme;

-Ndaj subjektit "E" ShPK, nuk janë aplikuar tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, për adresën sekondare Vlorë, Lagjia 24 Maji ZK 8605 nr. pasurie 19/529, pavarësisht faktit se është deklaruar adresë sekondare në QKB, ndryshe nga sa është vepruar për adresën sekondare Lagja Uji i Ftohtë, Rruga Murat Terbaçi, të subjektit "L" ShPK, për të cilën edhe pse ka munguar informacioni nga Drejtoria e Urbanistikës, mbi lejen e ndërtimit në këtë adresë, nga DAV janë aplikuar arifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit. Përllogaritur dhe pasqyruar tarifa 17,260 lekë për adresën sekondare Lagjja 24 Maji ZK 8605 nr. pasurie 19/529.

-Ndaj subjektit "A & K" ShPK, nuk janë aplikuar tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, pavarësisht faktit se është deklaruar adresë sekondare në QKB, ndryshe nga sa është vepruar për adresën sekondare Lagja Uji i Ftohtë, Rruga Murat Terbaçi, të subjektit "L" ShPK, për të cilën edhe pse ka munguar informacioni nga Drejtoria e Urbanistikës, mbi lejen e ndërtimit në këtë adresë, nga DAV janë aplikuar tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit. Përllogaritur dhe pasqyruar tarifa 50,547 lekë për adresën sekondare Lagjja Uji Ftohtë në tabelën e mësipërme.

Në total vlera e detyrimit të papërllogaritur për adresat sekondare të subjekteve të mësipërme, pavarësisht faktit se janë deklaruar në QKB, është 246,162 lekë.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, me shkresën nr.739/8 prot., datë 17.09.2026 është paraqitur observacion, konkretisht:

Pretendimi i Subjektit: Seksioni "Problematika të tjera të rezultuara gjatë verifikimeve": Në faqen nr.21 seksioni "Problematika të tjera të rezultuara gjatë verifikimeve":

Subjekti L sipas verifikimit në terren adresa Qeriba Derri dhe Lagjja 24 Maji, Rruga Spiro Comorra janë në të njëjtën rajon dhe subjekti e ka marrë vlerësimin e taksave dhe tarifave për 2025.

Subjekti L në lidhje me:

lejen 385 është kryer vlerësimi tatimor për vitin 2025

lejen 555 është kryer vlerësimi tatimor për vitin 2025

lejen 265 është kryer vlerësimi tatimor për vitin 2025

Subjekti E.B sipas verifikimit në QKB ka vetëm një adresë për të cilën është vlerësuar në zbatim të VKB-së nr.96.

Subjekti A&K sipas verifikimit në QKB ka vetëm një adresë për të cilën është vlerësuar në zbatim të VKB-së nr.96.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pas shqyrtimit të observacionit, sqarojmë se merret në konsideratë pjesërisht, për vlerësimin e subjektit L, ndërkohë për subjektet e tjera nuk merret në konsideratë observacioni.

Bazuar në shkronjat "c" dhe "h" në nenin 104 të rregullores së brendshme të Bashkisë Vlorë, mbanë përgjegjësi z. S.K, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për

periudhën deri më datë 14.07.2025, z. F.Ll, me detyrë Drejtor i Komanduar i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për periudhën Korrik - Dhjetor 2025.

Të ardhurat nga qiratë.

Procesi i administrimit të kontratave të qirasë për asetet në pronësi ose në administrim të Bashkisë Vlorë, kryhet nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve. Sipas përcaktimit të bërë në nenin 167 të rregullores së brendshme të Bashkisë Vlorë, në fuqi për vitin 2025, rezultoi se Drejtori i Drejtorisë së Aseteve dhe Pronave Publike:

-Është nëpunës civil dhe organizon dhe menaxhon punën e drejtorisë për të gjitha çështjet që lidhen me administrimin e pronave të paluajtshme të Bashkisë Vlorë.

-Mban regjistrin e akteve nënligjore të organeve të Bashkisë, për menaxhimin e pronave të Bashkisë si dhe regjistrin e kontratave për pronat në pronësi ose administrim të Bashkisë Vlorë etj.

Sa më sipër, me qëllim evidentimin e vlerës së arkëtuar dhe debitore, grupi i auditimit bëri kërkesë për regjistrin e kontratave të qirasë në fondin pyjor/kullosor, për subjekte që ushtrojnë aktivitet në sektorin e burimeve minerare dhe energjitike në Bashkinë Vlorë dhe NJA. Sipas komunikimit të bërë me z. K.K, Drejtori i komanduar në detyrë për periudhën Korrik – Dhjetor 2025[14], rezultoi se nuk administron asnjë informacion/dokumentacion lidhur me kontrata qiraje në fondin pyjor/kullosor për subjekte që ushtrojnë aktivitet në sektorin e burimeve minerare dhe energjetike. Theksojmë se edhe në procesverbalin nr. 12329 prot., datë 24.07.2025, të marrjes në dorëzim të dokumentacionit nga drejtuesi i mëparshëm i drejtorisë së mësipërme, nuk rezultoi asnjë dokument që lidhet me kontrata qiraje në fondin pyjor/kullosor.

Në këto kushte grupi i auditimit, me qëllim ilustrimin me shembuj, verifikoi databazat e institucioneve shtetërore, me qëllim marrjen e informacionit, nëse në territorin e Bashkisë Vlorë, ka subjekte që ushtrojnë aktivitet në sektorin e burimeve minerare dhe energjetike, të cilat mund të jenë burim i të ardhurave për këtë bashki. U verifikua databaza e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Entit Rregullator të Energjisë, si dhe informacioni për subjektet përkatëse u kryqëzua me informacionin e nxjerrë nga QKB, si dhe të regjistrit të taksave dhe tarifave vendore të DAV Bashkia Vlorë.

Nga verifikimi i mësipërm rezultoi se, përgjatë vitit 2025 kanë qenë aktiv 4 subjekte me aktivitet në sektorin minerar, me vendburimin dhe llojin e mineralit të përcaktuar, për të cilët, nuk administrohej asnjë dokumentacion tekniko-ligjor, mbi statusin juridik të pronave nëse janë pronë shtet/privat, llojin e fondit pyjor/kullosor, vlerën e bimësisë së hequr, rrugën auto-pyjore nëse kanë në përdorim këto subjekte, vendin e depozitimit etj, me qëllim përllogaritjen e detyrimeve ndaj tyre.

Tabela nr.26 Subjekte me aktivitet në sektorin minerar (për ilustrim)

Emërtimi	NIPT	Bashkia	Vendburimi	Lloji i Mineralit	S=km^2
A.S ShPK	L	Vlorë	Shushicë	Gur Gëlqeror	0.15
B.S ShPK	K	Vlorë	Radhimë	Gur Gëlqeror	0.096
G.K ShPK	K	Vlorë	Kaninë	Gur Gëlqeror	0.417
V ShPK	L	Vlorë	Kaninë	Gur Gëlqeror	0.688

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi z. J.J, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Aseteve dhe Pronës Publike, për periudhën Janar – Korrik të vitit 2025; z. K.K, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Aseteve dhe Pronës Publike për periudhën Korrik – Dhjetor 2025, të cilët nuk kanë marrë masat e nevojshme, për krijimin e databazës për kontratat e qirave.

[14] Sqarojmë se Drejtori për periudhën Janar – Korrik 2025, nuk është pjesë e stafit të Bashkisë Vlorë dhe në këto kushte nuk arritëm të komunikonim.

Problematika të tjera të rezultuara gjatë verifikimeve të mësipërme.

Nga verifikimi i mësipërm dhe më konkretisht nga kryqëzimi i informacionit, u konstatuan disa mangësi, të cilat lidhen kryesisht me aplikimin e taksave dhe tarifave vendore nga DAV Bashkia Vlorë, konkretisht:

-Subjekti "A.S" ShPK, me seli kryesore "Vlorë Lagjia Nr.10, Pallat nr.18, Shkalla.1, Ap.25 pranë Shkollës së Marinës", aktivitet në sektorin minerar "Gur Gëlqeror", vendndodhje "Shushicë" me status "Aktiv", nuk administrohet në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore të DAV, ndryshe nga çfarë është vepruar për tre subjektet e tjera "B.S" ShPK; "G.K" ShPK, dhe "V" ShPK, ndaj të cilëve janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore. Vlera e detyrimit të papërllogaritur për tarifë pastrimi, gjelbërimi dhe ndriçimi është 15,240 lekë (12,000 lekë pastrimi + 2,160 lekë ndriçimi + 1,080 lekë gjelbërimi), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, Sektori i Pranimit, me shkresën nr.739/8 datë 17.09.2026 është paraqitur observacion, konkretisht:

Pretendimi i Subjektit: Seksioni "Problematika të tjera të rezultuara gjatë verifikimeve":

Në lidhje me subjektin A.A ju sqarojmë se ky subjekt është pezulluar në datën 21.09.2018 dhe në zbatim të ligjit nr.9920 "Për procedurën tatimore në Republikën e Shqipërisë" nuk mund të vlerësohet me tarifat e pastrimit ndriçimit dhe gjelbërimit dhe për me tepër as për ndërtesën, të cilën nuk është e evidentuar në terren nga inspektorët e terrenit.

Subjekti E është vlerësuar me tarifat përkatëse pasi sipas QKB-së është pezulluar në 30.04.2025.

Subjekti M.H është vlerësuar me tarifat përkatëse pasi sipas QKB-së është pezulluar në 20.11.2025.

F.GJ është vlerësuar me tarifat përkatëse pasi sipas QKB-së është pezulluar në 11.07.2025.

D.Z është vlerësuar me tarifat përkatëse pasi sipas QKB-së është pezulluar në 09.06.2025.

P.D është vlerësuar me tarifat përkatëse pasi sipas QKB-së është pezulluar në 10.04.2025.

A.S është subjekt të cilit i është vlerësuar adresa kryesore, për sa i përket adresës dytësore nga verifikimi i inspektorëve të terrenit ky subjekt nuk gjendet dhe nga komunikimi në telefon subjekti është transferuar në Berat por nuk ka kryer ndryshimet në ekstraktin historik të tij.

G.K dhe V janë vlerësuar me taksat dhe tarifat përkatëse pasi janë evidentuar nga inspektorët e terrenit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Pas shqyrtimit të observacionit, sqarojmë se merret në konsideratë pjesërisht dhe janë bërë ndryshimet e nevojshme në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Nuk merret në konsideratë observacioni për subjektin A.S, pasi nuk administrohen të dhëna për vlerësimin tatimor për adresën kryesore.

Të ardhurat nga tarifa e qirasë për hapësirën e plazhit.

Nga auditimi i dokumentacionit për qiradhënien e hapësirës së plazhit për ushtrimin e aktivitetit "Stacion plazhi", rezultoi se Bashkia Vlorë në vitin 2025 ka në administrim 147 kontrata qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit. Për vitin 2025 janë lidhur 42 kontrata të reja për marrjen me qira të hapësirës për "Stacion plazhi".

Vlera e faturuar për hapësirën e plazhit për vitin 2025 është 35,736,128 lekë dhe vlera e arkëtuar është 34,550,628 lekë, pra me diferencë në vlerën 1,185,500 lekë, si rrjedhojë e mos pagesës së detyrimit vjetor nga 5 subjekte, konkretisht:

Tabela nr.28 Subjektet që nuk kanë kryer pagesën

Subjekti	Vlera e Faturuar	Detyrimi
A	154,500	154,500
D	325,000	325,000
K.L	250,000	250,000
H.V	240,000	240,000
P	216,000	216,000
Total	**1,185,500**	**1,185,500**

Burimi: DAV Bashkia Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Subjektet e mësipërme në vitin 2025 kanë pasur kontratë qiraje në fuqi të lidhur në periudha të mëparshme, pra nuk e kanë lidhur në vitin 2025.

Sa më sipër vlera debitore progresive në fund të vitit 2025 është 2,400,000 lekë, nga të cilat 1,214,500 lekë në fund të vitit 2024 dhe 1,185,500 krijuar brenda vitit 2025. Vlera prej 2,400,000 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Për subjektet e mësipërme nuk është aplikuar penalitet për moslikujdimin e tarifës së qirasë, si dhe për arkëtimin e detyrimit nuk janë marrë masat për prishje të kontratës, moslejimin e ushtrimit të aktivitetit, kërkesë padi në gjykatë etj.
Sa më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 8 në kontratën e qirasë të lidhur ndërmjet palëve, pikën a/2 të Paketës Fiskale Bashkia Vlorë.
Për këtë mbanë përgjegjësi z. J.J, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Aseteve dhe Pronës Publike, për periudhën Janar – Korrik të vitit 2025; z. K.K, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Aseteve dhe Pronës Publike për periudhën Korrik – Dhjetor 2025, të cilët nuk kanë marrë masat e nevojshme, për sa më sipër.

-Gjithashtu për 13 subjekte, ka rezultuar se pavarësisht se janë debitorë për moslikujdimin e detyrimeve vendore për taksa, tarifa ose kamatë-vonesa, përsëri janë pajisur me hapësirë për përdorim e plazhit për vitin 2025, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën a/2 të Paketës Fiskale Bashkia Vlorë, shkronjën "c" pika 3 në nenin 7 në VKM nr.649, datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", e ndryshuar.

Tabela nr.29 Subjekte debitorë që kanë hapësirë për përdorim e plazhit për vitin 2025

Nr.	Emër	NIPT
1	N.H	K
2	R.G	L
3	B.H	L
4	E.D	L
5	A	K
6	A.G	M
7	S	K
8	F.D	L
9	R	K
10	M.B	L
11	R.G	L
12	J.R	L
13	K.H	M

Burimi: DAV Bashkia Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Gjithashtu, nga verifikimi i kryer është konstatuar se për 1 subjekt në 2 raste, tarifa e aplikuar është në vlerën 20 lekë, tarifë e cila aplikohet në rastet kur aplikanti ka dokument pronësie në zonën, që do të shfrytëzojë për "Stacion plazhi", për të cilat dokumentacioni i pronësisë nuk përputhet me vendndodhjen e stacionit të plazhit, pasqyruar si më poshtë vijon:

Nr.	Emër	Nipt	Adresa	Sasi e faturuar (m^2)	Vlera e faturuar	Tarifa që duhet aplikuar	Vlera sipas tarifës që duhet aplikuar	Diferenca në lekë
1	D.N	L	Orikum	200	4,000	650	130,000	126,000
2	D.N	L	Orikum	325	6,500	650	211,250	204,750
	Total							**330,750**

Burimi: DAV Bashkia Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për subjektin e mësipërm konstatohen mangësi sa i përket dokumentacionit të pronësisë, konkretisht, administrohet certifikatë pronësie për pasuri të llojit "Pyll" që nuk përputhet me llojin e pasurisë në të cilën është stacioni i plazhit. Gjithashtu pasuria është në pronësi të shtetasit I.N dhe T.H, pra jo në pronësi të D.N/apo marrë me qira nga I.N dhe T.H. Diferenca e krijuar si rrjedhojë e aplikimit të tarifës 20 lekë, është 330,750 lekë gjithsej.

-Nga verifikimi i kryer, rezultoi se 4 subjekte kanë në përdorim më tepër sipërfaqe në krahasim me sipërfaqen e kontraktuar. Konkretisht subjektet janë si më poshtë vijon:

Nr.	Emër	Nipt	Adresa	Sip. sipas kontratës	Sip. e Faturuar	Diferenca në sipërfaqe
1	M.H	K	Fshat Radhimë, Kashtore vendi Virua	0	200	200
2	R.G	L	Fshati Radhimë, Kompleksi Regina	0	922	922
3	R.G	L	Fshati Radhimë, Kompleksi Regina	922	1100	178
4	E.N	M	Radhime	600	723.84	124
	Total			**1522**	**2945.8**	**1424**

Burimi: DAV dhe Drejtoria e Aseteve Bashkia Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1 në nenin 7 në VKM nr.649, datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", e ndryshuar.

Për këtë mbanë përgjegjësi z. J.J, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Aseteve dhe Pronës Publike, për periudhën Janar – Korrik të vitit 2025, periudhë në të cilën janë lidhur kontratat e qirasë.

Problematika të tjera të rezultuara gjatë verifikimeve të mësipërme.

Nga verifikimi i mësipërm dhe më konkretisht nga kryqëzimi i informacionit, rezultuan disa mangësi, të cilat lidhen kryesisht me aplikimin e taksave së fjetjes në hotel nga DAV Bashkia Vlorë, pasqyruar si më poshtë:

Nr.	Emër	Nipt	Adresa	Sipas QKB ka strukturë akomoduese	Faturohet për strukturën akomoduese
1	D.N	L	Orikum	Po	Jo
2	E.N	M	Radhimë	Po	Jo
3	E.K	M	Plazhi Vjetër	Po	Jo

Burimi: QKB dhe DAV Bashkia Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 të Paketës Fiskale Bashkia Vlorë.

Bazuar në Paketen Fiskale të Bashkisë Vlorë, miratuar me VKB nr.96, date 07.12.2023, i ndryshuar, Kapitulli 1, pika 3 dhe në shkronjat "c" dhe "h" në nenin 104 të rregullores së brendshme të Bashkisë Vlorë, mbanë përgjegjësi z. F.Ll, me detyrë Drejtor i Komanduar i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për periudhën Korrik - Dhjetor 2025.

Debitor nga gjoba të vendosura nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezultoi se në fund të vitit 2025 në mënyrë progresive nga gjobat e vendosura nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit kryqëzuar me informacionin e pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2025[15], janë gjithsej 665 gjoba për vlerën 402,010,813 lekë pa u arkëtuar, nga të cilat 102 gjoba në vlerën 195,985,813 lekë janë të vitit 2025.

Emërtimi	Debitor IMTV deri 2025	Subjekte	Principal
A	Nga të cilat deri më 31.12.2024	1182	428,090,000
B	Falur përgjatë vitit 2025[16]	619	222,065,000
C	Mbetur (A-B)	563	206,025,000
D	Mbetur në 2025 (Krijuar gjatë vitit 2025 – Likuiduar përgjatë vitit 2025)	102	195,985,813
E	Mbetur në mënyrë progresive deri më 31.12.2025 (C+D)	665	**402,010,813**

Burimi: IMTV dhe Qendra Ekonomike Bashkia Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Vlera e mësipërme prej 402,010,813 lekë, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë. Rezultoi se gjobat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat, *(përjashtuar 19 gjoba me vlerë 25,710,000 lekë të vendosura në periudhën Janar-Mars të vitit 2025, paraqitur kërkesa për urdhër ekzekutimi brenda vitit 2025, nga Kryeinspektori i IMTV, z. D.K),* nuk dokumentohet nëse është bërë kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të tyre. Gjithashtu për gjobat e vendosura në vitin 2025 dhe që nuk janë likuiduar brenda vitit, nuk janë përllogaritur kamatë-vonesat rast pas rasti. Pra rezulton se nuk është bërë punë e mjaftueshme në drejtim të masave të marra për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV Bashkia Vlorë. Sa më sipër është në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 3 dhe 4 të nenit 30 në Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Bazuar në shkronjat "b" dhe "c" në nenin 180 të rregullores së brendshme të Bashkisë Vlorë dhe mos marrjen e masave për arkëtimin e gjobave të vendosura në vitin 2025, si dhe mungesën e përllogaritjes së kamatë-vonesave për këto gjoba, me qëllim kontabilizimin e plotë të detyrimeve, mbanë përgjegjësi z. E.A, me detyrë Kryeinspektor i IMTV Bashkia Vlorë, për periudhën Janar – Mars 2025, z. I.Z me detyrë Kryeinspektor i IMTV Bashkia Vlorë, për periudhën Mars-Qershor 2025 dhe z. D.K, me detyrë Kryeinspektor i IMTV Bashkia Vlorë, për periudhën Korrik-Dhjetor 2025.

[15] Llogaria analitike nr.468.

[16] VKM Nr. 274, datë 9.5.2025 "Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të paekzekutuara".

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, IMTV Bashkia Vlorë, me shkresën nr.739/9 prot., datë 21.09.2026 është paraqitur observacion, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur, konkretisht:
Pretendimi i Subjektit: Bashkëlidhur kërkesat për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të disa prej gjobave të vendosura nga IMTV Bashkia Vlorë.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur, sqarojmë se merret në konsideratë pjesërisht dhe është bërë ndryshimin në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga subjekti i audituar, z. I.Z, me shkresën nr.739/7 prot., datë 03.09.2026 është paraqitur observacion, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur, konkretisht:
Pretendimi i Subjektit: Lidhur me gjetjet dhe konstatimet e paraqitura në projektraportin e auditimit, vlerësoj të nevojshme të sqaroj se periudha gjatë së cilës kam ushtruar detyrën dhe kam mbajtur pozicionin përkatës ka qenë vetëm nga muaji mars 2025 deri në muajin qershor 2025.
Në mënyrë të veçantë, brenda periudhës mars-qershor 2025, periudha 14.04.2025 - 15.05.2025, e cila përfshihet në periudhën objekt auditimi, përkon me periudhën e pushimit tim vjetor.
Gjithashtu, parashtroj se, gjatë zhvillimit të procesit të auditimit, nuk më janë përcjellë apo vënë në dispozicion akt-verifikimet, akt-konstatimet apo dokumentet përkatëse të hartuara nga grupi i auditimit në kohën kur janë kryer verifikimet dhe janë evidentuar konstatimet konkrete që lidhen me veprimtarinë time. Në mënyrë të posaçme, kërkoj që grupi i auditimit të verifikojë dhe të marrë në konsideratë: periudhën faktike gjatë së cilës kam mbajtur detyrën dhe pozicionin, konkretisht nga marsi deri në qershor 2025; Periudhën katërjavore të pushimit tim vjetor; Personin ose personat që kanë ushtruar detyrën dhe kompetencat përkatëse gjatë periudhës së pushimit vjetor; Dokumentacionin mbi të cilin janë mbështetur gjetjet dhe konstatimet; dhe lidhjen konkrete ndërmjet çdo veprimi apo mosveprimi të evidentuar dhe përgjegjësisë individuale që pretendohet se më atribuohet.
Mbi përbërjen e shumës prej 402,010,813 lekësh. Sipas tabelës së përpunuar nga grupi i auditimit, me burim të dhënat e IMT-së dhe Qendrës Ekonomike të Bashkisë Vlorë, rezultoi:
1.deri më 31.12.2024: 1,182 subjekte, me principal 428,090,000 lekë;
2.gjatë vitit 2025: 619 subjekte të likuiduara/falura, në vlerën 222,065,000 lekë;
3.mbetur nga kjo gjendje: 563 subjekte, në vlerën 206,025,000 lekë;
4.detyrime të krijuara gjatë vitit 2025 dhe të mbetura të palikuiduara: 102 subjekte, në vlerën 195,985,813 lekë;
5.total progresiv deri më 31.12.2025: 665 subjekte, në vlerën 402,010,813 lekë.
Pra, shuma prej 402,010,813 lekësh nuk përfaqëson gjoba të krijuara gjatë periudhës mars-qershor 2025. Një pjesë prej 206,025,000 lekësh përfaqëson detyrime të mbetura nga periudhat deri më 31.12.2024, ndërsa 195, 985,813 lekë përfaqësojnë detyrime të krijuara gjatë gjithë vitit 2025. Për këtë arsye, vlerësoj se shuma totale prej 402,010,813 lekësh nuk mund të përdoret si bazë e drejtpërdrejtë për individualizimin e përgjegjësisë time personale për periudhën mars-qershor 2025.
Mbi detyrimet e krijuara përpara vitit 2025.
Vetë tabela e auditimit evidenton se pas veprimeve të kryera gjatë vitit 2025, mbeten 563 subjekte, në vlerën 206,025,000 lekë, nga detyrimet e mëparshme. Kjo shumë lidhet me detyrime që kanë ekzistuar përpara vitit 2025. Për rrjedhojë, ekzistenca e këtyre detyrimeve në gjendjen e fundvitit 2025 nuk mund të konsiderohet, në vetvete, si pasojë e një veprimi ose mosveprimi tim gjatë periudhës mars-qershor 2025. Në mungesë të këtij individualizimi, nuk mund të pranohet që e gjithë shuma e detyrimeve të mbartura të konsiderohet si përgjegjësi personale për një periudhë katërmujore të vitit 2025.
Mbi 102 gjobat e krijuara gjatë vitit 2025.
Projekt-Raporti referon 102 gjoba, në vlerën 195,985,813 lekë, si gjoba të vitit 2025. Megjithatë, klasifikimi i tyre si "të vitit 2025" nuk përcakton se në cilin muaj të vitit janë vendosur. Viti 2025 përfshin periudhën 1 janar-31 dhjetor 2025, ndërsa përgjegjësia që më atribuohet lidhet vetëm me periudhën mars-qershor 2025. Për rrjedhojë, për të arritur në një konkluzion të individualizuar do të ishte e nevojshme të përcaktohej se sa nga këto 102 gjoba:
1.janë vendosur gjatë periudhës mars-qershor 2025;
2.janë njoftuar gjatë kësaj periudhe;
3.kanë përfunduar afatin e pagesës gjatë kësaj periudhe;
4.kanë kaluar në fazën e ekzekutimit gjatë kësaj periudhe;
5.dhe kanë qenë objekt i një veprimi konkret që duhej të ndërmerrej nga funksioni që kam ushtruar.

Mbi mosdokumentimin e kërkesës për urdhrin e ekzekutimit. Në Projekt-Raport thuhet se për gjobat e bëra të formës së prerë "nuk dokumentohet nëse është bërë kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit". Vlerësoj se duhet bërë dallimi ndërmjet:
1."nuk dokumentohet"
2.dhe "nuk është kryer"
Mungesa e një dokumenti në materialin e vënë në dispozicion të grupit të auditimit nuk përbën automatikisht provë se veprimi nuk është kryer. Nëse ky konstatim do të përdoret për të individualizuar përgjegjësi personale, duhet të përcaktohet më parë se cilit funksionar ose strukture i përkiste konkretisht detyrimi për kryerjen e veprimit dhe nëse ky detyrim binte brenda kompetencës sime personale gjatë periudhës mars-qershor 2025. Në të kundërt, një konstatim i përgjithshëm mbi mungesën e dokumentacionit nuk është i mjaftueshëm për të vendosur një përgjegjësi individuale.
Mbi kamatëvonesat.
Nuk kundërshtoj nevojën që, kur plotësohen kushtet ligjore, detyrimet nga gjobat të trajtohen edhe në aspektin e kamatëvonesave. Megjithatë, edhe në këtë rast duhet bërë individualizimi i detyrimeve. Për secilën gjobë duhet të përcaktohet së paku:
1.data e njoftimit;
2.afati i pagesës;
3.momenti i fillimit të kamatëvonesës
4.periudha për të cilën llogaritet ajo;
5.dhe struktura/personi kompetent për përllogaritjen dhe dokumentimin.
Një konstatim i përgjithshëm se "nuk janë përllogaritur kamatëvonesat" nuk përcakton në mënyrë të mjaftueshme se cilat janë detyrimet konkrete dhe se në cilën pikë të procedurës ka ndodhur mosveprimi që i atribuohet personit përgjegjës.
Mbi cilësimin e shumës si "të ardhura të munguara"
Fakti që një gjobë figuron e paarkëtuar në fund të vitit 2025 nuk provon, në vetvete, se ajo shumë është humbur përfundimisht nga buxheti i Bashkisë. Për këtë arsye, edhe nëse shuma prej 402,010,813 lekësh konsiderohet nga pikëpamja kontabël si e ardhur e parealizuar ose e munguar në momentin e raportimit, kjo nuk do të thotë automatikisht se e njëjta shumë përbën pasojë financiare të shkaktuar personalisht nga një funksionar i caktuar. Për atribuimin e një përgjegjësie personale duhet të provohet lidhja shkakësore midis veprimit ose mosveprimit konkret dhe pasojës konkrete.
Mbi lidhjen shkakësore
Nga vetë të dhënat e Projekt-Raportit rezultoi:
1.një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve është krijuar para vitit 2025;
2.një pjesë tjetër është krijuar gjatë gjithë vitit 2025;
3.përgjegjësia ime është kufizuar në periudhën mars-qershor 2025;
4.dhe në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2025 janë likuiduar/falur 619 subjekte.
Për rrjedhojë, nuk rezulton e mjaftueshme të kalohet drejtpërdrejt nga ekzistenca e stokut debitor në fund të vitit 2025 te përfundimi se një person i caktuar mban përgjegjësi për këtë stok. Përgjegjësia duhet të përcaktohet mbi bazën e fakteve dhe kompetencave konkrete që i përkasin pikërisht periudhës mars-qershor 2025.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pas shqyrtimit të observacionit, sqarojmë si më poshtë vijon:
Lidhur me njoftimin, grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit, për personat, të cilët nuk kanë qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Vlorë, i ka kërkuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore njoftimin e tyre, me qëllim komunikimin verbal të konstatimeve, pa u përfunduar dhe protokolluar akt-konstatimi, por nuk u realizua për mungesën e kontaktit. Gjithashtu në fund të akt-konstatimit, përcaktohet qartë se çdo personi, i cili është ngarkuar me përgjegjësi, duhet të njoftohet nga Zyra e Protokollit të subjektit të audituar, me qëllim paraqitjen e komenteve.
Lidhur me dokumentacionin që kemi marrë për gjobat e IMTV Bashkia Vlorë, sqarojmë se është kërkuar në formatin tabelar, çdo gjobë e vendosur për vitin 2025, me ekstremitetet e nevojshme, si dhe duke qenë auditim financiar, kemi kërkuar informacionin mbi likuidimin e gjobave dhe masat e marra për likuidimin e tyre, në rast të mungesës së likuidimit vullnetar nga kundërvajtësi, pas plotësimit të afateve administrative. Në vijim të kësaj kërkese na është vendosur informacioni në formatin tabelar, mbi gjobat e vendosura, masat plotësuese, statusin juridik të tyre. Pra kur vetë subjekti i audituar nuk paraqet dokumentacion, atehërë ky fakt është i mjaftueshëm për grupin e auditimit që të shprehet se nuk dokumentohet, dhe shprehja “nuk dokumentohet” në vetvete tregon moskryerjen e procedurës përkatëse.
Lidhur me përgjegjësinë, sqarojmë se në konstatimin përkatës është cituar shprehimisht (ndoshta nuk e keni lexuar) “*mos marrjen e masave për arkëtimin e gjobave të vendosura në vitin 2025, si dhe*

mungesën e përllogaritjes së kamatë-vonesave për këto gjoba". Pra për gjobat të vendosura gjatë vitit 2025, dhe për këtë është evidentuar përgjegjësia e çdo titullari të IMTV Bashkia Vlorë, në raport me periudhën gjatë së cilës ka ushtruar detyrën e titullarit të IMTV. Pra ju nuk jeni ngarkuar me përgjegjësi për aktivitetin e IMTV për periudhën deri më datë 31.12.2024, si dhe për periudha të tjera gjatë vitit 2025, në të cilën ju nuk keni qenë titullar i IMTV Bashkia Vlorë, si dhe për stokun total të detyrimeve të krijuar në fund të vitit 2025. Mënyra se si e pasqyron grupi i auditimit konstatimin, është në gjykimin profesional të audituesit. Megjithatë në evidentimin e përgjegjësisë personale, grupi i auditimit pavarësisht faktit se ka pasqyruar vetëm një pjesë të bazës ligjore, ju citon si vijon:
Rregullore e brendshme e vitit 2018 në fuqi për periudhën objekt auditimi:
Neni 180, shkronjat "b" dhe "c"
b.Organizon dhe drejton gjithë veprimtarinë e sistemit të IMT dhe përgjigjet për këtë para Kryetarit të Bashkisë.
c.Ndjek zbatimin e detyrave që dalin nga aktet ligjore dhe nënligjore në veprimtarinë e IMT.

Pra në zbatim të shkronjës "b" si titullar i IMTV merrni të gjitha masat e nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të IMTV, për ndarjen e detyrave, realizimin e tyre të plotë dhe në kohë, korrigjimin e gabimeve materiale në rast se ndodhin, evidentimin e personave përgjegjës që nuk kanë kryer detyrimet e tyre, si dhe në zbatim të shkronjës "c" detyrat tuaja si titullar zgjerohen dhe marrin më tepër rëndësi, konkretisht:
IMTV përgjatë aktivitetit të saj vendos gjoba (nuk jemi ndalur tek masat e tjera që vendos IMTV), kryesisht duke u bazuar në tre akte ligjore:
Ligji nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar;
Ligji nr. 107/2014 "për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.
Në aktet ligjore të mësipërme përcaktohet si vendoset masa administrative, përllogaritjen e kamatëvonesave, si dhe mënyrën se si vendoset në ekzekutim.
Aktet ligjore të mësipërme (Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998), për mënyrën e vendosjes së masës administrative dhe ekzekutimin e saj të diktojnë edhe zbatimin e ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", në fuqi për periudhën në të cilën ju keni ushtruar detyrën e titullarit të IMTV. Në këtë ligj, përcaktohet se zbatohet Kodi i Procedurës Administrative, i cili në përmbajtjen e tij, citon se në mungesë të ligjit të posaçëm, afatet e procedurës administrative rregullohen nga ky Kod. Veç sa më sipër është edhe Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", ku me rëndësi është përcaktimi i bërë në nenin 30, pika 4, shkronja "b". Në aktet ligjore të mësipërme, citohet edhe përllogaritja e kamatë-vonesës në masën 2% për çdo ditë vonesë deri në një muaj.
Pra janë 3 momente, në varësi të ligjit që përdoret për të vendosur gjobën. Në varësi të ligjit që përdoret, ndiqet dhe mënyra e ekzekutimit të gjobës.
1.Nëse gjoba është vendosur në zbatim të nenit 15 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, ndiqet si vijon:
Vendoset gjoba
Pritet 30 ditë për ankim të subjektit
Nëse nuk ka bërë ankim, vendimi i gjobës është i formës së prerë dhe duhet paguar brenda 5 ditëve. Nëse nuk paguhet brenda 5 ditëve, aplikohet 2% kamat për 1 muaj. Nëse pas kalimit të 1 muaj, bëhet kërkesë në gjykatë për të lëshuar urdhrin për ekzekutim në gjykatë dhe ngarkohet përmbarimi, me qëllim ekzekutimin e tij me forcë dhe vlerën e plotë të detyrimit, principal + kamatë.
Këto gjoba janë tituj ekzekutiv, dhe në mungesë të strukturës së ekzekutimit me forcë, për ekzekutimin e tyre me forcë ngarkohet përmbarimi.
Nëse ka bërë ankim, atëherë ankimi do shqyrtohet nga komisioni i gjobave (organi epror pranë NJQV);
Organi epror vendos lënien në fuqi të gjobës;
Nëse subjekti nuk e ankimon në gjykatë vendimin e organit epror, atëherë gjoba merrë formë të prerë dhe veprohet si në rastin e parë (pritet 5 ditë.....)
Nëse subjekti e ankimon në gjykatë, pritet vendimi i gjykatës dhe në varësi të tij veprohet më pas.
Pra në rastin e mësipërm, merren në konsideratë përcaktimet e bëra në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".
2.Nëse gjoba vendoset sipas nenit 13 të ligjit Nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, atëherë ajo mund të ankimohet direkt në gjykatë.

Vendimi i gjobës është titull ekzekutiv dhe mund të ekzekutohet në çdo kohë (vullnetarisht), edhe pa pritur vendimin e gjykatës, por nëse nuk paguhet vullnetarisht, atëher përsëri IMTV do ti drejtohet gjykatës, për ta vendosur në ekzekutim.
3.Nëse gjoba vendoset në zbatim të nenit 52 të Ligjit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, atëherë zbatohet neni 53 i këtij ligji, i cili na dërgon tek neni 14 i Ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, për të vazhduar si më sipër.

Për periudhën në të cilën ju keni qenë titullar i IMTV janë vendosur 56 gjoba gjithsej (për ilustrim disa prej tyre) si vijon:

Vendim P.D.Gjobe	Emri i Kundërvajtësit	Shuma	Ankimuar
OOO797/07.03.2025	P.L	50,000	Jo
OOO798/07.03.2025	K	100,000	Jo
OOO801/17.03.2025	G.M	10,000	Jo
OOO799/07.03.2025	G.M	19,250,000	Jo
OOO804/25.03.2025	G.M	740,000	Jo
OOO805/25.03.2025	P.B	50,000	Jo

Pra për gjobat e mësipërme, por jo vetëm, nuk na është vendosur në dispozicion dokumentacioni, lidhur me kërkesën e bërë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të tyre, me qëllim ngarkimin e shërbimit përmbarimor për ekzekutimin e detyrueshëm të tyre. Gjithashtu nuk evidentohet që të jetë përllogaritur kamatë-vonesa. Në këto kushte ju si titullar i IMTV Bashkia Vlorë, duke i'u referuar detyrimeve ligjore të përmendura më sipër, keni detyrimin që të ngarkoni specialistin jurist të përgatisë praktikën dhe me nënshkrimin tuaj, të përcillet pranë gjykatës. Ky dokumentacion nuk na është vendosur në dispozicion. Për këto gjoba, përveç juve, janë ngarkuar me përgjegjësi edhe titullarët e tjerë të IMTV Bashkia Vlorë, pasi edhe për këta është detyrimi që brenda afatit 2 vjeçar të marrin masat e nevojshme për vendosjen në ekzekutim të gjobës.
Përveç rasteve të mësipërme, ka edhe gjoba të cilat janë vendosur në vitin 2025, përpara se ju të emëroheshit titullar i IMTV Bashkia Vlorë, por periudha në të cilën duhet bërë kërkesë për ekzekutimin e tyre, përkon me periudhën që ju keni qenë titullar i IMTV Bashkia Vlorë, për të cilat bie mbi ju përgjegjësia për mosvendosjen në ekzekutim, sepse detyra e titullarit të IMTV është në vazhdim dhe lidhet me pozicionin dhe jo me personin. Pra pavarësisht se kush emërohet, në momentin që emërohet në detyrë, merrë në dorëzim punën e bërë nga titullari i mëparshëm, dhe vazhdon zbatimin e detyrave të papërfunduara dhe atyre të krijuara gjatë ushtrimit të funksionit të vetë.
Lidhur me lejen vjetore, ju nuk keni paraqitur dokumentacion vërtetues për kërkesën për leje dhe miratimin e saj, si dhe personin të cilit i janë deleguar detyrat e titullarit të IMTV gjatë kryerjes së lejes. Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Masat shtrënguese për arkëtimin e borxhit.

Për vitin 2025 ka ecuri lidhur me masat shtrënguese por nuk janë ezauruar të plota sipas përcaktimeve ligjore. Nuk është kryer një analizë e detajuar për secilin nga këta debitor tatimpagues për nxjerrë shkakun e mos mbledhjeve të detyrimeve.
Nga auditimi rezultoi se, Sektori i Borxhit dhe Kontabilitetit ka njoftuar bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se për vitin 2025 për debitorët, janë marrë masat si më poshtë vijojnë:

Tabela e njoftimeve

Nr.	Njoftime Tatimpaguesve	Nr. Njoftimeve
1	Njoftim dhe kërkesë për pagesë të debisë	2095
2	Njoftim për vendosje të barrës siguruese	1552
	Totali njoftimeve tatimpaguesve	**3647**

Tabela e masave shtrënguese

Nr.	Masa shtrënguese ndaj tatimpaguesve	Nr. Bllokimeve
1	Bllokime te llogarive bankare	4411
2	Vendosje të barrës ndaj titujve në QKB	209
	Totali bllokimeve	**4620**

Tabela e masave ekzekutuese

Masa ekzekutuese	Nr. Ekzekutimeve
Urdhra Ekzekutimi	**139**

Nga aplikimi i masave të mësipërme ka rezultuar se përgjatë vitit 2025 është arritur të arkëtohet vlera prej 104,566,000 lekë, si më poshtë:

Plani vjetor	Fakti 12 mujor	Realizimi në %	Nr. Debitorëve të paguar
85,000,000	104,566,000	123%	2951

Referuar të dhënave, rezultoi se sektori i borxhit ka arritur të realizojë planin e mbledhjes së borxhit me tejkalim në masën 123%, ku është planifikuar mbledhja e borxhit në vlerën 85,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 104,566,000 lekë.
Nga auditimi i dokumentacionit dhe praktikave të ndjekura për mbledhjen e të ardhurave dhe menaxhimin e arkëtimin e borxhit rezultoi se administrimi i procesit për mbledhjen e detyrimeve tatimore ka mangësi, duke mos ezauruar të gjitha hapat dhe mekanizmat e përcaktuar në legjislacionin tatimor për të siguruar mbledhjen e këtyre detyrimeve.
Në lidhje me këtë situatë, Sektori i Borxhit ka dërguar njoftim detyrimin për 2095 subjektet debitorë, urdhër bllokimet e llogarive të bankave të nivelit të dytë për 4411 subjekte debitore, njoftim për vendosje të barrës siguruese për 1552 debitorë, vendosje të barrës ndaj titujve në QKB për 209 subjekte debitorë si dhe 139 urdhra ekzekutimi për 139 debitorë, por nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese për debitorët si konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit, masë të sigurimit mbi pasurinë e taksapaguesit debitor, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë, si dhe deri në kallëzim penal sipas kërkesave të Udhëzimit të përbashkët nr. 17, datë 20.6.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore".
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi*: z. S.K, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për periudhën deri më datë 14.07.2025, z. F.Ll, me detyrë Drejtor i Komanduar i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për periudhën Korrik - Dhjetor 2025.*

Përdorimi i të ardhurave.
Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2025 është realizuar në vlerën 1,136,699,783 lekë, ose **0.3%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2025, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për shpenzime operative, paga dhe investime.

Tabela nr.30 Përdorimi i të ardhurave 2025

Art.	Emërtimi	Të ardhurat e veta
600	Paga	292,861,832
601	Sigurime Shoqërore	48,415,332
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	421,839,119
603	Shpenzime	43,306,944
651	Shpenzime	679,089
604	Trans. Institucioneve	16,000,000
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	1,769,500
166	Shpenzime	11,220,150
230-231	Kapitale të Trupëzuara	300,607,817
Total		**1,136,699,783**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

III.2.2.3. Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025.
-Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.
-Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
-Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit.

Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
Për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të

pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2025, konkretisht:

Pasqyrat Financiare të vitit 2025.

- Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2025 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:
  - Pasqyrat financiare të vitit 2025;
  - Llogaritë analitike;
  - Ditari i Bankës;
  - Ditari i Arkës;
  - Ditari i Magazinës;
  - Ditari i Veprimeve të ndryshme;
  - Aktrakordimet me Degën e Thesarit Vlorë;
  - Inventarët etj.

- Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:
Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligji nr. 68, datë 227.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Dokumentacioni i audituar.

1. Pasqyrat financiare të vitit 2025 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve të aktiveve, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur.
5. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Vlorë në mbyllje të vitit buxhetor.
6. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet "Excel" si: Për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet të ardhurat etj)

Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.

Bashkia Vlorë për vitin 2025 ka hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara, pasi ka në varësi njësi shpenzuese me nipt më vete si më poshtë:

1. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike;
2. Ndërmarrja e Mbetjeve të Ngurta;
3. Klubi Shumësportësh Flamurtari;
4. Teatri "Petro Marko";
5. Qendra e Kulturës;
6. Shtëpia e Fëmijës;
7. Qendra e Zhvillimit PAK.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Vlorë për vitin ushtrimor 2025 me shkresë përcjellëse nr.prot.6216, datë 31.03.2026. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori Financës. Pra në këtë rast nuk kemi delegime të detyrave.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël.

Për tu siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- mosndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabiltetit të Aparatit Bashkisë.

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:
- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel";
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë dhe justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së raportimit financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Vlorë për aktivitetin ekonomiko - financiar për vitin 2025.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së auditimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2025 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2024.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 rezultoi se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 "Disponibilitete në Thesar" dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin nr.5 "Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2025".

Lëvizja e llogarisë nr.520 "Disponibilitete në Thesar"

I.Të trashëguara nga viti 2024	**Lekë**
Sipas aktit të rakordimit për shumën. Nga të cilat:	
Granti i trashëguar	403,211,791
Të ardhura të trashëguara	1,129,676,759
Mjete në ruajtje të trashëguara (llog. 466)	61,251,238
Fonde specifike	158,547,552
FSHZH	
Totali	**1,752,687,340**
II.Të hyrat (Shtesat debitore) gjatë vitit 2025	
Granti i vitit	882,466,209
Të ardhurat e vitit	3,430,056,911
Të hyra nga mjetet në ruajtje	32,953,086
Granti specifik	620,877,572
FSHZH	
buxheti	1,260,721,435
Tot.	6,227,075,213
Totali i të ardhurave (I+II)	**7,979,762,553**
III.Lëvizjet kreditore të llogarisë 520 gjate vitit 2025	
Paga sigurime (600+601)	1,526,381,052
Shpenzime operative (602)	750,512,621
Subvencione (603)	53,783,684
Transferime korente të brendshme (604)	20,684,570
Transferime korente me jashtë (605)	
Transferime për buxhetet familjare dhe individë (606)	716,437,307
Kredia + Interesa për huamarje (651)	
Investime (231)	756,533,344
Inters kredie (651)	679,089
Pagese ket kredie (166)	11,220,150
Të dala nga mjetet në ruajtje (466)	4,820,435
Transferime korente te brendshme + transferta buxhetin e vet	
Totali	**3,841,052,252**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Totali i Aktivit për vitin 2025 është në vlerën 11,303,401,963 lekë, i paraqitur në formatin nr.1 të PF, si dhe i zbërthyer në llogari sintetike dhe analitike[17].

A. Aktive afatshkurtra

Në formatin nr.1 "Aktivet Afatshkurtra" në aktiv të bilancit paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 154,569,840 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 5,630,460,972 lekë.

Klasa 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 139,132,329 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI "Teprica e likujditeteve në fund të vitit ushtrimor" në Formatin nr.3 "Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Floë) sipas metodës direkte".

- Gjendja e llogarisë nr.520 "Disponibilitete në Thesar", sipas bilancit në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 138,925,329 lekë, gjendje e cila rakordon me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 "Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2025".
- Gjendja e llogarisë nr.532 "Vlera te tjera", sipas bilancit në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 207,000 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit.

[17] Tabela nr.31 "Aktivet" është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 62,085,978 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 64,468,633 lekë, ku diferenca e tyre në ulje në vlerën prej (2,382,655) lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:
- Gjendja e llogarisë nr.31 “Materiale” paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 12,498,166 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 20,086,189 lekë, me një diferencë për vitin ushtrimor prej 12,498,166 lekë, e cila përfaqëson paksim të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2025.
- Gjendja e llogarisë nr.32 “Inventari i imët” paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 44,382,444 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 49,587,812 lekë me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 5,205,368 lekë, e cila përfaqëson rritje të inventarit të imët për vitin 2025.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,429.242.665 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,336,685,867 lekë, ku kemi shtesë në shumën 92,556,798 duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes së detyrimeve të debitorëve të ndryshëm
- Gjendja e llogarisë nr.437, 438 “Organizma të tjerë shtetërore” në aktiv të bilancit paraqitet si në mbyllje të vitit 2025 dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 135,335 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,277,552,970 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 1,246,571,122 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024 ka pësuar një rritje prej 30,981,848 lekë, e cila i përket debitorëve të krijuar gjatë vitit 2025 nga taksat dhe tarifat vendore. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të krijuar në vitin 2025 nga detyrimet e lindura nga IMTV në shumën 80,673,000 lekë dhe debitorët nga taksat dhe tarifat vendore në vlerë progresive prej 525,693,272 lekë. Pjesa tjetër janë të drejtat të konstatuara nga të tretët për detyrime, për taksën në infrastrukturë nga legalizimet, nga Ujësjellësi si agjent tatimor, nga detyrime kontraktore për qiradhënie etj. Analiza e gjendjes së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuara në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Gjendja 31.12.2024	Pagesat e kryera gjatë vitit 2025	Vlera e debitorëve të krijuar vetëm gjatë vitit 2025	Detyrimi progresiv i debitorëve më 31.12.2025
1	Debitor ne vite	2,495,699			2,495,699
2	Debitor pulla	397,000		255,000	652,000
3	Vërtetime rajone	658,400	101,000		557,400
4	Bileta tregu	30,600			30,600
5	Debitor KLSH	8,680,526			8,680,526
6	IMTV	428,090,000	7,362,000	27,656,000	448,384,000
7	Njësia Nevosel	7,238,201			7,238,201
8	Njësia Orikumi	15,922,745			15,922,745
9	Njësia Shushice	1,041,663			1,041,663
10	Njësia Qender	895,111			895,111
11	Gjoba Policia	216,000	8,211,708	8,211,708	216,000
12	Debitor Tatimet	491,582,652		34,110,620	525,693,272
13	Legalizimet	98,414,672	3,093,527	3,566,759	98,887,904
14	Ujësjellësi	190,916,853	24,000,000		166,916,853
	TOTALI	**1,246,580,122**	**42,768,235**	**73,800,087**	**1,277,611,974**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

- Gjendja e llogarisë nr.4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në shumën 151,554,360 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin Dhjetor 2025, që trashëgohen në vitin 2026. Kjo gjendje ka në analizë ose përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llogarinë nr.401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 4,564,897 lekë, llogarinë nr.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 55,007,914 lekë, llogarinë nr.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 5,137,998 lekë, llogarinë nr.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 16,712,640 lekë, llogarinë nr.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 2,309.285 lekë. dhe llogarinë nr.467 "Kreditorë të ndryshëm" në shumën 67,821,626 lekë të planifikuar për likujdim në vitin 2026. Gjendja e

llogarinë nr.4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)" pasqyron detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundërparti në pasiv të bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Aktive afatgjata materiale.

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:
Aktivet ekzistojnë, i përkasin subjektit, janë të vlerësuara në mënyrë korrekte, janë regjistruar në mënyrë korrekte, është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:
- Për auditimin e aktiveve afatgjata materiale, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata materiale në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore.
- U verifikua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet afatgjata materiale.
- U verifikuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta.
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm.
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
- Për aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë)
- Për aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për t'u siguruar që subjekti:
- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 "Aktivet Afatgjata" në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 5,672,940,991 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 5,056,122,213 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 6,877,996,527 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 6,789,603,971 lekë të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 "Aktive Afatgjata jo materiale" që përbëhet nga**:**

Gjendja e llogarisë nr.202 "Studime dhe kërkime"[18] në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto si në mbyllje të vitit 2025 dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën prej 115,857,512 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 115,857,512 lekë.
Konkluzion**:** Referuar analizës së llogarisë 202 "Studime dhe projektime" me gjendje në vlerën 115,857,512 lekë, e cila përfaqëson vlerën e 52 projekt-studimeve e pa shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Ndërsa vlera prej 9,812,760 lekë e emërtuar "Të tjera" nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2025.
Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) "Aktivet afatgjata materiale" paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 4,343,592,304 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën totale prej 4,465,960,983 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 6,762,139,015 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 6,673,746,459 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:
- Gjendja e llogarisë nr.210 "Toka, Troje, Terrene"[19] paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 132,446,707 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 132,448,707 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" si në mbyllje të vitit 2025 është 132,446,707 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 132,446,707 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.211 "Pyje, Plantacione" paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 0 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.212 "Ndërtesa Konstruksione"[20] paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 967,641,914 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,018,570,430 lekë, ndërsa Gjendja me kosto historike sipas formatit nr.7/b paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,488,986,380 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,488,986,380 lekë. Gjatë vitit 2025 janë pakësuar aktive për shkak të amortizimit në vlerën 50,928,522 lekë.
Konkluzion: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 212 "Ndërtesa konstruksione" sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 e analizuar për 193 artikuj kontabël në vlerën prej 1,488,986,380 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" konstatohet se, në këtë llogari ka analizë më vete për vlerat e rikonstruksioneve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, të cilat nuk i janë shtuar vlerës së aktivit pas investimeve të kryera. Gjithashtu në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 7 artikuj aktive materiale në vlerën 96,594,903 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit të llogarive 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" në vlerën 88,775,097 lekë, llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene" në vlerën 7,819,806 lekë.

Aktivet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi
1	Trotuari Plazhi "Aulona"
2	Rrjeti ujësjellësit Rruga Nr.1 ndërt.dhjetor.2002

[18] Tabela nr.32 e llogarisë nr.202 është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
[19] Tabela nr.33 e llogarisë nr.210 është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
[20] Tabela nr.34 e llogarisë nr.212 është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nr.	Emërtimi
3	Rikonstruksion rrugës Zigur Lelo
4	Shpronësim M.K Uji Ftohtë
5	Veshje me beton kanale
6	Rrugë varrezash për fshatrat
7	Depo uji Zvërnec

- Gjendja e llogarisë nr.213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"[21] paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 2,868,523,750 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në 3,019,498,684 lekë. Gjendja me kosto historike sipas formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 4,592,327,159 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 4,592,327,159 lekë.

Konkluzion: Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" sipas Formatit nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në vlerën 4,592,327,159 lekë në mbyllje të vitit 2025 e analizuar në 329 artikuj aktivesh. Referuar analizës së kësaj gjendje konstatohet se në këtë llogari ka analizë më vete vlera të rikonstruksioneve, mbikëqyrjeve dhe kolaudimi të cilat nuk janë shtuar vlerës së aktivit për investime të kryera. Gjithashtu në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 30 artikuj aktive materiale në vlerën 103,720,750 lekë që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël. Gjithashtu në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë vlera 37,387,815 lekë e emërtuar "Të tjera", e cila është e pa analizuar[22].

- Gjendja e llogarisë nr.214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 320,408,785 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 259,543,796 lekë. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas formatit nr.7/b paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 389,091,008 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 324,829,055 lekë ku është pakësuar gjatë vitit 2025 për shkak të amortizimit 3,396,962 lekë dhe është shtuar në vlerën 79,417,054 lekë dhe është pakësuar në shumën 15,155,103 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.215 "Mjete Transporti"[23] në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 50,424,401 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 30,756,426 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet si në mbyllje të vitit 2025 130,288,250 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 104,438,190 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.218 në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 4,118,747 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 5,145,934 lekë. Ndërsa sipas formatit nr.7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 28,999,513 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 30,718,968 lekë. Diferenca në vlerën 1,719,455 lekë përgjatë vitit 2025 është si pasojë e nxjerrjes jashtë përdorimit.
- Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2025 paraqiten në Formatin nr.7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)"[24]
- Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale paraqitet në bilanc në vlerën 2,510,396,322 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

Inventarizimi i aktiveve.

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2025 për Bashkinë Vlorë dhe institucionet në varësi.

Për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2025 kanë dalë urdhrat e titullarit me nr. prot., 733, datë 17.01.2025 dhe nr.734, datë 17.01.2026 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe inventarit në përdorim për vitin 2025". Në bazë të urdhrave janë përcaktuar komisionet e inventarizimit sipas objekteve ku do kryhet

[21] Tabela nr.35 e llogarisë nr.213 është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
[22] Tabela nr.36 me aktivet e klasifikuara gabim është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
[23] Tabela nr.37 e llogarisë nr.215 është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
[24] Tabela nr.38 Formati nr.7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

inventarizimi. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se, komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Aparatin e Bashkisë dhe për institucionet në varësi si, kopshtet dhe çerdhet (qytet dhe fshat), Qendra Kulturore e Fëmijëve. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit Dhjetor 2025 dhe rezultojnë pa diferenca. Është hartuar një relacion përmbledhës për gjithë inventarin e AAGJM, ku përshkruhen mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë nr.26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vetë" në fund të vitit 2024 paraqitet me vlerën 2,000,000 lekë, e njëjtë edhe në fund të vitit 2025. Nga verifikimi i kryer në databazën e QKB-së, rezultoi se Bashkia Vlorë zotëron aksione në disa Shoqëri Aksionare. Konkretisht Bashkia Vlorë, zotëron aksione në:

Vlora Parking Sh.A me NIPT M56403202P, 100% të aksioneve me vlerë 3,500,000 lekë; Markata e Peshkut Sh.A me NIPT M46723211H, 100% të aksioneve me vlerë 3,500,000 lekë; Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë Sh.A, 41.35% të aksioneve me vlerë 4,135,000 lekë; K.F.Oriku Sh.A me NIPT L36521202N, 100% të aksioneve me vlerë 4,100,000 lekë; Flamurtari Football Club Sh.A me NIPT L17130203I, 100% të aksioneve me vlerë 3,500,000 lekë; Tregu Shitjes me Shumicë Frut-Perim Sh.A me NIPT K67217201D, 100% të aksioneve me vlerë 156,816,000 lekë.

- Gjendja e llogarisë nr.231"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"[25] në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 1,303,339,786 lekë, ku sipas analizës rezultoi që kjo llogari paraqet vlerën pjesore të paguar të kontratave të investimeve që janë në vazhdim të pa kapitalizuar.

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël[26].

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive debitore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,518,833,554 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- Gjendja e llogarisë nr.401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarie në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 4,564,897 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,240,618 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.42 "Detyrime ndaj personelit" paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën 550,007,914 lekë e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2025 për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2026.
- Gjendja e llogarisë nr.431 "Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat" paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën kontabël 5,137,998 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2025 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në muajin Janar të vitit 2026.
- Gjendja e llogarisë nr.435 "Sigurime shoqërore" paraqitet në fund të vitit 2025 në vlerën 16,712,840 lekë, të llogaritura për t'u paguar në muajin Janar të vitit 2026.
- Gjendja e llogarisë nr.436 "Sigurime shëndetësore" në fund të vitit 2025 është në vlerën kontabël 22,309,285 lekë, të llogaritura për t'u paguar në muajin Janar të vitit 2026.
- Gjendja e llogarisë nr.44 "Institucione të tjera publike" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 859,000 lekë.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë nr.466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 89,383,889 lekë. Për llogarinë nr.466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Vlorë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2025, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të

[25] Tabela nr.39 e llogarisë nr.231 është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

[26] Tabela nr.40 "Pasivet" është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë nr.466. Vlera e garancive të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes është 51,904,240 lekë. Llogaria nr.466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" është mbivlerësuar për 51,904,240 lekë[27] për vitin 2025.

- Gjendja e llogarisë nr.467 "Kreditorë të ndryshëm"[28] në mbyllje të vitit 2025 është në vlerën 67,821,826 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 7,282,211 lekë.

Pasqyra e Performancës financiare (F2)

Të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Vlorë më datë 31.12.2025 janë të kuadruar me Degën e Thesarit Vlorë, konkretisht:

Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera
-Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	3,244,677,598	Aktrakordimin me Degën e Thesarit	3,044,674,608
-Granti nga buxheti		Sipas çeljes së buxhetit nga MFE	2,566,510,877
-Financim i pritshëm nga buxheti	2,566,510,877	Sipas llogarisë 7206	
-Fonde buxhetore të trashëguara		aktrakordim Degën e Thesarit	
-Të ardhura të trashëguara (rez)	1,891,438,102	Nga rezultati i vitit të mëparshëm	1,891,438,102
-Llog 73 Ndryshim i gjendjes me (+)		Sipas llog 63 me (+)	
Totali të ardhura	**7,702,626,577**	**Totali të ardhura**	**7,502,623,587**

Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2025	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	1,310,801,390	60,145,912	839,190,514
601	215,579,662	19,021,925	137,275,472
602	750,512,595	30,194,705	480,245,646
603	53,783,684		53,783,684
651	679,089		
604	20,684,570		905,888,521
166	11,220,150		
606	716,437,307		716,437,307
466	4,820,435	89,383,889	
63			2,382,655
231	756,533,344	42,191,818	317,878,348
Totali	**3,841,052,226**	**240,938,249**	**3,453,082,147**

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Analizë: Formati nr.2 "Pasqyra e përformancës financiare" paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën **7,502,623,587** lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Vlorë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë sintetike nr.70 "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet" paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 2,429,924,211 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.7009 "Të tjera tatime mbi të ardhurat" pasqyrohet në bilanc për vitin2025 në vlerën 1,380,487 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.7029 "Tatim mbi pasurinë e paluajtshme" pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 325,149,447 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.7035 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejimin e veprimtarisë" pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 2,103,411,297 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.71 "Të ardhurat jo tatimore" paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 814,756,397 lekë.

Gjendja e llogarisë nr.72 "Grante Korrente" është në vlerën prej 2,568,510,877 lekë, vlerë e cila përbëhet nga:

- Gjendja e llogarisë nr.7200 "Nga buxheti për NJQP (Qendrore)" paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 728,017,431 lekë.

[27] Tabela nr.41 e llogarisë nr.466 është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

[28] Tabela nr.42 e llogarisë nr.467 është pasqyruar në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Gjendja e llogarisë nr.7201 “Nga buxheti për NJQP (Vendore)” paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 1,503,343,781 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.7204 “Pjesëmarrja e institucioneve në tatime nacionale” paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 1,160,108,130 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.787 “Tërheqje nga seksioni i investimeve” paraqitet në bilancin e vitit 2025 në vlerën 1,691,436,102 lekë.
- Gjendja llogarisë nr.7206 “Financim i pritshëm në vlerën 151,554,360 lekë vlerë e cila rakordon me gjendjen e llogarisë nr.4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në formatin nr.1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, pasi kjo gjendje pasqyron detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.
- Të ardhura të trashëguara në vlerën 1,691,436,102 lekë.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 3,453,082,147 lekë si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Vlorë paraqiten më poshtë:
- Gjendja e llogarisë nr.600 “Paga, shpërblime e të tjera personeli” për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 839,190,514 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.601 “Kontribute për sigurime” për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 1,137,275,472 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.602 “Blerje mallra e shërbime” paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 480,145,648 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.603 “Subvencion” paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 53,783,684 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.604 “Transferime korrente të brendshme” paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 905,888,521 lekë.
- Gjendja e llogarisë nr.606 “Transferime për buxhetet familjare e individë” paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 716,437,307 lekë.
- Gjendja e llogarisë “Shpenzime të tjera” për vitin 2025 paraqitet në bilanc në vlerën 317,878,348 lekë.

Për vitin 2025 totali i të ardhurave në vlerë është 7,502,623,587 lekë dhe totali shpenzimeve është 3,453,082,147 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 4,049,541,440 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatin e ushtrimit”.
Gjithashtu gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” është barabartë me ndryshimin e gjendjes së klasës 3 në formatin nr.1 të bilancit, ku për vitin 2025 është në vlerën -2,382,655 lekë.

Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”
- Zëri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën 739,187,457 lekë në analizë tregon burimet e investimit nga buxheti i shtetit në vlerën 444,724,585 lekë dhe nga fonde të veta në vlerën 294,482,872 lekë.

Nga testi kontrollit për vitet 2025 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:
Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:
Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limitin e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëhen derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit. Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konformë nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

III.2.2.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm[29].

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit "Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm" u krye auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH.

Kuadri rregullator i verifikimit të zbatimit rekomandimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në:

I. Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

-Neni 15, Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së ku parashikohet se: Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet:

j) të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës;

-Neni 30 - Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, ku parashikohet se: Në raportet e tij, Kontrolli i Lartë i Shtetit jep rekomandime në përputhje me nenin 15 të këtij ligji. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

II. Manualin për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, miratuar me Vendimin nr.XX, datë 22.06.2026 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

1. Auditimi i fundit në Bashkinë Vlorë.

Auditimi i fundit në Bashkinë Vlorë është kryer në vitin 2025 për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2024. Raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 601/45 prot., datë 31.12.2025. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 40 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 19 masa për shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën 6,744,090 lekë, pranuar nga subjekti;
- 15 masa për elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin e të ardhurave të munguara, pranuar nga subjekti;
- 6 masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, pranuar nga subjekti;
- 41 masa disiplinore, pranuar nga subjekti.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, germa "j", Bashkia Vlorë duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e Raportit Përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Vlorë ka hartuar Plan Veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 426/2 prot., datë 30.01.2026.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar shkresës nr. 601/45 prot., datë 31.12.2025, për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe rekomandimeve është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, pika 2. Sipas verifikimit Bashkia Vlorë nuk ka kthyer përgjigje në KLSH.

[29] Për zbatimin e rekomandimeve nga subjekti i audituar Bashkia Vlorë janë paraqitur observacione lidhur me statusin e disa prej rekomandimeve. Observacionet janë pasqyruar në kapitullin "Anekse – Aneksi nr.4" të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4. *Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH.*

Nga verifikimi rezultoi se Bashkia Vlorë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 601/45 prot., datë 31.12.2025, por nuk ka raportuar rregullisht në Këshillin Bashkiak, në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: *5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo audituesë të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.*

5. Mbi nivelin e zbatimin të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Bashkinë Vlorë.

Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:

Masa organizative

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Vlorë 40 masa organizative, nga të cilat 5 janë zbatuar plotësisht, 8 zbatuar pjesërisht dhe 27 pa zbatuar.

Masa për shpërblimin e dëmit ekonomik

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Vlorë 19 masa për shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën 6,744,090 lekë, nga të cilat 4 masa janë zbatuar plotësisht dhe 15 janë zbatuar pjesërisht.

Masa për elimimin e efekteve negative të konstatuara në adnministrimin dhe menaxhimin e të ardhurave të munguara të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Vlorë 15 masa për elimimin e efekteve negative të konstatuara në adnministrimin dhe menaxhimin e të ardhurave të munguara të lëna në auditimin e mëparshëm, nga të cilat 2 janë zbatuar plotësisht, 12 zbatuar pjesërisht dhe 1 pa zbatuar.

Masa për elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Vlorë 6 masa për elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, nga të cilat 6 janë pazbatuar.

Masa disiplinore

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Vlorë, masa disiplinore për 41 persona, të cilat janë zbatuar plotësisht.

Masa organizative të lëna në auditimin e mëparshëm.

1.1 - Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për:

- Evidentimin e nevojave të stafit për trajnim, si dhe hartimin e planit vjetor për trajnimin e punonjësve, me qëllim ngritjen e nivelit profesionale të tyre.
- Hartimin e dokumentit të gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës dhe për të gjitha drejtoritë dhe sektorët. Të hartohet ndarja e proceseve të punës dhe përcaktimi i detyrave që ka secili punonjës
- Plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacion origjinal apo fotokopje të noterizuara, inventarizimin e tyre, si dhe të ë plotësohet formulari i vlerësimit të performancës, si pjesë e dosjeve të personeli.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vlorë nuk është marrë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse,*

sipas programit të auditimit nr. 739/1, datë 01.07.2026. Rekomandimet e përsëritura do të unifikohen në një të vetme dhe do të rikërkohen për zbatim në vijim të këtij auditimi.
Rekomandimi është i pazbatuar.

2.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Njësinë e Auditimit të Brendshëm, gjatë veprimtarisë audituese të marrë masa të kryejë auditime në fusha që paraqesin risk të lartë dhe që nuk janë audituar në këtë Bashki, si edhe të plotësojë dosjen e auditimit sipas kërkesave të përcaktuara në Manualin e Auditimit, me qëllim kryerjen e misionit të auditimit që i shërben përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë së institucionit.
- Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, si një organ i pavarur.
- Në raportet e hartuara në përfundim të çdo angazhim auditimi, audituesit të respektojnë strukturën e përcaktuar dhe të plotësojnë opinionin e përgjithshëm lidhur me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vlorë nuk është marrë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit nr. 739/1, datë 01.07.2026. Rekomandimet e përsëritura do të unifikohen në një të vetme dhe do të rikërkohen për zbatim në vijim të këtij auditimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

3.1- Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vlorë, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë financimin i detyrimeve të prapambetura dhe për likuidimin e tyre të hartojë plane të detajuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vlorë Janë parashikuar fondet përkatëse në buxhet dhe janë hartuar planet e likujdimit të detyrimeve të prapambetura. Monitorimi i detyrimeve kryhet në mënyrë periodike.*
Rekomandimi është i zbatuar plotësisht.

4.1. Rekomandimi: Drejtoritë përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore dhe Njësitë Administrative, të marrin masa për mbajtjen e regjistrave me të dhëna të sakta dhe të plota për subjektet që administrojnë, si private ashtu edhe familjarë, duke pasqyruar rregullisht përllogaritjet për vlerat që do tarifohen dhe ato që do arkëtohen, si dhe gjendjet debitorë për secilin subjekt, si dhe të rakordohen periodikisht me Drejtorinë Ekonomike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vlorë është punuar dhe janë dërguar njoftim vlerësimi për secilin subjekt sipas listës së lënë nga KLSH.*
Gjithashtu, janë përcaktuar procedura për rakordimin periodik të të dhënave ndërmjet drejtorisë përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, Njësive Administrative dhe Qendrës Ekonomike, me qëllim garantimin e saktësisë së informacionit financiar, evidentimin në kohë të diferencave dhe marrjen e masave për korrigjimin e tyre. Zbatimi i këtij rekomandimi është pjesë e masave për forcimin e kontrollit të brendshëm, rritjen e cilësisë së administrimit të të ardhurave vendore dhe përmirësimin e procesit të evidentimit, ndjekjes dhe arkëtimit të detyrimeve ndaj Bashkisë. Procesi do të vijojë të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga strukturat përgjegjëse, me qëllim sigurimin e zbatimit të plotë dhe të qëndrueshëm të rekomandimit. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime

që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit nr. 739/1, datë 01.07.2026. Rekomandimet e përsëritura do të unifikohen në një të vetme dhe do të rikërkohen për zbatim në vijim të këtij auditimi.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

4.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të analizojë mundësinë e ndryshimeve në strukturat aktuale përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, duke i centralizuar këto përgjegjësi, me qëllim planifikimin dhe koordinimin më të saktë të treguesve mbi taksat dhe tarifat vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vlorë - Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka nisur procesin e plotësimit dhe përditësimit të regjistrit elektronik me të dhënat e plota për subjektet e biznesit, duke administruar dhe dokumentacionin vërtetues për llojin e aktivitetit, sipërfaqen e ambienteve, xhiron vjetore dhe elementët e tjerë të nevojshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
Në bashkëpunim me shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Vlorë po punohet për përmirësimin e shkëmbimit të informacionit, me qëllim që Bashkia të disponojë të dhëna më të detajuara mbi numrin e abonentëve familjarë, detyrimet e tyre, pagesat dhe debitorët, duke mundësuar verifikimin dhe rakordimin periodik të të dhënave.
Drejtorive përgjegjëse që administrojnë taksa dhe tarifa vendore u janë dhënë udhëzimet për krijimin dhe administrimin e regjistrave përkatës, sipas fushës së përgjegjësisë, me qëllim sigurimin e gjurmueshmërisë së të dhënave dhe përmirësimin e kontrollit administrativ. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit nr. 739/1, datë 01.07.2026. Rekomandimet e përsëritura do të unifikohen në një të vetme dhe do të rikërkohen për zbatim në vijim të këtij auditimi.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

5.1- Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Vlorë, të marrë masa për rishikimin dhe saktësimin e regjistrit të taksapaguesve kategoria biznes, duke përshtatur kategorinë/nënkategorinë me "*Veprimtarinë"* që ushtron subjekti për llogaritjen e saktë të detyrimeve, si dhe të kryejë inventarizimin e të gjithë subjekteve të cilët janë objekt i taksave vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vlorë është realizuar sipas kontratës së lidhur me IBS me nr 11840/12 datë 08.11.2024.*
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

6.1- Rekomandimi: Bashkia Vlorë, të marrë masa për monitorimin e procesit të grumbullimit përpunimit ruajtjes së informacionit dhe gjenerimit të raporteve të sakta dhe në kohë për subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj, me cilësi dhe konform standarteve të përcaktuara në kuadrin rregullator.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë ka nisur vlerësimin e strukturës organizative dhe marrjen e masave administrative për forcimin e funksionit të teknologjisë së informacionit, duke shqyrtuar mundësinë e organizimit të tij në nivel drejtorie ose strukturë të dedikuar, sipas nevojave dhe kapaciteteve të institucionit.*

Marrjen e masave për zhvillimin e kapaciteteve të auditimit të brendshëm në fushën e teknologjisë së informacionit, përmes trajnimeve, ngritjes së kapaciteteve profesionale ose plotësimit të strukturës me specialistë të profilit IT, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
Vendosjen e procedurave të dokumentuara për monitorimin periodik të funksionimit të sistemit, duke siguruar rakordimin e raporteve të gjeneruara nga sistemi me evidencat e përpunuara nga strukturat përgjegjëse, dokumentimin e çdo rakordimi dhe ruajtjen e gjurmës së kontrollit për proceset e përpunimit dhe raportimit të të dhënave.
Evidentimin dhe dokumentimin periodik të të gjitha veprimeve të monitorimit dhe kontrollit mbi sistemin, me qëllim garantimin e integritetit, sigurisë dhe besueshmërisë së të dhënave, si dhe përputhshmërisë me standardet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

7.1- Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit në Bashkinë Vlorë të analizojë dhe rishikojë dokumentacionin financiar të trashëguar nga ish-komunat dhe të kryejë inventarin fizik në NjA për identifikimin analitik të aktiveve që përfshijnë këto vlera.
Të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për kalimin e vlerave të aktiveve sipas llojit përkatës, duke i evidentuar në llogaritë e përshtatshme sipas klasifikimit, si dhe të bëhen korrektimet e nevojshme në llogaritjen e amortizimit.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë ka nisur procesin e analizës së dokumentacionit financiar të trashëguar nga ish-komunat dhe inventarizimi fizik në Njësitë Administrative. Në bashkëpunim me strukturat përkatëse po vijon identifikimi dhe sistemimi kontabël i aktiveve, si dhe korrektimi i amortizimit. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit nr. 739/1, datë 01.07.2026. Rekomandimet e përsëritura do të unifikohen në një të vetme dhe do të rikërkohen për zbatim në vijim të këtij auditimi.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

8.1- Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit në Bashkinë Vlorë të analizojë dokumentacionin financiar të arkivuar të ish-komunave dhe bashkisë për identifikimin e projekt-studimeve gjendje e llogarinë 202 "*Studime dhe kërkime*", ku vlerat e tyre ti kalojnë AAGJM-ve përkatëse dhe për pjesën e mbetur të përllogarisë amortizimin e tyre, veprime të cilat të evidentohen nëpërmjet sistemimeve kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2025.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë ka kryer analizën e dokumentacionit financiar të arkivuar dhe janë realizuar veprimet sistemuese kontabël për pasqyrimin e vlerave sipas klasifikimit përkatës. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit nr. 739/1, datë 01.07.2026. Rekomandimet e përsëritura do të unifikohen në një të vetme dhe do të rikërkohen për zbatim në vijim të këtij auditimi.*
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

9.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit të kryejë procedurat ligjore për transferimin e aktiveve që i përkasin ujësjellësve të rrjetit shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji në "Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime, Vlorë" dhe të kryhen veprimet sistemuese kontabël në llogarinë *213"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve Vlorë sh.a, po ndjek procedurat për evidentimin dhe transferimin e aktiveve përkatëse. Procesi vijon në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat administrative.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

10.1- Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit për 179 objekte inventari të pasurive të paluajtshme (ndërtesa) me kosto historike në vlerën 1,488,986,380 lekë të marrin masa që të kryhen procedurat e plota për hipotekimin dhe certifikimin në ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë, në mënyrë që këto aktive kjo njësi vendore ti zotërojë e të sigurojë njohjen në kontabilitet mbi bazën e dokumenteve ligjorë.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë me urdhrin nr.1057/2026 është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe realizimin e procesit të inventarizimit dhe regjistrimit të pronave të Bashkisë Vlorë. Pas administrimit të dokumentacionit përkatës do të vijohen procedurat për regjistrimin dhe certifikimin e pasurive pranë ASHK-së.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

11.1- Rekomandimi: Qendra e Turizmit, Artit dhe Kulturës të marrë të gjitha masat e nevojshme për dokumentimin e çdo faze të realizimit të projekteve, duke filluar nga përcaktimi i kritereve që duhet të plotësojnë aplikantët e deri në përcaktimin e strukturave përgjegjëse për ndjekjen, monitorimin dhe procedurat e financimit të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë ka standardizuar formatet e dokumentacionit që shoqërojnë projekt-propozimet, duke kërkuar që çdo aplikim të përmbajë program të detajuar të aktivitetit, preventiv të argumentuar të kostove, relacion teknik dhe financiar, si dhe dokumentacion që provon kapacitetin dhe përvojën e subjektit aplikues për realizimin e aktivitetit.*
Në procedurat e financimit është parashikuar detyrimi që, në rastet e bashkëfinancimit, të evidentohet qartë ndarja e zërave të shpenzimeve sipas burimit të financimit, duke garantuar transparencën dhe gjurmueshmërinë e përdorimit të fondeve publike.
Është forcuar procesi i monitorimit të realizimit të projekteve, duke përcaktuar detyrimin që për çdo aktivitet të hartohet raport monitorimi nga strukturat përgjegjëse të QTAK, i shoqëruar me dokumentacionin provues të realizimit të aktivitetit (material fotografik, materiale audiovizive, procesverbale dhe dokumentacion tjetër mbështetës).
Janë dhënë udhëzime që çdo pagesë ndaj subjekteve përfituese të kryhet vetëm pasi dosja e projektit të jetë e plotësuar me dokumentacionin justifikues financiar, përfshirë situacionet e shpenzimeve sipas zërave, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Drejtoria përgjegjëse e Bashkisë Vlorë dhe QTAK do të ushtrojnë monitorim periodik mbi zbatimin e këtyre procedurave, me qëllim garantimin e ligjshmërisë, transparencës dhe përdorimit me ekonomi, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike të destinuara për mbështetjen e aktiviteteve kulturore.
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

12.1- Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), të marrin masa për shmangien e copëzimit të fondeve dhe grupimin e sa më shumë blerjeve me vlerë të vogël me natyra të njëjta apo zëra të njëjta shpenzimesh, në një procedurë

të vetme, nisur nga fakti se nevojat për shpenzime të njësive publike janë planifikuar dhe miratuar që në hartimin e buxhetit vjetor dhe nuk janë blerje të ndodhura nga situata emergjente.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

13.1- Rekomandimi: Titullari i Ndërmarrjes së Shërbimeve të marrë masa dhe të kërkojë nga NjP dhe KVO respektimin me rigorozitet dhe në mënyrë kronologjike të të gjithë hapave që duhen ndjekur gjatë realizimit të procedurave të prokurimit blerje me vlerë të vogël, duke garantuar dokumentimin e çdo hapi që nga lindja e nevojës për shpenzim e deri në pasqyrimin e plotë të procesit të vlerësimit nga KVO. Procesi të kryhet me përgjegjshmëri vetëm nga personat e ngarkuar me urdhra pune për këtë qëllim.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

14- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, në cilësinë e Titullarit të AK- Bashkia Vlorë, të marrë masa që në asnjë rast të zhvillimit të procedurave të investimeve publike, të mos lidhë kontratën e zbatimit pa miratimin paraprak të "*leje ndërtimi/infrastrukture*" dhe oponencës teknike të objektit ne rastet kur kërkohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

15.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, në cilësinë e Titullarit të AK- Bashkia Vlorë, të marrë masa për hartimin e projekteve nga persona/subjekte të licencuar, sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, në mënyrë që të kemi projekte sa më cilësore dhe që paraqesin gjendjen reale të objektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

16.1- Rekomandimi: Bashkia Vlorë *(Sektori i Procedurave të Prokurimit)* dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike- Bashkia Vlorë, të marrin masa për arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura në të gjitha fazat e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

17.1- Rekomandimi: Drejtoria e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, Drejtoria e Bordit të Kullimit, Drejtoria e Gjelbërimit dhe Pastrimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe të Financës Bashkia Vlorë, gjatë planifikimit në buxhet të fondit për sasinë e karburantit që do prokurohet në periudhë në vijim, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për hartimin e procesverbaleve mbi konsumin për 100/km/ orë pune (pavarësisht librezës së mjeteve), mbi normativën e harxhimit të karburantit, mbi volumin e punës së kryer në vitin që mbyllet dhe të mjeteve që janë gjendje pune.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

18.1- Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të marrë masa të argumentojë dhe dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, duke u mbështetur në specifikimet teknike të objektit që do prokurohet, si dhe të sigurojë krijimin e kushteve për konkurrencë të paanshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

19.1- Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë (*aparati*) dhe NSHP- Bashkia Vlorë (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), të marrë masa për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, specifikimeve teknike dhe kriterit të vlerësimit të ofertave, në mënyrë që të sigurohet transparencë, trajtim i barabartë dhe mos-diskriminim ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe të promovohet konkurrenca, duke garantuar përdorimi me ekonomicitet i fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin*

e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.
Rekomandimi është i pazbatuar.

20.1- Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Vlorë *(aparati)* dhe AK në Ndërmarrja e Shërbimeve Publike-Bashkia Vlorë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e OE, të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DT.
Në çdo rast, gjatë fazës së vlerësimit të një procedure prokurimi, duket të konsiderohet e vlefshme dhe të kualifikohet vetëm ajo ofertë që është plotësisht në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës, ftesës për ofertë ose dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor i ka vlerësuar të domosdoshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

21.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin masat të analizojnë shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit me mungesa në dokumentacion, nxjerrjen e përgjegjësive, si dhe hartimin e një metodologjie të unifikuar për realizimin e këtij procesi.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

22.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin masat të analizojnë shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit që nuk respektojnë kondicionet urbane ligjore, si dhe të nxjerrje përgjegjësitë përkatëse, me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit në përputhje me dokumentet e planifikimit të Bashkisë Vlorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

23.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin të gjitha masat për:
- Të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, mendimin e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Informacioni që mundësojnë DR ASHK, nuk

duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit;
- Të kërkuar dhe respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve, të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, në varësi të tipologjisë së objektit dhe kushteve në të cilat zhvillohet. Për të gjitha rastet në të cilat këto autoritete kërkojnë ndryshimin e projektit ndërtimor ose plotësimin e dokumentacionit, miratimi i lejeve të ndërtimit të kryhet vetëm pasi është rikërkuar mendimi i tyre dhe është marrë miratim pozitiv (ose në heshtje).

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

24.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin të gjitha masat për të:
- Analizuar situatat në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e aplikimeve që vijnë përmes sistemit *e-lejet*, evidentimin e personave përgjegjës, me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit të Bashkisë Vlorë, në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe dispozitat ligjore në fuqi, për ato raste kur: zbatimi i punimeve ka filluar pa u pajisur paraprakisht me dokumentin e konfirmuar të fillimit të punimeve; leja për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit është miratuar pasi ndryshimet e kërkuara janë reflektuar në objektin e zbatuar; projekti i certifikuar ka ndryshime nga projekti i miratuar;
- Rishikuar metodologjinë e miratimit të lejeve për ndryshim projekti gjatë ndërtimit, duke përfshirë në procesin e shqyrtimit të aplikimit kryerjen e inspektimeve në objekt nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, para miratimit të lejeve, me qëllim marrjen e sigurisë së zhvilluesi nuk i ka reflektuar ndryshimet e kërkuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

25.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin të gjitha masat për të analizuar situatën në lidhje me miratimin e certifikatës së përdorimit për *"Godinë 4 kat, me 2 kate nëntokë, me tarracë të shfrytëzueshme të gjelbëruar, me funksion hoteleri dhe shërbime turistike"*, me zhvillues "B 2021" ShPK, miratuar në datën 04.05.2023, në kushtet e mungesës së kompetencës nga Bashkia Vlorë, evidentimin e personave përgjegjës dhe marrjen e masave sipas përcaktimeve ligjore.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*

Rekomandimi është i pazbatuar.

26.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin të gjitha masat për të cituar në dokumentet e emetuar prej saj (gjatë shqyrtimit / miratimit të aplikimeve në sistemin *e-lejet*), se cilët janë personat që kanë kryer shqyrtimin, duke përcaktuar dhe rolet, sipas manualeve të sistemit elektronik të lejeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

27.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Vlorë, të marrë masa për:
- Referimin e bazës ligjore të llogaritjes së masës së gjobës dhe në bashkëpunim me Policinë Bashkiake sipas rastit edhe me IKMT;
- Të vijuar ndërhyrja për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm për **9** raste të vitit 2023 dhe **19** raste të vitit 2024;
- Të kryer kallëzim penal për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi për **3** raste në vitin 2023 dhe **16** raste të vitit 2024 *(Sipas Aneksit 2.5.1 bashkëlidhur RPA).*

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

28.1- Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë, të marrë masa për të pasqyruar situatën e ndërtimit në lidhje me zhvillimin e tre objekteve:
-*"Ndërtimi i pergolatës dhe vendosja e paneleve fotovoltaik"* miratuar me vendimin nr. 218, datë 26.12.2023, në pronësi të "F.I", në adresën rruga "Osman Haxhiu", Vlorë;
-*"Kompleks shërbime turistike dhe shtëpi të dyta në Rradhimë – Vlorë"*, miratuar me vendimin nr.327, datë 05/04/2023, me zhvillues "E" ShPK, në Rradhimë, Vlorë;
-*Godinë banimi dhe shërbime 1-8-9 kate dhe 1 kat nëntokë (objekti 2)"*, miratuar me vendimin nr.585, datë 13/06/2023, me zhvillues "G.K" ShPK, në adresën "Uji i Ftohtë", Vlorë, si dhe të hartojë programe konkrete për të kryer kontrolle për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi, deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe verifikimit e zbatimit të punimeve për deklaratat paraprake të miratuara për kryerjen e punimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

29.1- Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Vlorë, të marrë masa për lëshim "*Urdhrit të Ekzekutimit*" për vjeljen e gjobës nr. 660, datë 18.12.2023, për subjektin S.N (F.K).

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vlorë është bërë kërkesa drejtuar Gjykatës së shkallës së parë Lushnje "Për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për vjeljen e gjobës nr.660 datë 18.12.2023" me Nr.7398.prot datë 15 05.2024.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

30.1- Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Vlorë të marrë masa që:
- Në bashkëpunim me Njësitë Bashkiake dhe me Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, për identifikimi e ndërtuesit të pa ligjshëm të pa identifikuar dhe nxjerrjen e vendimit për "*Dënim me Gjobë*", në përputhje me procesverbal konstatimi për ndërtime informale të mbajtur nga Inspektoret e terrenit, dhe për nxjerrjen e Vendimeve për "*Dënim me Gjobë*" dhe "*Prishje e Objektit të Kundërligjshëm*", në përputhje me procesverbalin e konstatimimit për ndërtime informale të mbajtur nga inspektorët e terrenit për subjektin S.K**.**

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë në të gjitha rastet ku nga ana e IMT Bashkia Vlorë është konstatuar ndërtim pa leje me subjekt të paidentifikuar, është kryer procedura e plotë ligjore Vendim për prishje të objektit, kallëzim penal dhe me shkresa zyrtare i është drejtuar Drejtorisë së Policisë së Shtetit për identifikimin e kundërvajtësit për secilin rast pasi vendimi për dënimin me gjobë nuk mund të merret për një subjekt të paidentifikuar. Referuar P.V nr.07 datë 22.04.2024 me kundërvajtës S.K, vendimi për prishjen e objektit nr.43 datë 30.04.2024, vendimi i dënimit me gjobe nr.43 datë 30.04.2024 për kundërvajtjen "strukturë hekuri dhe pedane" Në P.V e konstatimit është bërë një lapsus në datën e mbajtjes dhe është korrigjuar duke mbajtur brenda afatit të vendimit të prishjes dhe të dënimit me gjobë të cilat janë shoqëruar me njoftimet përkatëse të këtyre vendimeve. Gjoba është përllogaritur në mbështetje të ligjit 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit neni 41 si dhe neni 52 pika d d) mosdeklarimi i punimeve që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje, sipas nenit 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 150 000 lekë.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

31.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë e Mbrojtjes së Mjedisit, të marrin masa për ngritjen e grupeve të punës për verifikimin e tyre në terren, si dhe plotësimin e dokumentacionit ligjor për regjistrimin e ekonomive pyjore të transferuara.

Menjëherë e në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

32.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të marrë masa për ngritjen e Strukturës Përgjegjëse për Menaxhimin e Stacioneve të Plazhit, si dhe për përgatitjen e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara, publike dhe private, sipas koordinatave e miratimin e saj me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Menjëherë e në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

33.1- Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe e Menaxhimit të Aseteve, në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrin masa duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e detyrimeve tatimore për **16** subjektet.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë, Drejtoria e Pronave Publike dhe e Menaxhimit të Aseteve, në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, për ndjekjen e procedurave ligjore me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore për 16 subjektet e evidentuara, procesi i verifikimit dhe koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse vijon me qëllim përcaktimin e hapave të nevojshëm administrativë dhe ligjorë për trajtimin e detyrimeve të evidentuara dhe ndjekjen e procedurave përkatëse në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Bashkia Vlorë do të vijojë angazhimin për adresimin e këtij rekomandimi dhe marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e administrimit dhe ndjekjen e detyrimeve të evidentuara.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

34.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, të marrin masa për plotësimin e dokumentacionit të lejes infrastrukturore për projektin "*Përmirësim i mobilitetit*" pranë zonës urbane te ish –Fusha e Aviacionit Vlorë dhe të fillojë procedurat e shpronësimit në lidhje me pronat private të prekura nga ky projekt.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

34.2- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në Bashkëpunim me Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, të marrin masa për plotësimin e dokumentacionit për shpronësim për interes publik të Pasuritë nr.41 ZK 8602 të regjistruara në pronësi të Bp. G.H, P, M dhe njëkohësisht ndodhen në inventarin paraprak të Bashkisë Vlorë.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

35.1- Rekomandim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë, rekomandohet që në procedurat e ardhshme të kolaudimit të objekteve, të detajohet kontrata ku të përcaktohet afati i kohëzgjatjes

së procesit të kolaudimit vlera e shërbimit të kolaudimit, të drejtat, detyrat dhe penalitetet e secilës palë etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

36.1- Rekomandimi: Kryeinspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Vlorë, të marrë masat për:
- Të hartuar në mënyrë periodike planet mujore / tremujore / vjeçare të punës, si dhe për t'a shpërndarë këtë informacion te strukturat e vartësisë dhe inspektorët;
- Të hartuar në mënyrë periodike çdo tremujor, raportin e aktivitetit të inspektoratit, evidencat si dhe t'a dërgojë këtë informacion tek Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Hartimet periodike të planeve mujore/tre mujore/vjeçare të punës për vitin 2025-2026 si dhe informacionet tre mujore drejtuar IKMT janë realizuar dhe do jenë në vëmendjen e vazhdueshme për IMT Bashkia Vlorë.*
Rekomandimi është i zbatuar plotësisht.

37.1- Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, të hartojnë dhe të miratojë një plan strategjik dhe vjetor për hartimin e dokumentacionit ligjor e teknik për procedurën e inventarizimit të pronave shtetërore dhe për pajisjen me certifikatë pronësie të Aseteve të transferuara me VKM, me qëllim që ky proces të realizohet me efektivitet në arritjen e objektivave të njësisë në dobi të komunitetit.
37.2- Rekomandim: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, të marrin masat për përgatitjen e praktikave dokumentare të pronave publike të transferuara për të vijuar me aplikim në DVASHK Vlorë, për të përfunduar regjistrimin e këtyre pronave në një periudhë sa më të shkurtër kohore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimet, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

Masa për shpërblim dëmi të lëna në auditimin e mëparshëm.
Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15, germat (b) dhe (c) "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*", dhe mbështetur në nenet 98-102 të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", pikën 93 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, nga ana e Titullarit të njësisë publike Bashkisë Vlorë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar

shumën monetare gjyqësisht, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **6,744,090,** si më poshtë:

1.1- Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **161,500 lekë pa TVSh,** për mos përfundim në afat të punimeve dhe vlerën **134,472 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**R.C"** ShPK.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për arkëtimin e detyrimeve ndaj shoqërisë "R.C" ShPK. Fillimisht, shoqëria është njoftuar zyrtarisht për detyrimet që rrjedhin nga kontrata, duke i kërkuar shlyerjen e vlerës 161,500 lekë pa TVSH, që përfaqëson penalitetin për mos përfundimin në afat të punimeve, si dhe vlerës 134,472 lekë pa TVSH, që përfaqëson diferencat e konstatuara në volumet e punimeve.*
Meqenëse detyrimi nuk është shlyer vullnetarisht, Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë Juridike, ka ndjekur procedurat ligjore për mbrojtjen e interesave financiare të institucionit, duke depozituar kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë për arkëtimin e shumave të sipërcituara, me shkresën nr. 13495 prot., datë 03.07.2026.
Në vijim, Bashkia Vlorë do të ndjekë të gjitha procedurat ligjore dhe të gjitha shkallët e gjykimit, deri në përfundimin e procesit gjyqësor dhe ekzekutimin e vendimit përfundimtar, me qëllim arkëtimin e plotë të detyrimeve.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

2.1- Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e **vlerës 191,120 lekë** pa TVSH, nga shoqëria **"A"** ShPK.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për arkëtimin e detyrimit ndaj shoqërisë "A" ShPK, në vlerën 191,120 lekë pa TVSH. Pas njoftimit dhe ndjekjes së procedurave administrative për shlyerjen e detyrimit, subjekti ka likuiduar vullnetarisht shumën prej 191,120 lekë pa TVSH, duke përmbushur plotësisht detyrimin financiar ndaj Bashkisë Vlorë.*
Rekomandimi është i zbatuar plotësisht.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **323,527 lekë** pa TVSh për mos përfundim në afat të punimeve dhe vlerën **610,268 lekë pa TVSh,** për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga BOE "**V.G" & "I.G**" ShPK.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për arkëtimin e detyrimeve ndaj BOE "V.G" & "I.G" ShPK, në vlerën 323,527 lekë pa TVSH, për penalitetet e vendosura për mos përfundimin në afat të punimeve, si dhe në vlerën 610,268 lekë pa TVSH, për diferencat e konstatuara në*

volumet e punimeve. Subjekti është njoftuar zyrtarisht për shlyerjen e detyrimeve, por nuk ka kryer likuidimin e tyre brenda afatit të kërkuar. Për këtë arsye, në vijim të procedurave ligjore, Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 13496 prot., datë 03.07.2026, ka paraqitur kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, me objekt arkëtimin e detyrimeve të sipërcituara. Procesi gjyqësor do të ndiqet deri në përfundimin e tij dhe, sipas rastit, në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të Bashkisë Vlorë.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **195,300 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "***A***" ShPK.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për arkëtimin e detyrimit në vlerën 195,300 lekë pa TVSH, që lidhet me diferencat e konstatuara në volumet e punimeve nga shoqëria "A" ShPK. Në kuadër të zbatimit të rekomandimit dhe për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkisë Vlorë, pasi janë ndjekur procedurat administrative për kërkimin e shlyerjes së detyrimit, Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 13494 prot., datë 03.07.2026, ka paraqitur kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, me objekt arkëtimin e shumës prej 195,300 lekë pa TVSH.*
Bashkia Vlorë do të vijojë ndjekjen e procesit gjyqësor në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, sipas rastit, në të gjitha shkallët e gjykimit, deri në arkëtimin e plotë të detyrimit.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **684,820 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga BOE "**L.C" ShPK & "V.H" ShPK**.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për arkëtimin e detyrimit në vlerën 684,820 lekë pa TVSH, që lidhet me diferencat e konstatuara në volumet e punimeve nga BOE "L.C" ShPK & "V.H" ShPK. Në kuadër të zbatimit të rekomandimit dhe për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkisë Vlorë, pas ndjekjes së procedurave administrative për kërkimin e shlyerjes së detyrimit, Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 13499 prot., datë 03.07.2026, ka paraqitur kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, me objekt arkëtimin e shumës prej 684,820 lekë pa TVSH.*
Bashkia Vlorë do të vijojë ndjekjen e procesit gjyqësor në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, sipas rastit, në të gjitha shkallët e gjykimit, deri në përfundimin e procesit dhe arkëtimin e plotë të detyrimit.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e

gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **116,200 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**C.M"** ShPK.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për arkëtimin e detyrimit në vlerën 116,200 lekë pa TVSH, që lidhet me diferencat e konstatuara në volumet e punimeve nga shoqëria "C.M" ShPK. Në kuadër të zbatimit të rekomandimit dhe për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkisë Vlorë, pas ndjekjes së procedurave administrative për kërkimin e shlyerjes së detyrimit, Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 13497 prot., datë 03.07.2026, ka paraqitur kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, me objekt arkëtimin e shumës prej 116,200 lekë pa TVSH. Bashkia Vlorë do të vijojë ndjekjen e procesit gjyqësor në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, sipas rastit, në të gjitha shkallët e gjykimit, deri në përfundimin e procesit dhe arkëtimin e plotë të detyrimit.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **327,184 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**SH"** ShPK.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet administrative për arkëtimin e detyrimit në vlerën 327,184 lekë pa TVSH, që lidhet me diferencat e konstatuara në volumet e punimeve nga shoqëria "SH" ShPK. Shoqëria është njoftuar zyrtarisht për ekzistencën e detyrimit dhe është kërkuar shlyerja e tij në përputhje me procedurat administrative në fuqi. Megjithatë, deri në momentin e hartimit të kësaj përgjigjeje, detyrimi nuk është likuiduar. Për rrjedhojë, Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë Juridike, është në proces të përgatitjes së kërkesë-padisë, duke grumbulluar dokumentacionin dhe materialet e nevojshme nga drejtoritë përkatëse për depozitimin e saj pranë gjykatës kompetente. Pas përfundimit të këtij procesi, do të ndiqen të gjitha procedurat ligjore dhe, sipas rastit, të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e plotë të detyrimit.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

8.1- Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **304,000 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**B"** ShPK.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet administrative për arkëtimin e detyrimit në vlerën 304,000 lekë pa TVSH, që lidhet me diferencat e konstatuara në volumet e punimeve nga shoqëria "B" ShPK. Shoqëria është njoftuar zyrtarisht për detyrimin dhe është kërkuar shlyerja e tij në përputhje me procedurat administrative në fuqi. Megjithatë, deri në momentin e hartimit të kësaj përgjigjeje, detyrimi nuk është likuiduar. Për rrjedhojë, Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë Juridike, është në proces të përgatitjes së kërkesë-padisë, duke grumbulluar*

dokumentacionin dhe materialet e nevojshme nga drejtoritë përkatëse për hartimin dhe depozitimin e saj pranë gjykatës kompetente. Pas depozitimit të kërkesë-padisë, do të ndiqen të gjitha procedurat ligjore dhe, sipas rastit, të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e plotë të detyrimit.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **85,695 lekë pa TVSh,** për mos përfundim në afat të punimeve nga shoqëri "**N 2**" ShPK.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimit ndaj shoqërisë "N 2" ShPK, në vlerën 85,695 lekë pa TVSH, që lidhet me penalitetin për mos përfundimin në afat të punimeve. Pas ndjekjes së procedurave administrative për kërkimin e shlyerjes së detyrimit, shoqëria ka kryer pagesën e plotë të shumës prej 85,695 lekë pa TVSH, duke përmbushur detyrimin financiar ndaj Bashkisë Vlorë. Për rrjedhojë, rekomandimi konsiderohet i zbatuar, pasi është realizuar arkëtimi i plotë i vlerës së rekomanduar dhe janë mbrojtur interesat financiare të Bashkisë Vlorë.*
Rekomandimi është i zbatuar plotësisht.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **128,000 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**SH"** ShPK.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet administrative për arkëtimin e detyrimit në vlerën 128,000 lekë pa TVSH, që lidhet me diferencat e konstatuara në volumet e punimeve nga shoqëria "SH" ShPK. Shoqëria është njoftuar zyrtarisht për detyrimin dhe është kërkuar shlyerja e vlerës së përcaktuar, në përputhje me procedurat administrative në fuqi. Megjithatë, deri në momentin e hartimit të kësaj përgjigjeje, detyrimi nuk është likuiduar nga subjekti. Për rrjedhojë, Bashkia Vlorë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, është në proces të përgatitjes së kërkesë-padisë, duke grumbulluar dokumentacionin dhe materialet e nevojshme nga drejtoritë përkatëse për hartimin dhe depozitimin e saj pranë gjykatës kompetente. Pas depozitimit të kërkesë-padisë, do të ndiqen të gjitha procedurat ligjore dhe të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e plotë të detyrimit.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **202,240 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**A"** ShPK.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për arkëtimin e detyrimit në vlerën 202,240 lekë pa TVSH, që lidhet me diferencat e konstatuara në volumet e punimeve nga shoqëria "A" ShPK. Në kuadër të zbatimit të rekomandimit dhe për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkisë Vlorë, pas ndjekjes së procedurave administrative për kërkimin e shlyerjes së detyrimit, Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 13493 prot., datë 03.07.2026, ka paraqitur kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, me objekt arkëtimin e shumës prej 202,240 lekë pa TVSH. Bashkia Vlorë do të vijojë ndjekjen e procesit gjyqësor në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, sipas rastit, në të gjitha shkallët e gjykimit, deri në përfundimin e procesit dhe arkëtimin e plotë të detyrimit.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **151,480 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**P"** ShPK.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për arkëtimin e detyrimit në vlerën 151,480 lekë pa TVSH, që lidhet me diferencat e konstatuara në volumet e punimeve nga shoqëria "P" ShPK. Në kuadër të zbatimit të rekomandimit dhe për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkisë Vlorë, pas ndjekjes së procedurave administrative për kërkimin e shlyerjes së detyrimit, Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 13498 prot., datë 03.07.2026, ka paraqitur kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, me objekt arkëtimin e shumës prej 151,480 lekë pa TVSH. Bashkia Vlorë do të vijojë ndjekjen e procesit gjyqësor në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, sipas rastit, në të gjitha shkallët e gjykimit, deri në përfundimin e procesit dhe arkëtimin e plotë të detyrimit.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

13.1- Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Punimeve të Shërbimit të Pastrimit të Njësisë Administrative Bashkia Vlorë, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **432,227 lekë**, nga shoqëria "**S"** ShPK., në rrugët që kanë qenë në rikonstruksion nga Bashkia Vlorë.
13.2- Rekomandimi: Mbikëqyrësi i punimeve, të marrë masa për mbikëqyrjen e kontratave duke evidentuar me dokumentacion ligjore për çdo ditë, volumin e punës së kryer, numrin e punëtoreve dhe mjeteve të angazhuar, ditët që subjekti nuk punon për shkak të reshjeve ose të punimeve që mund të kryhen nga Bashkia Vlorë për riparimin e rrugëve dhe trotuareve, etj.
Të evidentohen të gjitha shpenzimet mujore që kryhen shoqëria "*S*" ShPK, duke i krahasuar ato me shpenzimet sipas preventivit në hartimin e fondit limit dhe për shpenzime të pa dokumentuar dhe jo sipas preventivit fillestar të bëhen zbritje nga vlera e situacionit mujor të paraqitur nga subjekti, duke likuiduar vetëm punimet faktike dhe me dokumentacion.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Punimeve të Shërbimit të Pastrimit të Njësisë Administrative Bashkia Vlorë, ka ndërmarrë masat e nevojshme për verifikimin dhe ndjekjen e detyrimeve financiare që lidhen me shoqërinë "S" ShPK. Pas ndjekjes së procedurave administrative dhe verifikimit*

të dokumentacionit përkatës, shoqëria "S" ShPK ka likuiduar vlerën prej 432,227 lekë, duke përmbushur detyrimin financiar ndaj Bashkisë Vlorë. Gjithashtu, në kuadër të përmirësimit të procesit të mbikëqyrjes së kontratave, janë marrë masa që Mbikëqyrësi i Punimeve të evidentojë dhe dokumentojë në mënyrë të vazhdueshme realizimin faktik të shërbimeve, duke pasqyruar volumin e punës së kryer, numrin e punonjësve dhe mjeteve të angazhuara, si dhe çdo rrethanë që ndikon në realizimin e kontratës. Për likuidimin e situacioneve mujore janë kryer verifikimet përkatëse mbi punimet/shërbimet e realizuara në terren dhe dokumentacionin justifikues, duke u likuiduar vetëm zërat e punimeve dhe shërbimeve të kryera faktikisht dhe të mbështetura me dokumentacion ligjor, në përputhje me kushtet e kontratës dhe preventivin e miratuar. Për rrjedhojë, rekomandimet konsiderohen të zbatuara, pasi është realizuar arkëtimi i vlerës së rekomanduar dhe janë ndërmarrë masa për forcimin e kontrollit dhe dokumentimit të zbatimit të kontratave në vijim.
Rekomandimi është i zbatuar plotësisht.

14.1- Rekomandimi: Drejtoria e Financë/ Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Vlorë, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **466,905 lekë**, nga shoqëria "**2"** ShPK, nëpërmjet shoqërisë së sigurimit "I" ShA.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Financës/Buxhetit, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të Bashkisë Vlorë, ka ndërmarrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 466,905 lekë, nga shoqëria "2" ShPK, nëpërmjet shoqërisë së sigurimit "I"* ShA. *Pas ndjekjes së procedurave administrative për kërkimin e përmbushjes së detyrimit dhe me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të Bashkisë Vlorë, për shkak të moslikuidimit vullnetar të detyrimit, Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 13496 prot., datë 03.07.2026, ka paraqitur kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, me objekt arkëtimin e shumës prej 466,905 lekë. Bashkia Vlorë do të vijojë ndjekjen e procesit gjyqësor në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit deri në përfundimin e procesit dhe arkëtimin e plotë të vlerës së rekomanduar. Nëpërmjet këtyre masave synohet garantimi i mbrojtjes së interesave financiare të Bashkisë Vlorë.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

15.1- Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhetit dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **570,977 lekë**, nga shoqëria "***P*"** ShPK, për mos mbyllje në afat të punimeve të kontratës nr. 12273/12 prot, datë 5.11.2024, me objekt: "*Rehabilitim i kanalit Kallafet dhe Babicë, Vlorë"*, viti 2024.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të Bashkisë Vlorë, ka ndërmarrë masat e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerës 570,977 lekë, nga shoqëria JV "C" ShPK, e cila lidhet me penalitetin për mos mbylljen në afat të punimeve të kontratës nr. 12273/12 prot., datë 05.11.2024, me objekt "Rehabilitim i kanalit Kallafet dhe Babicë, Vlorë", viti 2024. Shoqëria është njoftuar zyrtarisht për detyrimin dhe është kërkuar shlyerja e vlerës së përcaktuar në përputhje me procedurat administrative në fuqi. Megjithatë, deri në momentin e hartimit të kësaj përgjigjeje, subjekti nuk ka kryer likuidimin e detyrimit. Për rrjedhojë, Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë Juridike, është në proces të përgatitjes së kërkesë-padisë, duke grumbulluar dokumentacionin dhe materialet e nevojshme nga drejtoritë përkatëse për hartimin dhe depozitimin e saj pranë gjykatës kompetente. Pas depozitimit të*

kërkesë-padisë, do të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e plotë të detyrimit.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

16.1- Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhetit dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **916,575 lekë pa TVSH** nga shoqëria sipërmarrëse "*A.C*" ShPK, si penalitet për punime të pakryera, parashikuar në afatet e kontratën nr. 7950 *prot*, datë 3.7.2023, me objekt "*Rehabilitimi i stacioneve të autobusëve dhe i stacionit të taksive elektrike të Segmentit nga Shkolla e Marinës deri te Regina City*".

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të Bashkisë Vlorë, ka ndërmarrë masat e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerës 916,575 lekë pa TVSH nga shoqëria sipërmarrëse "A.C" ShPK, si penalitet për punime të pakryera, në zbatim të përcaktimeve të kontratës nr. 7950 prot., datë 03.07.2023, me objekt "Rehabilitimi i stacioneve të autobusëve dhe i stacionit të taksive elektrike të Segmentit nga Shkolla e Marinës deri te Regina City". Shoqëria është njoftuar zyrtarisht për detyrimin financiar dhe është kërkuar shlyerja e vlerës së përcaktuar në përputhje me procedurat administrative në fuqi. Megjithatë, deri në momentin e hartimit të kësaj përgjigjeje, subjekti nuk ka kryer likuidimin e detyrimit. Për rrjedhojë, Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë Juridike, është në proces të përgatitjes së kërkesë-padisë, duke grumbulluar dokumentacionin dhe materialet teknike e administrative nga drejtoritë përkatëse, me qëllim hartimin dhe depozitimin e saj pranë gjykatës kompetente për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimit.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

16.2- Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë, të marrë masa që të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë arsyet dhe shkaqet e mosmarrëveshjeve ose konfliktit mes palëve mbi dështimin e realizimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Rehabilitimi i stacioneve të autobusëve dhe i stacionit të taksive elektrike të Segmentit nga Shkolla e Marinës deri te Regina City*", të lidhur ndërmjet AK- Bashkia Vlorë dhe shoqërisë sipërmarrëse "*A.C*" ShPK me nr. 7950 *prot*, datë 3.7.2023. Në rast të kundërt, Bashkia Vlorë t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, në kushtet ku kjo kontratë ka dështuar.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të Bashkisë Vlorë në zbatim të rekomandimit për analizimin e shkaqeve të mosmarrëveshjeve dhe mosrealizimit të kontratës, po vijon procesi i shqyrtimit të dokumentacionit kontraktor, teknik dhe administrativ nga strukturat përgjegjëse, në bashkëpunim me specialistët e fushës dhe mbikëqyrësin e punimeve, me qëllim evidentimin e rrethanave që kanë sjellë mosrealizimin e kontratës dhe përcaktimin e masave të mëtejshme ligjore. Pas përfundimit të procedurave përgatitore dhe depozitimit të kërkesë-padisë, Bashkia Vlorë do të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

17.1- Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Vlorë dhe Drejtorinë e Financave, të marrin të gjitha masat për të njoftuar subjektin mbi detyrimin që ka në lidhje me vlerën **741,600 lekë** të papaguar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, si dhe arkëtimin e kësaj vlere.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Urbanistikës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financës të Bashkisë Vlorë, ka ndërmarrë masat e nevojshme administrative për njoftimin e subjektit mbi detyrimin financiar në vlerën 741,600 lekë, që përfaqëson taksën e ndikimit në infrastrukturë të papaguar. Subjekti është njoftuar zyrtarisht për detyrimin dhe është kërkuar shlyerja e vlerës përkatëse në përputhje me procedurat administrative në fuqi. Megjithatë, deri në momentin e hartimit të kësaj përgjigjeje, subjekti nuk ka kryer likuidimin e detyrimit. Për rrjedhojë, Bashkia Vlorë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, është në proces të përgatitjes së kërkesë-padisë, duke grumbulluar dokumentacionin dhe materialet e nevojshme nga drejtoritë përkatëse për hartimin dhe depozitimin e saj pranë gjykatës kompetente, me qëllim arkëtimin e vlerës së detyrimit. Pas depozitimit të kërkesë-padisë, do të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, deri në arkëtimin e plotë të vlerës së detyrimit dhe zbatimin e plotë të rekomandimit.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

<u>Masa për elimimin e efekteve negative të konstatuara në adnministrimin dhe menaxhimin e të ardhurave të munguara të lëna në auditimin e mëparshëm.</u>

<u>1.1- Rekomandimi</u>: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Vlorë, si Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Drejtorinë Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Projekteve dhe administratorët e njësive administrative të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve debitorë nga taksa/tarifa vendore në subjektet fizik/juridik/institucioni/abonentë familjarë në vlerën **708,616,396 lekë** për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit të keq që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Vlorë, Sektori i Borxhit pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore janë ndjekur procedurat ligjore të parashikuara për evidentimin, administrimin dhe kërkimin e arkëtimit të detyrimeve të prapambetura nga subjektet fizikë, juridikë dhe abonentët familjarë.*
Në vijim, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore do të vijojë bashkëpunimin me strukturat përkatëse të Bashkisë Vlorë, me qëllim intensifikimin e veprimeve administrative dhe ligjore për mbledhjen e detyrimeve vendore, reduktimin e nivelit të borxhit të krijuar dhe rritjen e performancës në administrimin e të ardhurave vendore. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit nr. 739/1, datë 01.07.2026. Rekomandimet e përsëritura do të unifikohen në një të vetme dhe do të rikërkohen për zbatim në vijim të këtij auditimi.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

<u>2.1- Rekomandimi</u>: Sektori i Borxhit Tatimor pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, të marrë masa për kryerjen e vlerësimit tatimor për taksën e ndërtesës dhe ndjekjen e të gjitha shkallëve ligjore për arkëtimin e vlerës totale prej **1,005,223 lekë** për **53** subjektet e audituara, si dhe për 472 subjektet e tjera që nuk janë tarifuar gjatë vitit 2025.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga DAV Bashkia Vlorë është bërë rivlerësimi për subjektet e mësipërme.*
Rekomandimi është i zbatuar plotësisht.

3.1- Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, të marrë masa për kryerjen e vlerësimeve tatimore dhe ndjekjen e të gjitha shkallëve ligjore për arkëtimin e vlerës prej **6,000,000 lekë** nga **7** subjektet debitorë që ushtrojnë veprimtari në fushën e hidrokarbureve dhe konkretisht për subjektet "B, "A", "E", "A.B", "D.T", "J" dhe J.P.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Shkresa e DIIP me Nr.6870 prot., datë 09.04.2026 me objekt "Kërkesë për bashkëpunim" drejtuar Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, ku kërkohet lista e subjekteve të cilat tregtojnë naftë dhe nënprodukte të saj me qëllim njoftimin e subjekteve për të shlyer detyrimet dhe pajisjen me licencën përkatëse.*
Shkresa e Drejtorisë së Taksave dhe tarifave vendor me Nr.6870/1 prot., datë 09.04.2026 me objekt "Dhënie informacion lidhur me kërkesën Nr.6870 prot., datë 09.04.2026." drejtuar DIIP në të cilën është lista e subjekteve që ushtrojnë aktivitet.
Njoftimet drejtuar subjekteve debitor për të kryer pagesën.
1. Shkresa e DIIP me Nr.7013 prot., datë 10.04.2026 me objekt "Urdhër ekzekutimi për shpërblim dëmi" drejtuar B dhe urdhërpagesa përkatëse Nr.107 datë 10.04.2026.
2. Shkresa e DIIP me Nr.7011 prot., datë 10.04.2026 me objekt "Urdhër ekzekutimi për shpërblim dëmi" drejtuar J dhe urdhërpagesa përkatëse Nr.109 datë 10.04.2026.
3. Shkresa e DIIP me Nr.7012 prot., datë 10.04.2026 me objekt "Urdhër ekzekutimi për shpërblim dëmi" drejtuar D.T dhe urdhërpagesa përkatëse Nr.108 datë 10.04.2026.
Njoftimet drejtuar subjekteve debitor për të dorëzuar dokumentat për licencim
1. Shkresa e DIIP me Nr.9256 prot., datë 12.05.2026 me objekt "Njoftim për t'u pajisur me licencë tregtimi karburanti" drejtuar subjektit J.
2. Shkresa e DIIP me Nr.9259 prot., datë 12.05.2026 me objekt "Njoftim për t'u pajisur me licencë tregtimi karburanti" drejtuar subjektit D.T.
3. Shkresa e DIIP me Nr.8268 prot., datë 12.05.2026 me objekt "Njoftim për t'u pajisur me licencë tregtimi karburanti" drejtuar subjektit B.
Në vitin 2026 rezultojnë debitor 3 subjekte "D.T", "J" dhe "B". Meqenëse detyrimi nuk është shlyer vullnetarisht, Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë Juridike, ka ndjekur procedurat ligjore për mbrojtjen e interesave financiare të institucionit, duke depozituar kërkesë-padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë për arkëtimin e shumave të sipërcituara nga subjektet "D.T", "J" dhe "B", me shkresat nr. 13492/2026; nr.13490/2026 dhe nr.13491/2026. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit nr. 739/1, datë 01.07.2026. Rekomandimet e përsëritura do të unifikohen në një të vetme dhe do të rikërkohen për zbatim në vijim të këtij auditimi.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **562,962 lekë** nga **8** subjektet dhe vlerës **854,632 lekë** nga **6** subjekte për taksën e ndërtesës.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vlorë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

4.2. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për ngritjen e strukturave të nevojshme në mënyrë që të identifikojë çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e bashkisë, si dhe të planifikojë detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" apo "truall" sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë, për ngritjen e strukturave dhe marrjen e masave për identifikimin e individëve, personave fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Bashkisë Vlorë, informojmë se ka vijuar koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet strukturave përgjegjëse për evidentimin dhe përditësimin e të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme. Në kuadër të këtij procesi, po ndërmerren veprimet e nevojshme për identifikimin e subjekteve tatimpaguese dhe për përditësimin e bazës së të dhënave, me qëllim planifikimin dhe vendosjen e detyrimit për pagesën e taksës mbi pasurinë e paluajtshme ("ndërtesë" dhe/ose "truall"), në përputhje me legjislacionin në fuqi, si për pronarët apo bashkëpronarët, ashtu edhe për përdoruesit e pasurive të paluajtshme që nuk disponojnë dokumentacion pronësie.*
Ky proces do të vijojë në bashkëpunim me të gjitha strukturat përgjegjëse dhe institucionet kompetente, me synim plotësimin e regjistrit të tatimpaguesve, rritjen e nivelit të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme dhe përmirësimin e performancës në mbledhjen e të ardhurave vendore.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

5.1- Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **94,084,169 lekë** ndaj **2222** subjekteve.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit janë duke ndërmarrë masat e nevojshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për ndjekjen e procedurave administrative dhe ligjore me qëllim arkëtimin e detyrimeve të identifikuara, në bashkëpunim me strukturat e tjera përkatëse të Bashkisë Vlorë.*
Zbatimi i këtij rekomandimi do të vijojë deri në përfundimin e procedurave të nevojshme dhe arkëtimin e detyrimeve, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit nr. 739/1, datë 01.07.2026. Rekomandimet e përsëritura do të unifikohen në një të vetme dhe do të rikërkohen për zbatim në vijim të këtij auditimi.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

6.1- Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore në vlerën **300,853,086 lekë** për **22,818** familjet e trajtuara me tokë bujqësore.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, vijon të kryejë përllogaritjen dhe lëshimin e faturave të taksës së tokës bujqësore për përfituesit në territorin e Bashkisë Vlorë, proces i cili zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme që prej vitit 2022. Llogaritja dhe faturimi i taksës kryhen në përputhje me aktet e miratuara*

nga Këshilli Bashkiak, konkretisht VKB nr. 79, datë 02.12.2021, i ndryshuar me VKB nr. 95, datë 23.12.2022. Aktualisht, faturat lëshohen për çdo subjekt që paraqitet pranë drejtorisë për të përfituar shërbime lidhur me dokumentacionin e tokës bujqësore të përfituar nga ristrukturimi i ish-ndërmarrjeve bujqësore. Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në bashkëpunim me Drejtorinë e të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe strukturat e tjera përgjegjëse, do të vijojë marrjen e masave administrative dhe ligjore për identifikimin e debitorëve dhe ndjekjen e procedurave për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga taksa e tokës bujqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit nr. 739/1, datë 01.07.2026. Rekomandimet e përsëritura do të unifikohen në një të vetme dhe do të rikërkohen për zbatim në vijim të këtij auditimi.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

7.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike Bashkia Vlorë, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për rishikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me UK ShA Vlorë, për një menaxhim më të mirë të taksave e tarifave nga abonentët familjarë, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore e administrative arkëtimin e vlerës së detyrimit të arkëtuar nga UK sha Vlorë por të pa likuiduara në llogarinë e Bashkisë për vlerën **191,756,541 lekë**. Të saktësojë dhe kontabilizojë diferencën prej 839,688 lekë nga debitorët familjar.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë është duke ndjekur në mënyrë të vazhdueshme problematikën në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse. Aktualisht po zhvillohen komunikime dhe përpjekje institucionale me UK Sh.A. Vlorë, me synim arritjen e një zgjidhjeje me mirëkuptim dhe rregullimin e marrëdhënieve financiare ndërmjet palëve, si dhe krijimin e një mekanizmi më efektiv për administrimin dhe transferimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat e abonentëve familjarë. Nëse këto përpjekje nuk do të çojnë në një zgjidhje të problematikës me pajtim, Bashkia Vlorë do të ndjekë të gjitha procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, përfshirë edhe ndjekjen e rrugës gjyqësore, me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të institucionit dhe arkëtimin e detyrimeve përkatëse.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

7.2- Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Rajoneve dhe të Njësive Administrative, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore, si edhe të hartohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave. Me qëllim evidentimin dhe përllogaritjen sa më të saktë të taksave dhe tarifave që planifikohen të arkëtohen, Njësitë Administrative të marrin parasysh edhe të dhënat e Census-it të fundit të realizuar.

Menjëherë dhe vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë ka përfunduar si procedurë në bashkëpunim me DAV me shkresën e datës 19.03.2024 të specialistes së kontabilitetit tatimor.*
Rekomandimi është i zbatuar plotësisht.

8.1- Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me IMTV dhe Drejtorinë e të Ardhurave Bashkia Vlorë, të marrin masa për evidentimin dhe nxjerrjen e njoftim vlerësimeve në shumën **3,053,350 lekë, të 24 subjekteve** debitorë për tarifën e mbetjeve urbane, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative për arkëtimin e detyrimeve**.**

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vlorë, për realizimin e këtij procesi është parashikuar në kontratën e lidhur me I.S nr. 11840/12 prot., datë 08.11.2024, ofrimi i mbështetjes për evidentimin dhe administrimin e të dhënave për subjektet debitore. Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore do të vijojë të jetë në vëmendje me qëllim koordinimin e veprimeve të nevojshme për zbatimin e rekomandimit, evidentimin e detyrimeve dhe ndjekjen e procedurave administrative për arkëtimin e tyre.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

9.1- Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Vlorë, të marrë të gjitha masat për të njoftuar zhvilluesit të cilët kanë përfituar lejet e ndërtimit: **i.** "L.B" ShPK për aplikimin me nr. *AN170220230016* (128.7 m^2 ose 7,955,514 lekë); **ii.** "F" ShPK për aplikimin me nr. *AN100420230044* (77 m^2 ose 4,758,600 lekë); **iii.** "L" ShPK për aplikimin me nr. *AN290520230014* (251 m^2 ose 15,501,294 lekë); **iv.** "M" ShPK për aplikimin me nr. *AN040620230002* (222.18 m^2 ose 13,330,800 lekë); për të hartuar aktmarrëveshjet me ta, për kalimin pa shpërblim të sipërfaqeve takuese në favor të fondit publik për strehim social, në natyrë ose vlerë monetare (**41,546,208 lekë në total**). Nga Bashkia Vlorë të ndiqen të gjitha hapat deri në refuzimin e aplikimeve për pajisje me certifikatë përdorimi, nëse zhvilluesit nuk dakortësohen për hartimin e aktmarrëveshjeve.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Drejtoria e Urbanistikës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për njoftimin e subjekteve zhvilluese. Konkretisht, janë dërguar njoftimet përkatëse si më poshtë: Shkresa nr. 3728 prot., datë 23.02.2026, drejtuar shoqërisë "M" ShPK.; Shkresa nr. 3727 prot., datë 23.02.2026, drejtuar shoqërisë "F" ShPK.; Shkresa nr. 3726 prot., datë 23.02.2026, drejtuar shoqërisë "L.B" ShPK.; Shkresa nr. 3725 prot., datë 23.02.2026, drejtuar shoqërisë "L" ShPK. Në vijim të procedurave të ndjekura, Bashkia Vlorë ka lidhur aktmarrëveshjet përkatëse me: shoqërinë "L.B" ShPK., me aktmarrëveshjen nr. 1604 Rep., nr. 1169/1 Kol., datë 18.11.2025; shoqërinë "M" ShPK., me aktmarrëveshjen nr. 1604 Rep., nr. 1169/1 Kol., datë 03.06.2026. Për shoqëritë "L" ShPK. dhe "F" ShPK., megjithëse është kryer njoftimi në përputhje me rekomandimin e KLSH-së, aktmarrëveshjet nuk janë lidhur ende, këto shoqëri nuk janë paraqitur për të lidhur akt marrëveshjet por edhe procedurat e kolaudimit të objekteve përkatëse nuk kanë përfunduar. Pas përfundimit të këtyre procedurave, Bashkia Vlorë do të vijojë ndjekjen e të gjitha hapave administrativë dhe ligjorë të parashikuar në legjislacionin në fuqi, përfshirë lidhjen e aktmarrëveshjeve ose, në rast të mosplotësimit të detyrimeve nga zhvilluesit, marrjen e masave të parashikuara për pajisjen me certifikatë përdorimi.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

10.1- Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Vlorë, të marrë masa për të arkëtuar diferencat e detyrimit në përputhje me shkeljen e konstatuar në subjektet A.V për vlerën **4,939,060** lekë; S.N (F.K) për vlerën **900,320** lekë; P.B për vlerën **49,520** lekë; F.M për vlerën **300,000** lekë. Ndërsa për subjektin SH.M, të kryhet llogaritja dhe arkëtimi i sanksionit përkatës, në përputhje me konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi (punime mure tulle perimetral me përmasa 6.6 ml + 6 ml +3.8 ml x 3 ml x 0.25 ml.).

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Për subjektin A.V pas verifikimit në terren rezultoi se janë kryer punime duke mbyllur totalisht objektin, rrjedhimisht, nga ana e IMT Bashkia Vlorë është mbajtur procedura ligjore shoqëruar me vendimin e dënimit me gjobë me vlerën 4,939,060 lekë.*
Referuar P.V nr.03 datë 02.11.2023 me kundërvajtës F.K, vendimi i dënimit me gjobë nr.652 datë 06.11.2023 për kundërvajtjen "mur guri i lidhur me llac" është ndryshuar emri i kundërvajtësit për shkak të deklaratës noteriale S.N duke u rivlerësuar vendimi i gjobës me Nr.660 datë 18.12.2023. Ky vendim gjobe është përllogaritur në mbështetje të ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit neni 52 pika pika 2 Vlera e punimeve të kryera pa leje, sipas pikës 1, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij neni, llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit, të përcaktuar me udhëzim të Këshillit të Ministrave. Duke qenë se objekti mur guri kryen funksioni e një muri mbajtës dhe jo të një objekti (shumë i dukshëm edhe në fotot bashkëlidhur) nuk mund të konsiderohet si objekt (në strukturë të plotë mure konstruksion dhe mbulesë), përllogaritet me vlerën e preventivit të punimeve, mbështetur në VKM Nr.216 datë 13 .04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve"
An.2.54/1 "Mur guri në lartësi deri 3ml"
Sasia 44 m^3
Çmimi 9,032 lekë/m^3
Vlera 397408 lekë
Referuar subjektit F.M është mbajtur vendimit i dënimit me gjobë Nr. 602 datë 04.07.2023 me vlerë 300,000 lekë me kundërvajtës F.M për konstatimin e kundërvajtjes "vazhdim i punimeve në objekt të proceduar më parë duke ndërtuar mbyllje të strukturës në anën lindore me kartonxhes" është ndjekur e gjithë procedura ligjore për këtë kundërvajtje.
IMT i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje me kërkesën për lëshimin e "Urdhrit të Ekzekutimit" për vjeljen e gjobës me shkresën Nr 8379 datë 10.07.2023.
Referuar P.V nr.11 datë 31.10.2023 me kundërvajtës SH.M, vendimi i dënimit me gjobë Nr.651 datë 02.11.2023 për kundërvajtjen "mur tulle perimetral me përmasa (6.6ml+6ml+3.8ml) x 3ml" është përllogaritur në mbështetje të ligjit nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit neni 52 pika pika 2 Vlera e punimeve të kryera pa leje, sipas pikës 1, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij neni, llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit, të përcaktuar me udhëzim të Këshillit të Ministrave. Duke qenë se objekti i konstatuar si kundërvajtje ishin punime mure-tulle perimetral (pjesërisht) mbi një objekt Konstruksion B/A i ndërtuar prej shumë vitesh për të cilin subjekti ka aplikuar për legalizimin e tij, nuk mund të përllogaritet si objekt (në strukturë të plotë mure konstruksion dhe mbulesë) përllogaritjet janë kryer për muret e tullës me vlerën e preventivit të punimeve, mbështetur në VKM Nr. 216 datë 13 .04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve".
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

11.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë të ngrejë një grup pune me përfaqësues nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Struktura Përgjegjëse për Menaxhimin e Stacioneve të Plazhit dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, duke hartuar një plan pune me afate të përcaktuara. Grupi i punës të analizojë dosjet e subjekteve që kanë administruar hapësira publike të stacioneve të plazhit, me fokus verifikimin e plotësimit të dokumentacionit ligjor dhe përcaktimin e përgjegjësive për parregullsitë e konstatuara. Gjithashtu, të merren masat e nevojshme dhe të ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **8,098,500 lekë**, që kanë rezultuar si faturim më pak në raport me sipërfaqen e miratuar nga AKB për 17 parcela me sipërfaqe totale 19,947 m².

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë ka kryer analizën e përgjegjësive administrative për parregullsitë e konstatuara gjatë administrimit të hapësirave publike të stacioneve të plazhit. Si rezultat i kësaj analize, janë marrë masa disiplinore ndaj dy punonjësve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore informon se janë realizuar procedurat për ndjekjen e subjekteve debitorë që kanë administruar stacionet e plazhit, duke vijuar procedurat administrative për arkëtimin e detyrimeve të evidentuara. Bashkia Vlorë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, do të vijojë bashkëpunimin ndërmjet Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Strukturës Përgjegjëse për Menaxhimin e Stacioneve të Plazhit, Drejtorisë së të Ardhurave Vendore dhe Drejtorisë Juridike, me qëllim përfundimin e verifikimit të dokumentacionit, evidentimin e përgjegjësive dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative e ligjore për arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.*
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

12.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Policinë Bashkiake, të marrin masa duke hartuar plan pune me afate konkrete. Për të analizuar dosjet e subjekteve që kanë administruar hapësira publike në lidhje me plotësimin e dokumentacionit ligjor dhe nxjerrjen e përgjegjësive për parregullsitë e konstatuara si dhe marrjen e masave duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e detyrimeve në vlerë **11,424,290 lekë nga 187 subjekte**.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë ka kryer analizën e përgjegjësive administrative për parregullsitë e konstatuara gjatë administrimit të hapësirave publike. Si rezultat i kësaj analize, janë marrë masa disiplinore ndaj dy punonjësve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet që rregullojnë marrëdhëniet e punës në administratën vendore. Nga ana tjetër, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore informon se vijon ndjekjen e subjekteve të regjistruara në sistemin TAIS, të evidentuara dhe të referuara nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit (DFBK). Në kuadër të procedurave të mbledhjes së detyrimeve janë kryer njoftimet paraprake ndaj subjekteve debitorë, si dhe janë ndërmarrë masat administrative përkatëse, përfshirë vendosjen e bllokimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
Strukturat përgjegjëse do të vijojnë bashkëpunimin për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore me qëllim arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga subjektet përfituese të hapësirave publike.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

13.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të ngrejë një grup pune me përbërje nga Drejtoria e Pronave Publike dhe e Menaxhimit të Aseteve, Strukturën Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të Plazhit, Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, duke hartuar një plan pune me afate të përcaktuara. Ky grup pune të analizojë dosjet e subjekteve që kanë administruar hapësira publike të stacioneve të plazhit, me qëllim verifikimin e plotësimit të dokumentacionit ligjor, përcaktimin e përgjegjësive për parregullsitë e konstatuara dhe marrjen e masave përkatëse, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **8,008,476 lekë ndaj 57 subjekteve**.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Bashkia Vlorë ka ndërmarrë veprimet për verifikimin dhe analizimin e situatës së krijuar lidhur me administrimin e hapësirave publike të stacioneve të plazhit dhe detyrimet e evidentuara ndaj subjekteve përkatëse. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Vlorë, është vijuar me evidentimin e rasteve problematike, verifikimin e përgjegjësive për parregullsitë e*

konstatuara dhe ndjekjen e procedurave përkatëse administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara në vlerën 8,008,476 lekë ndaj 57 subjekteve. Në kuadër të masave të marra për përmirësimin e proceseve të administrimit dhe kontrollit të hapësirave publike të stacioneve të plazhit, janë analizuar përgjegjësitë e punonjësve të përfshirë në proces dhe, si rezultat i konstatimeve të bëra, ndaj dy punonjësve të Bashkisë Vlorë janë marrë masa disiplinore, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Bashkia Vlorë vijon ndjekjen e procedurave për arkëtimin e detyrimeve të evidentuara dhe marrjen e masave të nevojshme administrative, me qëllim përmbushjen e rekomandimit të KLSH-së dhe garantimin e menaxhimit sa më efektiv të aseteve dhe hapësirave publike.
Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

Masa për elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike të lëna në auditimin e mëparshëm.

1.1- Rekomandimi: Titullari i AK *(Bashkia Vlorë dhe NSHP-Bashkia Vlorë),* të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST dhe s'kualifikimin e atyre që i plotësojnë ato, me pasojë përdorimin pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën **11,173,298 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

2.1- Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Vlorë *(aparati),* të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST dhe s'kualifikimin atyre që i plotësojnë ato, me pasojë përdorimin pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën **1,100,000 lekë**.
2.2- Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (*komisioni i vlerësimit të ofertave*), gjatë vlerësimit të procedurave të prokurimit, të verifikojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga OE dhe të raportojë në APP deklarime e falsifikuara për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

3.1- Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialist të fushës për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit në vlerën **4,957,766 lekë** pa TVSh**,** si rezultat i hartimit të gabuar të fondit limit të shërbimit të pastrimit në Njësinë Administrative Orikum.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

4.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit të Autoritetit Kontraktor në vlerën **538,650 lekë pa TVSh** mbi pagesat e kryera për punime të mbivendosura në objektin e mësipërm.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

5.1- Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë në buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën **7,908,566 lekë pa TVSh** mbi pagesat e kryera për punime të mbivendosura në objektin e mësipërm.

Brenda datës 30.06.2026

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i grupit të auditimit: *Lidhur me rekomandimin, në bazë të Programit të Auditimit Financiar Nr.739/1 Prot., datë 01.07.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të verifikohet zbatimi i tij në auditimin e rradhës.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

Masa disiplinore të lëna në auditimin e mëparshëm.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; shkronjat (b, c, ç) dhe nenit 58 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"; nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë", kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vlorë** të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2024, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si vijon:

F.1. Nga "*Vërejtje*" deri në "*Largim nga shërbimi civil/Largim nga puna*", për 21 (njëzet e një) punonjësit, si më poshtë:

1. Zj. M.C, me detyrë Specialiste, Njësia e Prokurimit, në **8** procedura prokurimi: *("Azhornim projekti i kanaleve vaditës-Bordi Kullimit-Vlorë (Mirëmbajtje kanali ujitës Tragjas-Radhimë), viti 2024"; "Rehabilitim i kanalit Kallafet dhe Babicë, Vlorë", viti 2024", "Mirëmbajtje diga të rezervuarit Bestrov, Panaja, Bunavija, viti 2024", "Barriera metalike mbrojtëse për këmbësorët përgjatë rrugës Trans ballkanike dhe rruga Ali Demi", viti 2024", "Rikon i*

kopshteve dhe shkollave (Hasan Pulo, Orikum, kopshti nr. 14, shkolla Jani Minga, tualetet e shkollës Ismail Qemali, 15 Tetori dhe kopshti nr. 5", viti 2024", "Rikonstruksion i kopshtit nr. 10, viti 2024", "Rikonstruksion i rrugës ish- Fabrika e Çimentos (segmenti I-rë)", viti 2024", "Rikualifikim i disa hapësirave të gjelbra të qytetit, viti 2024").

2. Zj. XH.K, me detyrë Përgjegjëse, Sektori i Buxhetit, Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit, në **2** procedura prokurimi; *("Rikonstruksion i palestrës së qytetit, multisportive të ekipit të Flamurtarit", viti 2023", "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare "Avni Rustemi", viti 2023").*

3. Zj. F.R, me detyrë Përgjegjëse, Sektori i Taksës së Pasurisë, në **2** procedura prokurimi: *("Sistemim i territorit të NSHP Bashkia Vlorë, viti 2023", "Mirëmbajtje Hidrovori", viti 2023").*

4. Z. E.H, me detyrë Përgjegjës, Sektori Teknik, NSHP, në **10** procedura prokurimi *("Blerje fadrome me kovë mbi 3 ton", viti 2023", "Blerje karburanti për nevojat e Sektorit të Pastrimit, viti 2024", "Blerje karburanti për nevojat e NSHP, viti 2024", "Blerje karburanti, Bordi Kullimit, viti 2024", "Blerje karburanti, Sektori i Gjelbërimit, viti 2024", "Blerje autobot ujë për Sektorin e Pastrimit, viti 2024", "Blerje kontejneri 1.1 m3, Sektorin e Shërbimeve, viti 2024", "Blerje skrep me kovë të parë 1.2 m³ dhe kovë të pasme 0.5m³", viti 2023", "Blerje rimorkiator për ekskavator, viti 2024", "Blerje kamion vinç 7 ton vetëshkarkues, viti 2024", "Blerje kokë tërheqje për rimorkiatorin, viti 2024").*

5. Zj. E.D, me detyrë Inxhiniere mjedisi, Ndërmarrja e Pastrimit, në **4** procedura prokurimi *("Blerje kontejneri 1.1 m3, Sektorin e Shërbimeve, viti 2024", "Blerje karburanti, Bordi Kullimit, viti 2024", "Blerje karburanti për nevojat e NSHP, viti 2024', "Blerje karburanti për nevojat e Sektorit të Pastrimit, viti 2024").*

Për shkeljet e mëposhtme*:*

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) dhe të specifikimeve teknike (ST), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të paargumentuara dhe jo të lidhura me tipologjinë e procedurës, veprime të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE ose janë bërë shkak për skualifikim të OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës *(siç pasqyrohet në faqen 90-186 të RPA),* në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

6. Z. D.Z, me detyrë Sekretar i Këshillit Bashkiak, në **2** procedura prokurimi: *(Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme në njësinë Administrative Orikum për vitin 2023", "Rehabilitimi i stacioneve te autobusëve dhe I stacionit te taksive elektrike Segmentit nga Shkolla e Marines deri te Regina City, viti 2023");*

7. Zj. S.ZH, me detyrë Specialiste, Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit, në **5** procedura prokurimi *("Azhornim projekti i kanaleve vaditës-Bordi Kullimit-Vlorë (Mirëmbajtje kanali ujitës Tragjas-Radhimë), viti 2024"; "Rehabilitim i kanalit Kallafet dhe Babicë, Vlorë", viti 2024", "Mirëmbajtje diga të rezervuarit Bestrov, Panaja, Bunavija, viti 2024", "Rikonstruksion i kopshtit nr. 10, viti 2024", "Rikualifikim i disa hapësirave të gjelbra të qytetit, viti 2024");*

8. Zj. E.N, me detyrë Specialiste inxhiniere ndërtimi, Drejtoria e Urbanistikës, në **1 (një)** procedurë prokurimi *("Rikonstruksion i rrugës ish- Fabrika e Çimentos (segmenti I-rë)", viti 2024");*

9. Z. E.B, me detyrë Përgjegjës, Sektori i Shërbimeve, NSHP, NSHP, në **2** procedura prokurimi: *("Punime te vendgrumbullimi i mbetjeve, dëmtime nga zjarri, viti 2023", "Sistemim i territorit të NSHP Bashkia Vlorë, viti 2023");*

10. Zj. E.S me detyrë Përgjegjëse finance, Ndërmarrja e Pastrimit, në **6** procedura prokurimi: *("Blerje karburanti, Sektori i Gjelbërimit, viti 2024", "Blerje karburanti për nevojat e NSHP,*

viti 2024", "Blerje karburanti për nevojat e Sektorit të Pastrimit, viti 2024", "Punime te vendgrumbullimi i mbetjeve, dëmtime nga zjarri, viti 2023", "Blerje karburanti, Bordi Kullimit, viti 2024", "Blerje kontejneri 1.1 m3, Sektorin e Shërbimeve, viti 2024");

11. Zj. M.Z me detyrë Ekonomiste, Ndërmarrja e Gjelbërimit, në **5** procedura prokurimi: *(" Blerje kontejneri 1.1 m3, Sektorin e Shërbimeve, viti 2024", "Blerje karburanti, Sektori i Gjelbërimit, viti 2024", "Blerje karburanti, Bordi Kullimit, viti 2024", "Blerje karburanti për nevojat e NSHP, viti 2024", "Blerje karburanti për nevojat e Sektorit të Pastrimit, viti 2024").*

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë "*Çmimi më i leverdishëm*", si dhe vlerësimin jo të saktë të OE të skualifikuar ose me mangësi të njëjta me OE e shpallur fitues, duke çuar në përdorimin pa efektivitet të fondeve për vlerën 12,273,298 lekë, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, *"Parimet e përzgjedhjeje*", neni 98, "*Anulimi i një procedure*", neni 76 "*Kriteret detyruese për skualifikim*", neni 92, "*Shqyrtimi i ofertave*", si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", neni 67, "*Klasifikimi i ofertave*".

12. Z. A.S, me detyrë Përgjegjës", Bordi i Kullimit, në **6** procedura prokurimi: *("Blerje rimorkiator për ekskavator, viti 2024", "Blerje kamion vinç 7 ton vetëshkarkues, viti 2024", "Blerje Asfalto beton viti", viti 2024", "Azhornim projekti i kanaleve vaditës-Bordi Kullimit-Vlorë (Mirëmbajtje kanali ujitës Tragjas-Radhimë), viti 2024"; "Rehabilitim i kanalit Kallafet dhe Babicë, Vlorë", viti 2024", "Mirëmbajtje diga të rezervuarit Bestrov, Panaja, Bunavija, viti 2024", "Blerje skrep me kovë të parë 1.2 m³ dhe kovë të pasme 0.5m³", viti 2023").*

13. Z. A.L, me detyrë Specialist i operimit te impiantit, ndërmarrja MIM, në **10** procedura prokurimi. Azhornim projekti i kanaleve vaditës-Bordi Kullimit-Vlorë *("Blerje karburanti për nevojat e Sektorit të Pastrimit, viti 2024", "Blerje karburanti për nevojat e NSHP, viti 2024", "Blerje karburanti, Bordi Kullimit, viti 2024", "Blerje karburanti, Sektori i Gjelbërimit, viti 2024", "Blerje autobot ujë për Sektorin e Pastrimit, viti 2024", "Blerje kontejneri 1.1 m3, Sektorin e Shërbimeve, viti 2024", "Blerje rimorkiator për ekskavator, viti 2024", "Blerje kamion vinç 7 ton vetëshkarkues, viti 2024", "Blerje kokë tërheqje për rimorkiatorin, viti 2024", "Blerje skrep me kovë të parë 1.2 m³ dhe kovë të pasme 0.5m³", viti 2023", "Sistemim i territorit të NSHP Bashkia Vlorë, viti 2023").*

14. Zj. L.A, me detyrë Specialiste, Njësia e Prokurimit, në **7** procedura prokurimi: *(Azhornim projekti i kanaleve vaditës-Bordi Kullimit-Vlorë (Mirëmbajtje kanali ujitës Tragjas-Radhimë), viti 2024"; "Rehabilitim i kanalit Kallafet dhe Babicë, Vlorë", viti 2024", "Mirëmbajtje diga të rezervuarit Bestrov, Panaja, Bunavija, viti 2024", "Rikonstruksioni i Pallatit 1300 për vitin 2024"), (" Rikonstruksion i kopshtit nr. 10, viti 2024", "Rikualifikim i disa hapësirave të gjelbra të qytetit, viti 2024", "Rikonstruksion i rrugës ish- Fabrika e Çimentos (segmenti I-rë)", viti 2024").*

Për shkeljet e mëposhtme*:*

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) dhe të specifikimeve teknike (ST), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të paargumentuara dhe jo të lidhura me tipologjinë e procedurës, veprime të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE ose janë bërë shkak për skualifikim të OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës *(siç pasqyrohet në faqen 90-186 të RPA)*, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 "*Hartimi dhe publikimi*

i dokumenteve të tenderit" dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë "*Çmimi më i leverdishëm*", si dhe vlerësimin jo të saktë të OE të skualifikuar ose me mangësi të njëjta me OE e shpallur fitues, duke çuar në përdorimin pa efektivitet të fondeve për vlerën 12,273,298 lekë, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, *"Parimet e përzgjedhjeje*", neni 98, "*Anulimi i një procedure*", neni 76 "*Kriteret detyruese për s'kualifikim*", neni 92, "*Shqyrtimi i ofertave*", si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", neni 67, "*Klasifikimi i ofertave*".
15. Z. Z.S, me detyrë Specialist i administratoreve të pallateve, në **2** procedura prokurimi *("Rikonstruksion dhe shtesë anësore me tre kate në shkollën 9- vjeçare Lef Sallata", viti 2024", "Rehabilitimi i stacioneve të autobusëve dhe i stacionit të taksive elektrike Segmentit nga Shkolla e Marinës deri te Regina City, viti 2023").*
Për shkeljet e mëposhtme*:*
- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) dhe të specifikimeve teknike (ST), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të paargumentuara dhe jo të lidhura me tipologjinë e procedurës, veprime të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE ose janë bërë shkak për skualifikim të OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës *(siç pasqyrohet në faqen 90-186 të RPA)*, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë "*Çmimi më i leverdishëm*", si dhe vlerësimin jo të saktë të OE të skualifikuar ose me mangësi të njëjta me OE e shpallur fitues, duke çuar në përdorimin pa efektivitet të fondeve për vlerën 12,273,298 lekë, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, *"Parimet e përzgjedhjeje*", neni 98, "*Anulimi i një procedure*", neni 76 "*Kriteret detyruese për s'kualifikim*", neni 92, "*Shqyrtimi i ofertave*", si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", neni 67, "*Klasifikimi i ofertave*".
- Problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara, për *11 (njëmbëdhjetë)* raste. Problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me: **i.** në njëmbëdhjetë raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë/saktë; **ii.** në gjashtë raste janë miratuar objekte që nuk respektojnë kondicionet urbane, si numri minimal i vendparkimeve, sipërfaqja e lejuar e katit të fundit, vijën e ndërtimit, intensitetin maksimal të lejuar, lartësinë e matur me numër katesh dhe metra; **iii.** nuk ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në dy raste; **iv.** miratimin e certifikatave të përdorimit kur zhvilluesi ka kryer ndryshime të pa-autorizuara, referuar projektit të miratuar në katër raste; **v.** miratimin e certifikatës së përdorimit në mungesë të kompentencës në një rast; **vi.** mos-hartimin e aktmarrëveshjeve për përfitimin e

sipërfaqeve në favor të fondit publik për strehim social në pesë raste; **vii.** mos-përfshirjen e punonjësve të drejtorisë në shqyrtimin / miratimin e dokumenteve të procedurës së miratimit të lejeve të ndërtimit / përdorimit.
- Për mos administrimin korrekt të të dhënave lidhur me abonentët familjarë dhe subjektet private që kanë detyrime nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe mos marrjen e të gjitha masave të nevojshme për arkëtimin e këtyre detyrimeve, me pasojë krijimin e vlerave të konsiderueshme të borxhit tatimor.

16. Z. A.Rr, në cilësinë e ish-Kryeinspektorit të IMTV.

Për shkeljet e konstatuara*:*

Në lidhje me lejimin e fillimit të punimeve në kushtet e mungesës së konfirmimit të fillimit të punimeve në një rast dhe mos-kryerjen e inspektimeve me qëllim evidentimin e ndryshimeve në tre raste.

17. Z. F.H, në cilësinë e ish-Kryeinspektorit të IMTV.

Për shkeljet e konstatuara*:*

- Mos-kryerjen e inspektimeve me qëllim evidentimin e ndryshimeve në dy raste.
- Për vitin 2023, në tre raste nga mungesa e kontrollit në terren të punimeve të ndërtimit nga inspektorët e IMT-së të Bashkisë Vlorë, ka sjellë si pasojë devijimin nga leja e ndërtimit e miratuar. Veprime në kundërshtim me ligjin *107/2014, datë 31.07.2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Neni 51, Inspektimi e Neni 52, Kundërvajtje administrative dhe ligjin Nr.9780, datë 16.07.2007,* "*Për inspektimin e ndërtimit", Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar,*

Për vitin 2024 si Kryeinspektor i IMTV
- Hartimi i planeve tri-mujore dhe/ose vjeçare të punës nuk ishte kryer në mënyrë periodike; Raportimi në IKMT nuk është kryer periodik, si dhe nuk është kryer i plotë, për të gjithë periudhën nën auditim; Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, është konstatuar se për 166 raste në vitin 2024, për të cilat kryeinspektori i IMTV ka nxjerrë vendimin e prishjes, nuk ka një evidencë për realizimin e prishjeve.

Veprime në kundërshtim me VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore",* nënpika b.ii; Nenit 5 të Ligjit nr.9780, datë 16/07/2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f); dhe nenit 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a).

18. Z. E.A, në cilësinë e Kryeinspektori të IMTV aktualisht Drejtor i Policisë Bashkiake.

Për shkeljet e konstatuara*:*

Në vitin 2024 si Kryeinspektor i IMTV
- Hartimi i planeve tri-mujore dhe/ose vjeçare të punës nuk ishte kryer në mënyrë periodike; Raportimi në IKMT nuk është kryer periodik, si dhe nuk është kryer i plotë, për të gjithë periudhën nën auditim; Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, është konstatuar se për 166 raste në vitin 2024, për të cilat kryeinspektori i IMTV ka nxjerrë vendimin e prishjes, nuk ka një evidencë për realizimin e prishjeve.

Veprime në kundërshtim me VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore",* nënpika b.ii; Nenit 5 të Ligjit nr.9780, datë 16/07/2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika (f); dhe nenit 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika (a).

19. Z. A.H, me detyrë specialist inxhinier në IMT Bashkia Vlorë;

20. Z. G.A, me detyrë specialist inxhinier në IMT Bashkia Vlorë;

Për shkeljet e konstatuara*:*

Për shfrytëzimin e hapësirës publike nga subjektet, (*për vitin 2023, për asnjë rast nuk rezultoi procesverbal për dorëzimin hapësirës publike; mungojnë Akt marrëveshjes/kontratës; mungojnë planvendosjet për vlerësim bazuar në matjet e bëra nga inxhinieri i Bashkisë);* pa përmbushur detyrimet tatimore për zërin e hapësirës publike stacion plazhi ka sjellë mungesë të ardhurash në Bashkinë Vlorë në vlerë **8,008,476** lekë për 57 subjekte, veprime në

kundërshtim me nenin 5, pika 3.d, të VKM nr.171, datë 27.03.2019 " Për Miratimin e Rregullores për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit", ndryshuar me VKM nr.659, datë 10.10.2022.

21. Zj. E.L, me detyrë Specialiste, Njësia e Legalizimeve, në cilësinë e ish- Drejtorit të NSHP-Bashkia Vlorë, në **6** procedura prokurimi: *("Blerje kontejneri 1.1 m3, Sektorin e Shërbimeve, viti 2024", "Blerje karburanti, Sektori i Gjelbërimit, viti 2024", "Blerje karburanti, Bordi Kullimit, viti 2024", "Blerje karburanti për nevojat e NSHP, viti 2024 ", "Blerje karburanti për nevojat e Sektorit të Pastrimit, viti 2024", "Punime te vendgrumbullimi i mbetjeve, dëmtime nga zjarri, viti 2023").*

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit:

1.*Me Vendimin nr. 3 datë 19.02.2026 të Komisionit të Disiplinës është dhënë masa disiplinore "Largim nga shërbimi civil" për nëpunësin M.C, me detyrë "Specialiste" në Njësinë e Prokurimit.*

2. *Me Vendimin nr. 623 datë 16.07.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin Znj. Xh.K, me detyrë "Përgjegjëse", në Sektorin e Buxhetit.*

3. *Me Vendimin nr. 240 datë 25.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës" për nëpunësin F.R, me detyrë "Përgjegjëse" në Sektorin e Taksës së Pasurisë.*

4. *Me Vendimin nr. 243 datë 25.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës" për nëpunësin E.H, me detyrë "Përgjegjës" në Sektorin Teknik.*

5. *Me Vendimin nr. 241 datë 25.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës" për nëpunësin E.D, me detyrë "Inxhiniere mjedisi" Ndërmarrja e Pastrimit.*

6. *Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Largim nga Detyra" për D.Z, me detyrë "Sekretar" në Këshillin Bashkiak, Vlorë.*

7. *Me Vendimin nr. 8 datë 26.03.2026 të Komisionit të Disiplinës është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin S.Zh, me detyrë "Specialiste" në DFBK.*

8. *Me Vendimin nr. 9 datë 26.03.2026 të Komisionit të Disiplinës është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin E.N. me detyrë "Specialiste inxhiniere ndërtimi" DU.*

9. *Me Vendimin nr. 217 datë 19.02.2026 të Komisionit të Disiplinës është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" E.B, me detyrë "Përgjegjës" në Sektorin e Shërbimeve.*

10. *Me Vendimin nr. 244 datë 25.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës" për nëpunësin E.S, me detyrë "Përgjegjëse finance", Ndërmarrja e Pastrimit.*

11. *Me Vendimin nr. 237 datë 25.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës" për nëpunësin M.Z, me detyrë "Ekonomiste" Ndërmarrja e Gjelbërimit.*

12. *Me Vendimin nr. 236 datë 25.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës" për nëpunësin A.S, me detyë "Përgjegjës", Bordi i Kullimit.*

13. *Me Vendimin nr. 245 datë 25.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës" për nëpunësin A.L, me detyrë "Specialist i operimit të impiantit", MIM.*

14. *Me Vendimin nr. 4 datë 19.02.2026 të Komisionit të Disiplinës është dhënë masa disiplinore "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 vit" L.A, me detyrë "Specialist" në Njësinë e Prokurimit.*

15. *Me Vendimin nr. 622 datë 16.07.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore 'Vërejtje" për nëpunësin Z.S, me detyrë "Specialist i administratorëve të pallateve" DIIP.*

16. *Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore 'Largim nga Detyra" për A.R, Ish- Kryeinspektorit të IMTV.*
17. *Me Vendimin nr. 238 datë 25.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës" për nëpunësin F.H, Ish- Kryeinspektorit të IMTV.*
18. *Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Largim nga Detyra" për E.A, me detyrë "Kryeinspektor" në IMTV.*
19. *Me Vendimin nr. 242 datë 25.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës" për nëpunësin A.H, me detyrë "Specialist inxhinier".*
20. *Me Vendimin nr. 5 datë 23.02.2026 të Komisionit të Disiplinës është dhënë masa disiplinore "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 vit" G.H, me detyrë "Specialist inxhinier".*
21. *Me Vendimin nr. 239 datë 25.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës" për nëpunësin E.L, me detyrë "Agronome" NJ.A Qendër.*
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

F.2. Masa " Vërejtje", për 20 (njëzet) punonjës, si vijon:
1. Zj. S.H, me detyrë Specialiste juriste, Drejtoria Juridike, në **1 (një)** procedurë prokurimit: *"Rehabilitimi i stacioneve të autobusëve dhe i stacionit të taksive elektrike Segmentit nga Shkolla e Marinës deri te Regina City, viti 2023".*
2. Zj. S.K, me detyrë Specialiste juriste, Drejtoria Juridike, në **1 (një)** procedurë prokurimi: *"Rehabilitimi i stacioneve të autobusëve dhe i stacionit të taksive elektrike Segmentit nga Shkolla e Marinës deri te Regina City, viti 2023".*
3. Zj. M.D, me detyrë Faturiste e taksës së ndikimit në infrastrukture nga ndërtimet e reja, në **1 (një)** procedurë prokurimi: "*Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme në njësinë Administrative Orikum për vitin 2023".*
4. Zj. L.Sh me detyrë Përgjegjëse finance, Ndërmarrja e Gjelbërimit, në **1 (një)** procedurë prokurimi: *"Punime te vendgrumbullimi i mbetjeve, dëmtime nga zjarri, viti 2023).*
Për shkeljet e konstatuara*:*
Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesor "*Çmimi më i leverdishëm*", si dhe vlerësimin jo të saktë të OE të skualifikuar ose me mangësi të njëjta me OE e shpallur fitues, duke çuar në përdorimin pa efektivitet të fondeve për vlerën 12,273,298 lekë, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, *"Parimet e përzgjedhjeje*", neni 98, "*Anulimi i një procedure*", neni 76 "*Kriteret detyruese për skualifikim*", neni 92, "*Shqyrtimi i ofertave*", si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", neni 67, "*Klasifikimi i ofertave*".
5. Zj. V.Ç, me detyrë Supervizor në Drejtorinë e Investimeve.
Për shkeljet e mëposhtme:
Mos hartimin e saktë të fondit limit për shërbimin e pastrimit të Nj.A Orikum, duke mos u bazuar në Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve për periudhën 2023 – 2028, miratuar me Vendimin e KB nr. 26, datë 31.03.2023 (*me nr. 3403/1 prot., datë 04.04.2023*), në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe në zbatim të kërkesave të nenit 10, të Ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*", i ndryshuar, veprime të cilat kanë ndikuar në rritjen e fondit të prokuruar padrejtësisht për vlerën 4,957,766 *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 90-186, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6. Zj. D.F, me detyrë Specialiste investimesh, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, në **1 (një)** procedura prokurimi: *"Rikualifikim i disa hapësirave të gjelbra të qytetit, viti 2024"*.
7. Z. E.B, me detyrë Specialist Inxhinier ndërtimi, në **1 (një)** procedurë prokurimi: *"Rehabilitimi i stacioneve të autobusëve dhe i stacionit të taksive elektrike Segmentit nga Shkolla e Marinës deri te Regina City, viti 2023".*
8. Zj. D.Z, me detyrë Specialiste Ekonomiste, NSHP, në **1 (një)** procedura prokurimi: "*Mirëmbajtje Hidrovori", viti 2023"***.**
9. Zj. L.K, me detyrë Juriste, Ndërmarrja e Pastrimit, në **1 (një)** procedurë prokurimi: "*Blerje Asfalto beton viti", viti 2024".*
10. Zj. L.S, me detyrë Përgjegjëse finance, Ndërmarrja e Gjelbërimit, në **1 (një)** procedurë prokurimi: "*Blerje Asfalto beton" viti 2024.*
11. Z. E.B, me detyrë Përgjegjës, Sektori i Shërbimeve, NSHP, në **1 (një)** procedurë prokurimi: *"Blerje skrep me kovë të parë 1.2 m³ dhe kovë të pasme 0.5m³",* viti 2023".
12. Z. E.S, me detyrë Teknik i mesëm, Ndërmarrja e Gjelbërimit, në **1 (një)** procedurë prokurimi: *"Blerje skrep me kovë të parë 1.2 m³ dhe kovë të pasme 0.5m³", viti 2023".*
13. Z. A.M, me detyrë Topograf, Sektori Teknik, në **1 (një)** procedurë prokurimi: *"Blerje fadrome me kovë mbi 3 ton", viti 2023".*

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) dhe të specifikimeve teknike (ST), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të paargumentuara dhe jo të lidhura me tipologjinë e procedurës, veprime të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE ose janë bërë shkak për skualifikim të OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës *(siç pasqyrohet në faqen 90-186 të RPA)*, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
14. Z. F.Ll, me detyrë Përgj/ Sektori të Terrenit në DATV (Drejtor i komanduar);
15. Z. S.H, me detyrë Administrator në NJA Orikum;
16. Z. G.F, me detyrë administrator në NJA Qendër;
17. Z. K.S, me detyrë administrator në NJA Novosel.
18. Z. B.A, me detyrë Administrator në NJ.A Shushicë.

Për shkeljet e konstatuara:

Mos administrimin korrekt të të dhënave lidhur me abonentët familjarë dhe subjektet private që kanë detyrime nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe mos marrjen e të gjitha masave të nevojshme për arkëtimin e këtyre detyrimeve, me pasojë krijimin e vlerave të konsiderueshme të borxhit tatimor.
19. Zj. A.S, me detyrë administratore e Drejtorisë së Shërbim Pastrimit.

Për shkeljet e konstatuara:

Mos administrimin korrekt të të dhënave lidhur me abonentët familjarë dhe subjektet private që kanë detyrime nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe mos marrjen e të gjitha masave të nevojshme për arkëtimin e këtyre detyrimeve, me pasojë krijimin e vlerave të konsiderueshme të borxhit tatimor. "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar si dhe VKB nr. 95, datë 23.12.2022 ndryshuar; VKB nr. 96, datë 07.12.2023 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë" ndryshuar.
20. Z. I.H me detyrë Inxhinjer Elektrik në Sektorin e Ndricimit, në **1 (një)** procedurë prokurimi: *"Blerje Materiale Elektrike për ndriçim publik dhe institucionin për vitin 2024.*

Për shkeljet e konstatuara:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat

duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë "*Çmimi më i leverdishëm*", si dhe vlerësimin jo të saktë të OE të skualifikuar ose me mangësi të njëjta me OE e shpallur fitues, duke çuar në përdorimin pa efektivitet të fondeve për vlerën 12,273,298 lekë, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, *"Parimet e përzgjedhjeje*", neni 98, "*Anulimi i një procedure*", neni 76 "*Kriteret detyruese për skualifikim*", neni 92, "*Shqyrtimi i ofertave*", si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", neni 67, "*Klasifikimi i ofertave*".

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit:
1. *Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Largim nga Detyra" për S.K, me detyrë "Specialiste juriste", Drejtoria Juridike.*
2. *Me Vendimin nr. 213 datë 19.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin M.D, me detyrë "Faturiste e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja".*
3. *Me Vendimin nr. 215 datë 19.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin V.C, me detyrë "Supervizor" në Drejtorinë e Investimeve.*
4. *Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Largim nga Detyra" për D.F, me detyrë "Specialiste investimesh" DIIP.*
5. *Me Vendimin nr. 621 datë 16.07.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin E.B, me detyrë "Specialist inxhinier ndërtimi".*
6. *Me Vendimin nr. 216 datë 19.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin D.Z, me detyrë "Specialiste ekonomiste" Ndërmarrja e Pastrimit.*
7. *Me Vendimin nr. 211 datë 19.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin L.K, me detyrë "Juriste" Ndërmarrja e Pastrimit.*
8. *Me Vendimin nr. 217 datë 19.02.2026 të Komisionit të Disiplinës është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" E.B, me detyrë "Përgjegjës" në Sektorin e Shërbimeve.*
9. *Me Vendimin nr. 221 datë 19.02.2026 të Komisionit të Disiplinës është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" E.S, me detyrë "Teknik i mesëm" NGJ.*
10. *Me Vendimin nr. 220 datë 19.02.2026 të Komisionit të Disiplinës është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" A.M, me detyrë "Topograf" Sektori Teknik.*
11. *Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Largim nga Detyra" për S.H, me detyrë "Administrator" NJA Orikum.*
12. *Me Vendimin nr. 212 datë 19.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin G.F, me detyrë "Administrator" NJA Qendër.*
13. *Me Vendimin nr. 210 datë 19.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin Z. K.S, me detyrë administrator në NJA Novosel.*
14. *Me Vendimin nr. 214 datë 19.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin B.A, me detyrë "Administrator" NJA Shushicë.*
15. *Me Vendimin nr. 260 datë 27.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin I.H, me detyrë "Elektricist" në Sektorin e Ndriçimit.*
Rekomandimi është zbatuar plotësisht.

E. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Vlorë (Drejtoria e Burimeve Njerëzore), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore

Për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të ahteve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil"', i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.
Zbatimi i rekomandimeve për Bashkinë Vlorë (Formulari nr. 12), në mënyrë tabelore paraqitet në Kapitullin "Anekse" – Aneksi nr.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III.2.2.5.Të ndryshme të dala gjatë auditimit.
Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit *"Të ndryshme të dala gjatë auditimit"*, u verifikua ankesa e subjektit T. Sh.P.K, me objekt "Kërkesë për zhbllokimin e llogarive bankare dhe ankesë për pasojat e krijuara ndaj subjektit T. Sh.P.K", protokolluar në KLSH-së me shkresën nr.467 prot., datë 22.04.2026.
-Në mënyrë të përmbledhur subjekti i mësipërm ankohet për vlerësimin tatimor të kryer nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë, në vitin 2024. Konkretisht ndaj subjektit është aplikuar tarifa e pastrimit në vlerën 50,000 lekë. Këtë vlerësim DTTV Bashkia Vlorë e ka kryer në zbatim të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH pranë Bashkisë Vlorë.
Subjekti është njoftuar për likuidimin e këtij detyrimi, si dhe në vijim, si rrjedhojë e moslikujdimit të detyrimit, nga DTTV Bashkia Vlorë është vendosur bllokimi i llogarive bankare të subjektit T. Sh.P.K.
Sa më sipër me qëllim pasqyrimin e saktë dhe të plotë të veprimeve nga DTTV Bashkia Vlorë, u auditua dokumentacioni i administruar në Bashkinë Vlorë, konkretisht:
-Regjistri i realizimit të prokurimeve për vitin 2022;
-Raporti Përfundimtar i auditimit të kryer nga KLSH pranë Bashkisë Vlorë, përcjellë me shkresën nr.1130/1 prot., datë 10.12.2025;
-Paketa Fiskale në fuqi për periudhën e mësipërme;
-Ekstrakti historik i subjektit T. Sh.P.K, nxjerrë nëpërmjet QKB-së;
-Korrespondenca e komunikimit ndërmjet DTTV dhe Njësisë së Prokurimit Bashkia Vlorë;
-Urdhri i brendshëm nr.132, datë 02.05.2024 "Për arkëtimin e detyrimeve sipas raportit përfundimtar të auditimit të KLSH";
-Njoftimi dhe kërkesa nr.19314 prot., datë 18.11.2025 drejtuar subjektit T. Sh.P.K për të likujduar detyrimin;
-Urdhrin e bllokimit të llogarive bankare të subjektit T. Sh.P.K.

Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm rezultoi se:
-Subjekti T. Sh.P.K, ushtron aktivitet me seli kryesore në adresën Elbasan, Bradashesh, Kusarth, Rruga Kadri Hoxha, ZK 2346, pasuria nr.428, me objekt "*Import - Eksport, Projektim, Prodhim, Instalim, Transportim, Përpunim, Tregtim të Instrumentave Matës të Peshimit jo Automatik me kapacitet nga 1 deri 80.000 kg etj*".
-Subjekti nuk ka hapur asnjëherë adresë sekondare në territorin e Bashkisë Vlorë, që të jetë objekt i taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në këtë Bashki, në zbatim të Paketës Fiskale;
-Ankesa e subjektit T. Sh.P.K lidhur me aplikimin e tarifës së pastrimit, qëndron dhe duhet të ishte pranuar nga DTTV Bashkia Vlorë;
-Aplikimi i tarifës së pastrimit nga DTTV Bashkia Vlorë ndaj subjektit T. Sh.P.K, nuk qëndron.

Si përfundim nga DTTV Bashkia Vlorë, duhet të merren masat e nevojshme për heqjen nga sistemi TAIS të detyrimit dhe zhbllokimin e llogarive bankare të subjektit T. Sh.P.K.

IV. REKOMANDIME:

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Bashkinë Vlorë, për vitin 2025, rezultoi se sistemi i kontrollit të brendshëm nuk është ngritur dhe nuk funksionon plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore. Bashkia Vlorë ka vijuar të zbatojë rregulloren e brendshme të vitit 2018, e papërshtatur me strukturën organizative të vitit 2025, duke mos garantuar përcaktimin e qartë të detyrave, përgjegjësive dhe linjave të raportimit.
Strukturat organizative nuk kishin hartuar plane vjetore pune, harta dhe manuale të proceseve, si dhe gjurmët e auditimit për proceset kryesore. Nuk janë përgatitur raporte periodike për monitorimin e planit të veprimit të MFK-së, ndërsa raporti vjetor për vitin 2025 nuk përmban të gjithë elementet e kërkuara për vlerësimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm, trajtimin e risqeve, rekomandimet e auditimit dhe masat për përmirësimin e sistemit.
Në administrimin e burimeve njerëzore nuk është hartuar plan vjetor rekrutimi, ndërsa dosjet e personelit paraqesin mangësi në përshkrimet e punës, objektivat individuale dhe vlerësimet periodike. Për punësimin e dy punonjësve me Kod Pune nuk u paraqit dokumentacion që të provonte shpalljen e vendeve të punës, kriteret e miratuara, vlerësimin e kandidatëve dhe arsyetimin e përzgjedhjes, duke mos garantuar transparencën, objektivitetin dhe gjurmueshmërinë e procesit. Përfundimi mbi detyrimin për konkurrim duhet të mbështetet edhe në statusin juridik të pozicioneve dhe aktet e brendshme të Bashkisë. Në fushën e teknologjisë së informacionit mungojnë procedurat për krijimin, ruajtjen dhe testimin e kopjeve rezervë, si dhe plani për menaxhimin e riskut IT dhe rikuperimin e të dhënave. Sistemi i raportimit nuk siguron informacion të plotë mbi realizimin e objektivave të Bashkisë dhe të njësive të varësisë.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me nenet 5, 8, 9, 16, 17, 18 në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; Pikat 2.2, 2.2.4 dhe 2.2.5 në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"; Kapitulli II, pikat 2.2.6 dhe 2.5.2, si dhe Kapitulli III, pikat 3.1 dhe 3.2 në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për forcimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke:
-Hartuar dhe përditësuar gjurmët e auditimit për të gjitha proceset dhe aktivitetet kryesore të institucionit, në funksion të rritjes së gjurmueshmërisë dhe përgjegjshmërisë administrative;
-Hartuar plane vjetore pune për çdo strukturë organizative, të lidhura me objektivat institucionale;
-Përcaktuar dhe dokumentuar kriteret e përzgjedhjes për punonjësit që punësohen sipas Kodit të Punës, në mënyrë që procedurat e rekrutimit të jenë transparente, të dokumentuara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Vlorë rezultoi se:
-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenet 12, 13 të Ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",* i ndryshuar;

-Për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Vlorë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Inspektoriati të Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm;
-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;
- DAB Bashkia Vlorë nuk kishte dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 *"Dosja e Përhershme". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, të marrin masa që:
- Në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart.
- Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, si një organ i pavarur.
- Në raportet e hartuara në përfundim të çdo angazhim auditimi, audituesit të plotësojnë opinionin e përgjithshëm lidhur me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", u konstatua se gjendja e kësaj llogarie është mbivlerësuar me 51,904,240 lekë. Kjo vlerë përfaqëson garancitë e kontratave, në masën 5% të vlerës së tyre, për të cilat ka përfunduar afati i garancisë. Meqenëse Bashkia Vlorë nuk kishte paraqitur kërkesa apo pretendime ndaj kontraktorëve lidhur me cilësinë e punimeve, nuk ekzistojnë kushte për mbajtjen e mëtejshme të këtyre garancive. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2, klasa 4 në Udhëzimin e MF nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Vlorë të marrin masat e nevojshme, me qëllim likuidimin e vlerës së garancive të punëve publike, të cilat janë kontabilizuar si aktive dhe është plotësuar afati i garancisë në kontratë. Në vijim Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2026

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", u konstatua se kjo llogari është pasqyruar më pak për 175,551,000 lekë, që përfaqëson vlerën e aksioneve që zotëron Bashkia Vlorë në shoqëritë aksionare. Konkretisht, nga verifikimi i kryer në databazën e QKB-së, ka rezultuar se Bashkia Vlorë zotëron aksione në disa shoqëri aksionare, si vijon: Vlora Parking Sh.A., me NIPT M56403202P, 100% të aksioneve me vlerë 3,500,000 lekë; Markata e Peshkut Sh.A., me NIPT M46723211H, 100% të aksioneve me vlerë 3,500,000 lekë; Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë Sh.A., 41.35% të aksioneve me vlerë 4,135,000 lekë; K.F.Oriku Sh.A., me NIPT L36521202N, 100% të aksioneve me vlerë 4,100,000 lekë; Flamurtari Football Club Sh.A., me NIPT L17130203I, 100% të aksioneve me vlerë 3,500,000 lekë; Tregu Shitjes me Shumicë Frut-Perim Sh.A., me NIPT K67217201D, 100% të aksioneve me vlerë 156,816,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet në seksionin 3.1, paragrafi 31 në Udhëzimin e MF nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, si dhe në Standardin Kombëtar

të Kontabilitetit nr. 14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit në Bashkinë Vlorë, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2026

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të aktiveve afatgjata materiale në mbyllje të vitit 2025, rezultoi se nuk ka analizë më vete për vlerat e rikonstruksioneve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, të lidhura me investimet e kryera, të cilat nuk janë përfshirë në vlerën e aktiveve përkatëse. Gjithashtu, rezultoi keqklasifikim kontabël, i gjendjes së këtyre aktiveve në llogaritë:

- Nr. 212 "Ndërtesa e Konstruksione", janë keqklasifikuar 7 aktive në vlerën prej 96,594,903 lekë, nga të cilat 6 aktive në vlerën 88,775,097 lekë, që i përkasin llogarisë nr.213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" dhe 1 aktiv në vlerën 7,819,806 lekë, që i përket llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene.
- Nr. 213 "Rrugë, mjete, vepra ujore", janë keqklasifikuar 30 aktive në vlerën prej 103,720,750 lekë, nga të cilat 5 aktive në vlerën 16,228,308 lekë, që i përkasin llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene", 13 aktive në vlerën 3,738,580 lekë, që i përkasin llogarisë 214 "Instalime teknike makineri e pajisje" dhe 12 aktive në vlerën 83,753,862 lekë, që i përkasin llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione". Gjithashtu në gjendjen e llogarie nr.213 është përfshirë vlera 37,387,815 lekë e emërtuar "Të tjera", e cila është trashëguar nga ish-komunat, vlerë e pa analizuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun II, pikat 5, 11, 36, Aneksi 1, pika 2/1 germa (e), Klasa 2 në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85 në Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit në Bashkinë Vlorë të marrë masa për të analizuar dhe rishikuar dokumentacionin financiar të trashëguar nga ish-komunat, si dhe për kryerjen e inventarizimit fizik, me qëllim identifikimin, evidentimin dhe rakordimin e tyre me të dhënat kontabël.

-Të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për kalimin e vlerave të aktiveve sipas llojit përkatës, duke i evidentuar në llogaritë e përshtatshme sipas klasifikimit, si dhe të bëhen korrektimet e nevojshme në llogaritjen e amortizimit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2026

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.202 "Studime dhe projektime", ka rezultuar se në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 115,857,512 lekë (e pa ndryshuar), ku sipas analizës përfaqëson vlerën e 52 projekt-studimeve të pa shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Ndërsa vlera prej 9,812,760 lekë e emërtuar "Të tjera", nuk është e analizuar dhe nuk ka informacion se çfarë përfaqëson. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur, në kundërshtim me kreun III, pika 36, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2, pika 3.3 në Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, si dhe pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 në Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për administrimin e aktiveve dhe komisionin e inventarizimit të Bashkisë Vlorë, të marrë masa për të analizuar dokumentacionin financiar dhe teknik të

aktiveve, përfshirë atë të trashëguar nga ish-komunat, si dhe të kryerjen e inventarizimit fizik dhe rakordimin me të dhënat kontabël.
-Të identifikojë dhe dokumentojë në mënyrë analitike vlerën prej 37,387,815 lekë të evidentuar me përshkrimin "Të tjera", si dhe kostot e rikonstruksionit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për çdo aktiv.
- Të kryhen sistemimet kontabël për klasifikimin e çdo aktivi në llogarinë përkatëse nr.210 "Toka, troje dhe terrene", nr.212 "Ndërtesa dhe konstruksione", 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" ose 214 "Instalime teknike dhe makineri", si dhe të korrigjohet amortizimi i llogaritur, të përditësohen regjistrat analitikë të aktiveve dhe pasqyrat financiare.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2026

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të vitit 2025, ka rezultuar se buxheti është realizuar në masën 57%, ku realizimin më të lartë e kishte ndihma ekonomike, ndjekur nga shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë shpenzimet për mallra, shërbime dhe investime. Ky mos realizim vjen për faktin se parashikimi i shpenzimeve nuk është bërë mbi bazën e të ardhurave faktike të një viti më parë, por është planifikuar mbi planin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore. Detyrimet e prapambetura të raportuara në fund të vitit 2025, konstatohet se ishin në vlerën 72,399,600 lekë, vlerë e cila në raport me totalin e shpenzimeve të vitit, zë 2.81 %, gjë që tregon se kjo njësi vendore nuk është në vështirësi financiare.
-Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 60 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Vlorë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2025, ky afat nuk është respektuar në 4 raste për shpenzime për investime dhe shpenzime korrente në vlerën 38,013,266 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me germën (a) të nenin 5, të Ligjit nr. 68/2017, i ndryshuar, pikën 24 dhe 25 të nenit 3, nenin 47 në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, i ndryshuar, si dhe pikat 8 dhe pika 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe të bëjë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2026

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, të marrë masa për të përmirësuar planifikimin buxhetor dhe monitorimin periodik të zbatimit të fondit të investimeve, duke planifikuar fondet mbi nevoja reale dhe duke analizuar në kohë devijimet nga plani, me qëllim rritjen e nivelit të realizimit dhe përdorimin efektiv të fondeve publike.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i ankesës të subjektit T. Sh.P.K., me objekt "Kërkesë për zhbllokimin e llogarive bankare dhe ankesë për pasojat e krijuara ndaj subjektit T. Sh.P.K." protokolluar në KLSH-së me shkresën nr.467 prot., datë 22.04.2026, rezultoi se:
-Subjekti nuk ka hapur asnjëherë adresë sekondare në territorin e Bashkisë Vlorë, që të jetë objekt i taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në këtë Bashki, në zbatim të Paketës Fiskale;
-Ankesa e subjektit T. Sh.P.K lidhur me aplikimin e tarifës së pastrimit, qëndron dhe duhet të ishte pranuar nga DTTV Bashkia Vlorë;
-Aplikimi i tarifës së pastrimit nga DTTV Bashkia Vlorë ndaj subjektit T. Sh.P.K, nuk qëndron. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKB nr. 96, datë 07.12.2023 "Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2025", i ndryshuar, kapitulli nr.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 104-105, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë të marrë masat e nevojshme për heqjen nga sistemi TAIS të detyrimit dhe zhbllokimin e llogarive bankare të subjektit T. Sh.P.K.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, rezultoi se Bashkia Vlorë administron të dhëna sa i takon subjekteve biznes, ndërkohë që për detyrimet e familjarëve ka marrë të mirëqenë vlerat totale të arkëtuara që i kalohen nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë, pa kryer verifikime dhe pa njohur numrin e abonentëve taksapagues dhe atyre debitorë. Me përjashtim të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, drejtoritë e tjera që administrojnë taksa/tarifa nuk mbajnë regjistër për menaxhimin e të dhënave. Gjithashtu konstatohet se procesi i administrimit të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Vlorë është i shpërndarë dhe jo i mirëkoordinuar. Duke qenë se pranë kësaj bashkie ekziston Drejtoria e të Ardhurave Vendore, e cila është përgjegjëse vetëm për administrimin e të dhënave që lidhen me subjektet private, ndërkohë që e gjithë pjesa tjetër e të ardhurave administrohen nga drejtori të tjera. Situata e mësipërme ndikon negativisht në procesin e planifikimit dhe marrjes së masave për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 5, pikat 1–3, nenin 16, pika 2, nenin 23, pikat 1–5 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Nenin 4, pika 7, të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; si dhe me nenin 12, pika 1, të ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1. Rekomandimi: Drejtoritë përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore dhe Njësitë Administrative, të marrin masa për mbajtjen e regjistrave me të dhëna të sakta dhe të plota për subjektet që administrojnë, si private ashtu edhe familjarë, duke pasqyruar rregullisht përllogaritjet për vlerat që do tarifohen dhe ato që do arkëtohen, si dhe gjendjet debitorë për secilin subjekt, si dhe të rakordohen periodikisht me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Në vijimësi

9.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të analizojë mundësinë e ndryshimeve në strukturat aktuale përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, duke i centralizuar këto përgjegjësi, me qëllim planifikimin dhe koordinimin më të saktë të treguesve mbi taksat dhe tarifat vendore.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2026

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr. 601/45 prot., datë 31.12.2025, rezultoi se:

Bashkia Vlorë ka dërguar planin e masave brenda afatit 20-ditor, por nuk ka paraqitur raportimin 6-mujor mbi ecurinë e zbatimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën nr. 2, neni 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Në lidhje me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, ka rezultuar se janë rekomanduar:

- 40 masa organizative, nga të cilat 5 janë zbatuar plotësisht, 8 zbatuar pjesërisht dhe 27 pa zbatuar;
- 19 masa për shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën 6,744,090 lekë, nga të cilat 4 masa janë zbatuar plotësisht dhe 15 janë zbatuar pjesërisht;
- 15 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin e të ardhurave të munguara të lëna në auditimin e mëparshëm, nga të cilat 2 janë zbatuar plotësisht, 12 zbatuar pjesërisht dhe 1 pa zbatuar;
- 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat nuk janë zbatuar;

-masa disiplinore për 41 persona, të cilat janë zbatuar plotësisht.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-104, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
10.1. Rekomandimi: Për sa më sipër rikërkojmë[30] që, Bashkia Vlorë, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të "zbatuara pjesërisht" dhe të "pazbatuara", si më poshtë:

Masa organizative të lëna në auditimin e mëparshëm.

6.1- Rekomandimi: Bashkia Vlorë, të marrë masa për monitorimin e procesit të grumbullimit përpunimit ruajtjes së informacionit dhe gjenerimit të raporteve të sakta dhe në kohë për subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj, me cilësi dhe konform standarteve të përcaktuara në kuadrin rregullator.
9.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit të kryejë procedurat ligjore për transferimin e aktiveve që i përkasin ujësjellësve të rrjetit shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji në "Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime, Vlorë" dhe të kryhen veprimet sistemuese kontabël në llogarinë *213"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*.
10.1- Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit për 179 objekte inventari të pasurive të paluajtshme (ndërtesa) me kosto historike në vlerën 1,488,986,380 lekë të marrin masa që të kryhen procedurat e plota për hipotekimin dhe certifikimin në ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë, në mënyrë që këto aktive kjo njësi vendore ti zotërojë e të sigurojë njohjen në kontabilitet mbi bazën e dokumenteve ligjorë.
12.1- Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), të marrin masa për shmangien e copëzimit të fondeve dhe grupimin e sa më shumë blerjeve me vlerë të vogël me natyra të njëjta apo zëra të njëjta shpenzimesh, në një procedurë të vetme, nisur nga fakti se nevojat për shpenzime të njësive publike janë planifikuar dhe miratuar që në hartimin e buxhetit vjetor dhe nuk janë blerje të ndodhura nga situata emergjente.
13.1- Rekomandimi: Titullari i Ndërmarrjes së Shërbimeve të marrë masa dhe të kërkojë nga NJP dhe KVO respektimin me rigorozitet dhe në mënyrë kronologjike të të gjithë hapave që duhen ndjekur gjatë realizimit të procedurave të prokurimit blerje me vlerë të vogël, duke garantuar dokumentimin e çdo hapi që nga lindja e nevojës për shpenzim e deri në pasqyrimin e plotë të procesit të vlerësimit nga KVO. Procesi të kryhet me përgjegjshmëri vetëm nga personat e ngarkuar me urdhra pune për këtë qëllim.
14- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, në cilësinë e Titullarit të AK- Bashkia Vlorë, të marrë masa që në asnjë rast të zhvillimit të procedurave të investimeve publike, të mos lidhë kontratën e zbatimit pa miratimin paraprak të "*leje ndërtimi/infrastrukture*" dhe oponencës teknike të objektit ne rastet kur kërkohet.
15.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, në cilësinë e Titullarit të AK- Bashkia Vlorë, të marrë masa për hartimin e projekteve nga persona/subjekte të licencuar, sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, në mënyrë që të kemi projekte sa më cilësore dhe që paraqesin gjendjen reale të objektit.
16.1- Rekomandimi: Bashkia Vlorë *(Sektori i Procedurave të Prokurimit)* dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike- Bashkia Vlorë, të marrin masa për arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura në të gjitha fazat e tij.
17.1- Rekomandimi: Drejtoria e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, Drejtoria e Bordit të Kullimit, Drejtoria e Gjelbërimit dhe Pastrimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe të Financës Bashkia Vlorë, gjatë planifikimit në buxhet të fondit për sasinë e karburantit që do prokurohet në periudhë në vijim, të ngrejë një grup pune me specialist të

[30] Rekomandimet të cilat janë dhënë në këtë auditim për problematika të ngjashme të konstatuara në auditimin në zbatim të Programit të Auditimit nr.739/1 prot., datë 01.07.2026, i ndryshuar, nuk janë pasqyruar për të shmangur përsëritjen.

fushës për hartimin e procesverbaleve mbi konsumin për 100/km/ orë pune (pavarësisht librezës së mjeteve), mbi normativën e harxhimit të karburantit, mbi volumin e punës së kryer në vitin që mbyllet dhe të mjeteve që janë gjendje pune.

18.1- Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të marrë masa të argumentojë dhe dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, duke u mbështetur në specifikimet teknike të objektit që do prokurohet, si dhe të sigurojë krijimin e kushteve për konkurrencë të paanshme.

19.1- Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë (*aparati*) dhe NSHP- Bashkia Vlorë (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), të marrë masa për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, specifikimeve teknike dhe kriterit të vlerësimit të ofertave, në mënyrë që të sigurohet transparencë, trajtim i barabartë dhe mos-diskriminim ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe të promovohet konkurrenca, duke garantuar përdorimi me ekonomicitet i fondeve publike.

20.1- Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Vlorë *(aparati)* dhe AK në Ndërmarrja e Shërbimeve Publike-Bashkia Vlorë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e OE, të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DT. Në çdo rast, gjatë fazës së vlerësimit të një procedure prokurimi, duket të konsiderohet e vlefshme dhe të kualifikohet vetëm ajo ofertë që është plotësisht në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës, ftesës për ofertë ose dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor i ka vlerësuar të domosdoshme.

21.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin masat të analizojnë shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit me mungesa në dokumentacion, nxjerrjen e përgjegjësive, si dhe hartimin e një metodologjie të unifikuar për realizimin e këtij procesi.

22.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin masat të analizojnë shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit që nuk respektojnë kondicionet urbane ligjore, si dhe të nxjerrje përgjegjësitë përkatëse, me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit në përputhje me dokumentet e planifikimit të Bashkisë Vlorë.

23.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin të gjitha masat për:

- Të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, mendimin e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Informacioni që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit;
- Të kërkuar dhe respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve, të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, në varësi të tipologjisë së objektit dhe kushteve në të cilat zhvillohet. Për të gjitha rastet në të cilat këto autoritete kërkojnë ndryshimin e projektit ndërtimor ose plotësimin e dokumentacionit, miratimi i lejeve të ndërtimit të kryhet vetëm pasi është rikërkuar mendimi i tyre dhe është marrë miratim pozitiv (ose në heshtje).

24.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin të gjitha masat për të:

- Analizuar situatat në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e aplikimeve që vijnë përmes sistemit *e-lejet*, evidentimin e personave përgjegjës, me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit të Bashkisë Vlorë, në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe dispozitat ligjore në fuqi, për ato raste kur: zbatimi i punimeve ka filluar pa u pajisur paraprakisht me dokumentin e konfirmuar të fillimit të punimeve; leja për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit është miratuar pasi ndryshimet e kërkuara janë reflektuar në objektin e zbatuar; projekti i certifikuar ka ndryshime nga projekti i miratuar;
- Rishikuar metodologjinë e miratimit të lejeve për ndryshim projekti gjatë ndërtimit, duke përfshirë në procesin e shqyrtimit të aplikimit kryerjen e inspektimeve në objekt nga ana e

Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, para miratimit të lejeve, me qëllim marrjen e sigurisë së zhvilluesi nuk i ka reflektuar ndryshimet e kërkuara.

25.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin të gjitha masat për të analizuar situatën në lidhje me miratimin e certifikatës së përdorimit për *"Godinë 4 kat, me 2 kate nëntokë, me tarracë të shfrytëzueshme të gjelbëruar, me funksion hoteleri dhe shërbime turistike"*, me zhvillues "B" ShPK, miratuar në datën 04.05.2023, në kushtet e mungesës së kompetencës nga Bashkia Vlorë, evidentimin e personave përgjegjës dhe marrjen e masave sipas përcaktimeve ligjore.

26.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin të gjitha masat për të cituar në dokumentet e emetuar prej saj (gjatë shqyrtimit / miratimit të aplikimeve në sistemin *e-lejet*), se cilët janë personat që kanë kryer shqyrtimin, duke përcaktuar dhe rolet, sipas manualeve të sistemit elektronik të lejeve.

27.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Vlorë, të marrë masa për:

- Referimin e bazës ligjore të llogaritjes së masës së gjobës dhe në bashkëpunim me Policinë Bashkiake sipas rastit edhe me IKMT;
- Të vijuar ndërhyrja për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm për **9** raste të vitit 2023 dhe **19** raste të vitit 2024;
- Të kryer kallëzim penal për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi për **3** raste në vitin 2023 dhe **16** raste të vitit 2024.

28.1- Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë, të marrë masa për të pasqyruar situatën e ndërtimit në lidhje me zhvillimin e tre objekteve:

-*"Ndërtimi i pergolatës dhe vendosja e paneleve fotovoltaik"* miratuar me vendimin nr. 218, datë 26.12.2023, në pronësi të "F.I", në adresën rruga "Osman Haxhiu", Vlorë;

-*"Kompleks shërbime turistike dhe shtëpi të dyta në Rradhimë – Vlorë"*, miratuar me vendimin nr.327, datë 05/04/2023, me zhvillues "E" ShPK, në Rradhimë, Vlorë;

-*Godinë banimi dhe shërbime 1-8-9 kate dhe 1 kat nëntokë (objekti 2)"*, miratuar me vendimin nr.585, datë 13/06/2023, me zhvillues "G.K" ShPK, në adresën "Uji i Ftohtë", Vlorë, si dhe të hartojë programe konkrete për të kryer kontrolle për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi, deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe verifikimit e zbatimit të punimeve për deklaratat paraprake të miratuara për kryerjen e punimeve.

29.1- Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Vlorë, të marrë masa për lëshim "*Urdhrit të Ekzekutimit*" për vjeljen e gjobës nr. 660, datë 18.12.2023, për subjektin S. N. (F. K.).

30.1- Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Vlorë të marrë masa që:

- Në bashkëpunim me Njësitë Bashkiake dhe me Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, për identifikimi e ndërtuesit të pa ligjshëm të pa identifikuar dhe nxjerrjen e vendimit për "*Dënim me Gjobë*", në përputhje me procesverbal konstatimi për ndërtime informale të mbajtur nga Inspektoret e terrenit, dhe për nxjerrjen e Vendimeve për "*Dënim me Gjobë*" dhe "*Prishje e Objektit të Kundërligjshëm*", në përputhje me procesverbalin e konstatimimit për ndërtime informale të mbajtur nga inspektorët e terrenit për subjektin S. K.

31.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë e Mbrojtjes së Mjedisit, të marrin masa për ngritjen e grupeve të punës për verifikimin e tyre në terren, si dhe plotësimin e dokumentacionit ligjor për regjistrimin e ekonomive pyjore të transferuara.

32.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të marrë masa për ngritjen e Strukturës Përgjegjëse për Menaxhimin e Stacioneve të Plazhit, si dhe për përgatitjen e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara, publike dhe private, sipas koordinatave e miratimin e saj me Vendim të Këshillit Bashkiak.

33.1- Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe e Menaxhimit të Aseteve, në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrin masa duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e detyrimeve tatimore për **16** subjektet.

34.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, të marrin masa për plotësimin e dokumentacionit të lejes infrastrukturore për projektin "*Përmirësim i mobilitetit*" pranë zonës urbane te ish –Fusha e Aviacionit Vlorë dhe të fillojë procedurat e shpronësimit në lidhje me pronat private të prekura nga ky projekt.
34.2- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në Bashkëpunim me Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, të marrin masa për plotësimin e dokumentacionit për shpronësim për interes publik të Pasuritë nr.41/229 dhe 41/230 ZK 8602 të regjistruara në pronësi të Bp. G, H, P, M dhe njëkohësisht ndodhen në inventarin paraprak të Bashkisë Vlorë.
35.1- Rekomandim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë, rekomandohet që në procedurat e ardhshme të kolaudimit të objekteve, të detajohet kontrata ku të përcaktohet afati i kohëzgjatjes së procesit të kolaudimit vlera e shërbimit të kolaudimit, të drejtat, detyrat dhe penalitetet e secilës palë etj.
36.1- Rekomandimi: Kryeinspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Vlorë, të marrë masat për:
- Të hartuar në mënyrë periodike planet mujore / tremujore / vjeçare të punës, si dhe për t'a shpërndarë këtë informacion te strukturat e vartësisë dhe inspektorët;
- Të hartuar në mënyrë periodike çdo tremujor, raportin e aktivitetit të inspektoratit, evidencat si dhe t'a dërgojë këtë informacion tek Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.
37.1- Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, të hartojnë dhe të miratojë një plan strategjik dhe vjetor për hartimin e dokumentacionit ligjor e teknik për procedurën e inventarizimit të pronave shtetërore dhe për pajisjen me certifikatë pronësie të Aseteve të transferuara me VKM, me qëllim që ky proces të realizohet me efektivitet në arritjen e objektivave të njësisë në dobi të komunitetit.
37.2- Rekomandim: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, të marrin masat për përgatitjen e praktikave dokumentare të pronave publike të transferuara për të vijuar me aplikim në DVASHK Vlorë, për të përfunduar regjistrimin e këtyre pronave në një periudhë sa më të shkurtër kohore.

Masa për shpërblim dëmi të lëna në auditimin e mëparshëm.
1.1- Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **161,500 lekë pa TVSh,** për mos përfundim në afat të punimeve dhe vlerën **134,472 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**R.C"** ShPK.
3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **323,527 lekë** pa TVSh për mos përfundim në afat të punimeve dhe vlerën **610,268 lekë pa TVSh,** për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga BOE "**V.G" & "I.G**" ShPK.
4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **195,300 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "***A***" ShPK.
5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **684,820 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga BOE "**L.C" ShPK & "V.H" ShPK**.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **116,200 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**C"** ShPK.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **327,184 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**SH"** ShPK.

8.1- Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **304,000 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**B"** ShPK.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **128,000 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**SH"** ShPK.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **202,240 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**A"** ShPK.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **151,480 lekë** pa TVSh për diferencat në lidhje me volumet e punimeve nga shoqëria "**P"** ShPK.

14.1- Rekomandimi: Drejtoria e Financë/ Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Vlorë, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **466,905 lekë**, nga shoqëria "**2"** ShPK, nëpërmjet shoqërisë së sigurimit "I" ShA.

15.1- Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhetit dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **570,977 lekë**, nga shoqëria "**P"** ShPK, për mos mbyllje në afat të punimeve të kontratës nr. 12273/12 prot, datë 5.11.2024, me objekt: " *Rehabilitim i kanalit Kallafet dhe Babicë, Vlorë",* viti 2024.

16.1- Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhetit dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **916,575 lekë pa TVSH** nga shoqëria sipërmarrëse "*A.C*" ShPK, si penalitet për punime të pakryera, parashikuar në afatet e kontratën nr. 7950 *prot*, datë 3.7.2023, me objekt "*Rehabilitimi i stacioneve të autobusëve dhe i stacionit të taksive elektrike të Segmentit nga Shkolla e Marinës deri te Regina City*".

16.2- Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë, të marrë masa që të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë arsyet dhe shkaqet e mosmarrëveshjeve ose konfliktit mes palëve mbi dështimin e realizimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Rehabilitimi i stacioneve të autobusëve dhe i stacionit të taksive elektrike të Segmentit nga Shkolla e Marinës deri te Regina City*", të lidhur ndërmjet AK- Bashkia Vlorë dhe shoqërisë sipërmarrëse "*A.C*" ShPK me nr. 7950 *prot*, datë 3.7.2023. Në rast të kundërt, Bashkia Vlorë t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në

fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, në kushtet ku kjo kontratë ka dështuar.
17.1- Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Vlorë dhe Drejtorinë e Financave, të marrin të gjitha masat për të njoftuar subjektin mbi detyrimin që ka në lidhje me vlerën **741,600 lekë** të papaguar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, si dhe arkëtimin e kësaj vlere.

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin e të ardhurave të munguara të lëna në auditimin e mëparshëm.
4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **562,962 lekë** nga **8** subjektet dhe vlerës **854,632 lekë** nga **6** subjekte për taksën e ndërtesës.
4.2. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për ngritjen e strukturave të nevojshme në mënyrë që të identifikojë çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e bashkisë, si dhe të planifikojë detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" apo "truall" sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë.
7.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike Bashkia Vlorë, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për rishikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me UK ShA Vlorë, për një menaxhim më të mirë të taksave e tarifave nga abonentët familjarë, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore e administrative arkëtimin e vlerës së detyrimit të arkëtuar nga UK sha Vlorë por të pa likuiduara në llogarinë e Bashkisë për vlerën **191,756,541 lekë**. Të saktësojë dhe kontabilizojë diferencën prej 839,688 lekë nga debitorët familjar.
8.1- Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me IMTV dhe Drejtorinë e të Ardhurave Bashkia Vlorë, të marrin masa për evidentimin dhe nxjerrjen e njoftim vlerësimeve në shumën **3,053,350 lekë, të 24 subjekteve** debitorë për tarifën e mbetjeve urbane, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative për arkëtimin e detyrimeve.
9.1- Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Vlorë, të marrë të gjitha masat për të njoftuar zhvilluesit të cilët kanë përfituar lejet e ndërtimit: **i.** "L.B" ShPK për aplikimin me nr. *AN170220230016* (128.7 m^2 ose 7,955,514 lekë); **ii.** "F" ShPK për aplikimin me nr. *AN100420230044* (77 m^2 ose 4,758,600 lekë); **iii.** "L" ShPK për aplikimin me nr. *AN290520230014* (251 m^2 ose 15,501,294 lekë); **iv.** "M" ShPK për aplikimin me nr. *AN040620230002* (222.18 m^2 ose 13,330,800 lekë); për të hartuar aktmarrëveshjet me ta, për kalimin pa shpërblim të sipërfaqeve takuese në favor të fondit publik për strehim social, në natyrë ose vlerë monetare (**41,546,208 lekë në total**). Nga Bashkia Vlorë të ndiqen të gjitha hapat deri në refuzimin e aplikimeve për pajisje me certifikatë përdorimi, nëse zhvilluesit nuk dakortësohen për hartimin e aktmarrëveshjeve.
10.1- Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Vlorë, të marrë masa për të arkëtuar diferencat e detyrimit në përputhje me shkeljen e konstatuar në subjektet Artan Vrekaj për vlerën **4,939,060** lekë; S.N (F.K) për vlerën **900,320** lekë; P.B për vlerën **49,520** lekë; F.M për vlerën **300,000** lekë. Ndërsa për subjektin SH.M, të kryhet llogaritja dhe arkëtimi i sanksionit përkatës, në përputhje me konstatimin e kundërvajtës për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi (punime mure tulle perimetral me përmasa 6.6 ml + 6 ml +3.8 ml x 3 ml x 0.25 ml.)
11.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë të ngrejë një grup pune me përfaqësues nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Struktura Përgjegjëse për Menaxhimin e Stacioneve të Plazhit dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, duke hartuar një plan pune me afate të përcaktuara. Grupi i punës të analizojë dosjet e subjekteve që kanë administruar hapësira publike të stacioneve të plazhit, me fokus verifikimin e plotësimit të dokumentacionit ligjor dhe përcaktimin e përgjegjësive për parregullsitë e konstatuara. Gjithashtu, të merren masat e nevojshme dhe të ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e

detyrimeve në vlerën **8,098,500 lekë**, që kanë rezultuar si faturim më pak në raport me sipërfaqen e miratuar nga AKB për 17 parcela me sipërfaqe totale 19,947 m².

12.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Policinë Bashkiake, të marrin masa duke hartuar plan pune me afate konkrete. Për të analizuar dosjet e subjekteve që kanë administruar hapësira publike në lidhje me plotësimin e dokumentacionit ligjor dhe nxjerrjen e përgjegjësive për parregullsitë e konstatuara si dhe marrjen e masave duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e detyrimeve në vlerë **11,424,290 lekë nga 187 subjekte**.

13.1- Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të ngrejë një grup pune me përbërje nga Drejtoria e Pronave Publike dhe e Menaxhimit të Aseteve, Strukturën Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të Plazhit, Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, duke hartuar një plan pune me afate të përcaktuara. Ky grup pune të analizojë dosjet e subjekteve që kanë administruar hapësira publike të stacioneve të plazhit, me qëllim verifikimin e plotësimit të dokumentacionit ligjor, përcaktimin e përgjegjësive për parregullsitë e konstatuara dhe marrjen e masave përkatëse, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **8,008,476 lekë ndaj 57 subjekteve**.

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike të lëna në auditimin e mëparshëm.

1.1- Rekomandimi: Titullari i AK (*Bashkia Vlorë dhe NSHP-Bashkia Vlorë*), të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST dhe s'kualifikimin e atyre që i plotësojnë ato, me pasojë përdorimin pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 11,173,298 lekë.

2.1- Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Vlorë *(aparati)*, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST dhe s'kualifikimin atyre që i plotësojnë ato, me pasojë përdorimin pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 1,100,000 lekë.

2.2- Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (*komisioni i vlerësimit të ofertave*), gjatë vlerësimit të procedurave të prokurimit, të verifikojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga OE dhe të raportojë në APP deklarime e falsifikuara për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike.

3.1- Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialist të fushës për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit në vlerën 4,957,766 lekë pa TVSh**,** si rezultat i hartimit të gabuar të fondit limit të shërbimit të pastrimit në Njësinë Administrative Orikum.

4.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit të Autoritetit Kontraktor në vlerën 538,650 lekë pa TVSh mbi pagesat e kryera për punime të mbivendosura në objektin e mësipërm.

5.1- Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë në buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën 7,908,566 lekë pa TVSh mbi pagesat e kryera për punime të mbivendosura në objektin e mësipërm.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se vlera progresive e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore të subjekteve fizik/juridik/institucione/abonentë familjarë, etj në fund të

vitit 2025 ishte në vlerën **829,623,808 lekë**[31], nga të cilat, vlera e debitorëve të krijuar gjatë vitit 2025 ishte 37,932,379 lekë dhe pakësimet gjatë vitit 2025 ishin në vlerën 27,422,381 lekë. Sa më sipër, në krahasim me fundin e vitit 2024, ku vlera debitore ishte **819,113,810 lekë**, në fundin e vitit 2025 vlera debitore ishte rritur me 10,509,998 lekë.
Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Vlorë në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 15 dhe 88 në Ligjin nr.9920 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Nenin 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; Shkronjën "a" në pikën 1.3 në nenin 9 në Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; Nenin 42 në Ligjin nr.68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar; VKB nr. 96, datë 07.12.2023 "Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2025", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Vlorë, si Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Drejtorinë Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Projekteve dhe Administratorët e Njësive Administrative të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve debitorë nga taksa/tarifa vendore në subjektet fizik/juridik/institucioni/abonentë familjarë në vlerën **829,623,808 lekë**, për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit të keq që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.
Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2026 dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit, rezultoi se përgjatë vitit 2025 në territorin e Bashkisë Vlorë, kanë ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit 40 subjekte, nga të cilët 18 prej tyre kanë ushtruar aktivitet të pa licensuar. Përgjatë vitit 2025 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që kanë ushtruar aktivitet pa licencë. U konstatua se në fund të vitit 2025 rezultuan debitor 6 subjekte për vlerën 5,000,000 lekë. Vlera debitore ishte krijuar në vitet e mëparshme, pasi për vitin 2025, subjektet që janë pajisur me autorizimin për tregtimin e karburantit, kanë kryer likuidimin e detyrimit. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, u konstatua se nuk janë njoftuar të gjithë subjektet për likuidimin e detyrimit, si dhe nuk administrohet dokumentacion drejtuar Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për marrjen e masave shtrënguese ndaj subjekteve debitorë.
Gjithashtu nga kryqëzimi i databasës së Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, Qendrës Kombëtare të Biznesit, me databazën e Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, rezultoi se janë 4 subjekte të cilat kanë ushtruar aktivitet "Tregtimi Karburanti", për të cilët Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike nuk kishte informacion/dokumentacion. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 4 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar; Pikën 1.3 në nenin 9, shkronjën "c" të pikës 5 në nenin 35 të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; Nenin 12 në Ligjin nr.68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar; Pikat 15.1 dhe 15.2 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike Bashkia Vlorë të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t'i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët

[31] Sqarojmë se në këtë vlerë nuk janë përfshirë detyrimet nga gjobat e IMTV dhe Policisë Bashkiake (vlera e të cilave është e kontabilizuar), qira për stacionet e plazhit (vlera e të cilës nuk është kontabilizuar), tarifa e licencimit të stacioneve të karburantit (vlera e të cilës nuk është kontabilizuar).

me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial, për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2026

2.2. Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 5,000,000 lekë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV-ja e Bashkisë Vlorë rezultoi se, më 31.12.2025, evidentohen 665 gjoba të formës së prerë dhe të paarkëtuara, me vlerë të përgjithshme 402,010,813 lekë. Kjo vlerë përfaqëson stokun e detyrimeve të paarkëtueshme në fund të vitit 2025 dhe nuk përfshin gjobat e shfuqizuara/falura në zbatim të ligjit nr.127/2024 dhe VKM-së nr.274, datë 09.05.2025. Nga stoku prej 402,010,813 lekë, vlera 195,985,813 lekë u përket gjobave të vendosura gjatë vitit 2025, ndërsa diferenca prej 206,025,000 lekë u përket gjobave të mbartura nga periudhat e mëparshme.
Veçmas nga ky stok, në zbatim të ligjit nr.127/2024 dhe VKM-së nr.274, datë 09.05.2025, janë shfuqizuar 619 masa administrative me gjobë, në vlerën 222,065,000 lekë. Për gjobat e formës së prerë dhe të paarkëtuara nuk u dokumentua paraqitja e kërkesave për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit dhe as ndjekja e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm të tyre. Gjithashtu, për gjobat e vitit 2025, të papaguara brenda afatit ligjor, nuk ishin përllogaritur kamatëvonesat përkatëse, rast pas rasti. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 30, veçanërisht pikat 3 dhe 4, të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar, lidhur me ekzekutimin e gjobave administrative dhe përllogaritjen e kamatëvonesave. Për procedurën e ekzekutimit, referenca mund të plotësohet me nenet 510, shkronja "e", dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile, lidhur me titujt ekzekutivë dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
3.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV Bashkia Vlorë të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 402,010,813 lekë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2026 dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2025 në mënyrë progresive vlera debitore është 216,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë. Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, nuk ishin marrë masat ligjore. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 në Ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 "*Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës*", i ndryshuar, si dhe pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 216,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2026 dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vlorë (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Vlorë) u konstatua se përgjatë vitit 2025, në 46 raste, ishin kryer punime ndërtimi nga subjekte të ndryshme, për të cilët nuk ishte aplikuar tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën 4,631,073 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e

mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKB nr. 96, datë 07.12.2023 "Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2025", i ndryshuar, kapitulli nr.2, tabela e tarifave, si dhe paragrafi në vijim të tabelës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë të nxjerrë njoftim detyrimin për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative për arkëtimin e vlerës prej 4,631,073 lekë[32].

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2026

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e pajisjes me autorizim të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë "Lavazh", ka rezultuar se përgjatë vitit 2025 kanë ushtruar aktivitet me objekt "Lavazh", 51 subjekte gjithsej, për të cilët nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike Bashkia Vlorë nuk ishte lëshuar asnjë autorizim për ushtrim veprimtarie si "Lavazh", me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën 510,000 lekë. Sa më sipër është në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKB nr. 96, datë 07.12.2023 "Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2025", i ndryshuar, kapitulli nr.2, pika 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e tarifës së autorizimit për ushtrim veprimtarie "Lavazh" në vlerën 510,000 lekë lekë ndaj 51 subjekteve[33].

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave nga qiradhënia e aseteve në pronësi/përdorim të Bashkisë Vlorë, u konstatua se Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve, si struktura e ngarkuar për administrimin e aseteve, (përjashtuar hapësirat e dhëna me qira për stacion plazhi) nuk kishte një regjistër të kontratave të qirasë për pasuri të llojit ndërtesë, truall, sipërfaqe pyjore dhe kullosore etj, si dhe nuk kishte kryer verifikim fizik pranë pasurive të cilat i ka në pronësi/përdorim, me qëllim identifikimin e rasteve të përdorimit të tyre në mungesë të dokumentacionit ligjor.

-U konstatua se nga vlera e faturuar prej 35,736,128 lekë për vitin 2025, për marrjen me qira të hapësirës për "Stacion plazhi", ishin likuiduar vetëm 34,550,628 lekë, pra me diferencë në vlerën 1,185,500 lekë, si rrjedhojë e mos pagesës së detyrimit vjetor nga 5 subjekte.

Në mënyrë progresive deri më datë 31.12.2025 vlera e detyrimit të papaguar për marrjen me qira të hapësirës për "Stacion plazhi" është 2,400,000 lekë, ku vlera prej 1,214,500 lekë krijuar deri në fund të vitit 2024 dhe 1,185,500 lekë krijuar brenda vitit 2025, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë. Për subjektet e mësipërme nuk ishte aplikuar penalitet për moslikujdimin e tarifës së qirasë, si dhe për arkëtimin e detyrimit nuk ishin marrë masat për prishje të kontratës, moslejimin e ushtrimit të aktivitetit, kërkesë padi në gjykatë etj.

-Gjithashtu për 13 subjekte, u konstatua se megjithëse janë debitorë për moslikujdimin e detyrimeve vendore për taksa, tarifa ose kamatë vonesa, përsëri ishin pajisur me hapësirë për përdorim e plazhit për vitin 2025.

-Nga verifikimi i kryer u konstatua se për 1 subjekt në 2 raste, tarifa e aplikuar ishte në vlerën 20 lekë, tarifë e cila aplikohet në rastet kur aplikanti ka dokument pronësie në zonën, që do të shfrytëzojë për "Stacion plazhi", por konkretisht dokumentacioni i pronësisë nuk përputhet me vendndodhjen e stacionit të plazhit, duke krijuar diferencë në vlerën 330,750 lekë gjithsej që përbënë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë. Sa më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën a/2 të Paketës Fiskale Bashkia Vlorë, shkronjën "c" pika 3 në nenin 7 në VKM nr.649, datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", e ndryshuar; Nenin 167 të

[32] Subjektet janë pasqyruar në Kapitullin Anekse – Aneksi nr.2, tabelat nr.24 dhe nr.25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
[33] Subjektet janë pasqyruar në Kapitullin Anekse – Aneksi nr.2, tabela nr.23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

rregullores së brendshme të Bashkisë Vlorë, në fuqi për vitin 2025. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me objekt verifikimin, inventarizimin e pasurive që Bashkia Vlorë ka në pronësi/përdorim, me qëllim krijimin e regjistrit të aseteve me informacion të plotë për vendndodhjen, statusin juridik, gjendjen fizike etj.

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve të marrë masat për krijimin e regjistrit të kontratave të qirasë për pasuritë e llojit truall, ndërtesë, hapësirë publike, pyje dhe kullota.

7.3. Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Bashkia Vlorë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore 2,730,750 lekë, nga të cilat 2,400,000 lekë si rrjedhojë e mospagesës së detyrimit vjetor të qirasë për hapësirë plazhi, si dhe 330,750 lekë si rrjedhojë e aplikimit jo të drejtë të nivelit të tarifës për hapësirë plazhi.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2026

C. MASA DISIPLINORE.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; shkronjat "b", "c", "ç" të nenit 58 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"; nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kontratës individuale, si dhe shkronja "k" e nenit 64 të Ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vlorë** të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si vijon:

D.1. "Vërejtje", për punonjësit, si më poshtë:

1. Z. I.Xh, me detyrë Drejtor i Urbanistikës.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për mangësitë e evidentuara në përcjelljen e informacionit pranë Drejtorisë së të Ardhurave, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në zbatim të lejes së ndërtimit. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2. Z. Z.S, në cilësinë e ish Drejtorit të Infrastrukturës dhe Investimeve Publike.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për mangësitë e evidentuara në përcjelljen e informacionit pranë Drejtorisë së të Ardhurave, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në zbatim të lejes së ndërtimit, si dhe mangësitë për subjektet që kanë ushtruar aktivitet në tregtimin e karburantit. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3. Z. K.K, me detyrë Drejtor i komanduar i Drejtorisë së Aseteve dhe Pronës Publike për periudhën Korrik – Dhjetor 2025.

Për shkeljet e konstatuara:

Për mos marrjen e masave për subjektet debitorë që kanë marrë me qira hapësirë plazhi, si dhe për krijimin e databazës për kontratat e qirave me palët e treta. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4. Z. F.Ll, me detyrë Drejtor i komanduar i DAV Bashkia Vlorë;

Për shkeljet e mëposhtme:

Mos administrimin korrekt të të dhënave lidhur me abonentët familjarë dhe subjektet private që kanë detyrime nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe mos marrjen e të gjitha masave të nevojshme për arkëtimin e këtyre detyrimeve, me pasojë krijimin e të borxhit tatimor. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

D. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Vlorë (Drejtoria e Burimeve Njerëzore), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore Për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të ahteve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil"', i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte nga **"Vërejtje",** si më poshtë:
1. Z. K.M, me detyrë Drejtor i Urbanistikës për periudhën nga data 01.01.2025 deri më datë 03.03.2025;
2. Z. O.D me detyrë Drejtor i Urbanistikës për periudhën nga data 17.07.2025 deri më datë 03.10.2025;
3. Znj. **M.C**, me detyrë Përgjegjës i Njësisë së Prokurimit për periudhën Qershor – Dhjetor 2025;
Për shkeljet e mëposhtme:
Për mangësitë e evidentuara në përcjelljen e informacionit pranë Drejtorisë së të Ardhurave, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në zbatim të lejes së ndërtimit dhe prokurimeve publike. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
4. Z. J.J, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Aseteve dhe Pronës Publike, për periudhën Janar – Korrik të vitit 2025;
Për shkeljet e konstatuara:
Për mos marrjen e masave për subjektet debitorë që kanë marrë me qira hapësirë plazhi, si dhe për krijimin e databazës për kontratat e qirave me palët e treta. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
5. Z. E.A, në cilësinë e Kryeinspektori të IMTV aktualisht Drejtor i Policisë Bashkiake;
6. Z. I.Z, me detyrë Kryeinspektor i IMTV Bashkia Vlorë, për periudhën Mars-Qershor 2025;
7. Z. D.K, me detyrë Kryeinspektor i IMTV Bashkia Vlorë, për periudhën Korrik-Dhjetor 2025;
Për shkeljet e konstatuara:
Për mos marrjen e masave për subjektet debitorë nga gjobat e IMTV Bashkia Vlorë. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 34-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
8. Znj. D.F, me detyrë Drejtor i Komanduar i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve publike për periudhën Korrik – Dhjetor të vitit 2025;
Për shkeljet e mëposhtme:
Për mangësitë e evidentuara në përcjelljen e informacionit pranë Drejtorisë së të Ardhurave, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në zbatim të lejes së ndërtimit, si dhe mangësitë për subjektet që kanë ushtruar aktivitet në tregtimin e karburantit. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
9. Z. S.H, me detyrë Administrator në NJA Orikum;
10. Z. G.F, me detyrë administrator në NJA Qendër;

11. Z. K.SH, me detyrë administrator në NJA Novosel.
12. Z. B.A, me detyrë Administrator në NJ.A Shushicë.
Për shkeljet e konstatuara:
Mos administrimin korrekt të të dhënave lidhur me abonentët familjarë dhe subjektet private që kanë detyrime nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe mos marrjen e të gjitha masave të nevojshme për arkëtimin e këtyre detyrimeve, me pasojë krijimin e vlerave të konsiderueshme të borxhit tatimor. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 26-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT